

Revistë edukative-kulturore

ETIKA

Shqipëri: 150 Lek
Kosovë: 1 Euro
Maqedoni: 60 Den
Europa: 2 Euro

Korrik 2011 • Numri: 40 • E përmuajshme



Singeriteti

www.revistaetika.com

EDITORIAL

Sinqeritet (*ihlas*) do të thotë të qëndruarit larg çdo lloj shirku, larg bestytive dhe ndjenjave negative, si dhe shmangia nga marrëdhëniet që mbështeten vetëm në interesin e kësaj bote. Shkurt, mund të themi se sinqeritet është të kesh për qëllim vetëm pëlqimin e Zotit dhe jo kënaqësitë apo pakënaqësitë e njerëzve.

Sinqeriteti për adhurimin dhe veprën fetare (*amel*) është si shpirti për trupin. Në këtë botë, për sa kohë që njeriu është bashkë me shpirt dhe trup, ka kuptim. Trupi nuk ka kuptim pa shpirtin, siç nuk ka as shpirti pa trupin. Veprat fitojnë vlerë me sinqeritet, sepse ashtu si nuk ka kuptim një vepër pa sinqeritet, po ashtu edhe sinqeriteti pa vepër është i pavend.

Sinqeriteti nuk është një vlerë që arrihet lehtë. Madje, të vetëndihesh i sinqertë, është shenjë e pasinqeritetit...

Sinqeritet do të thotë që në fenë tënde t'i dedikohesh vetëm Allahut, punët t'i kryesh vetëm për të fituar kënaqësinë hyjnore dhe t'i pastrosh ato nga ndyrësitë.

Sinqeriteti është garantuesi i paqes shpirtërore dhe mburoja më e fortë kundër frikës...

Sinqeriteti është ilaçi i problemeve, i hidhërimit dhe dhimbjeve...

Nëse pakësohet sinqeriteti, i cili siguron paqen shpirtërore, zemra ngushtohet dhe shqetësimet shtohen. Për arsye se adhurimin dhe nënshtrimin e bëjnë për dikë tjetër dhe jo për Allahun, zemrat e munafikëve, mushrikëve dhe hipokritëve ngushtohen vazhdimisht...

Fjala jonë e fundit le të jetë fjala e Allahut:

"Thuaj: "Në të vërtetë, namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve." (Surja El-En'am, 162.)

"Ai (shejtani) tha: "Betohem në madhërinë Tënde se unë do t'i mashtroj ata të gjithë, përveç robërve Tu të sinqertë!" (Surja Sad, 82-83.)

Në një hadith thuhet:

"Bëhu i sinqertë në fenë tënde! Nëse bëhesh i tillë, të mjaftojnë edhe pak vepra të mira" (Hakim, IV, 341.)

Do të lexoni:



Ahmet Tashgetiren /

Sinqeriteti - Standardi fetar i kualitetit të njeriut

4



Ahmet Tashgetiren / 4

Sinqeriteti - Standardi fetar i kualitetit të njeriut

/ 8

Reportazh me të nderuarin z. Ahmet Tashgetiren

Shpëtim Kelmendi / 10

Përkujdesja madhështore e Allahut

Mustafa Erish / 13

Le të jetë e vogël por të jetë për Allahun

Xhemal Nar / 14

Fuqia dhe mendjemadhësia

Edison Çeraç / 16

Kultura masive

Nexhat Ibrahimimi / 20

Besimi islam në dritën e njohjes racionale

Prof. dr. Hasan K. Jëllmaz / 24

Statusi i sinqeritetit

/ 28

Fotoja e muajit

Prof. dr. Sadije Bushati / 30

Një analizë e zhvillimit të turizmit në Shkodër

M. Sami Ramazanogllu / 33

Shpëtimi i madh

Nexhat Ibrahimimi /

Besimi Islam në dritën e njohjes racionale

20



Prof. dr. Hasan K. Jëllmaz /

Statusi i sinqeritetit

24



Viti: VI | Numri: 40 | Korrik 2011

Administrator i Progresi botime:

Shuaqip Bashhan

bashan43@hotmail.com

+355 69 20 76768

Drejtor & Kryeredaktor:

Alban Kali

albankali@yahoo.com

+355 69 24 23989

Përkthyesit:

Alban Kali / Albert Halili / Artur Tagani

Drita Muça / Elvira Puka / Elona Sytari

Evans Drishti / Fatmir Sulaj / Ilir Hoxha

Redaktor:

Zija Vukaj

Korrektore:

Ma. Irida Hoti

Kopertina:

Edison Çeraç

Dizajn-Grafik:

Bledar Xama

Për artikuj

e-mail: revistaetika@progresibotime.com

e-mail: kosova@progresibotime.com

e-mail: maqedoni@progresibotime.com

Korrik 2011

40

Osman Nuri Topbash /
Të nxitosh në punë të mira



Një shikim modern i mendimeve dhe konstatimeve të Ibn Haldunit në lidhje me politikën e administrimit publik dhe ekonomik

34 /

48

Ma. sci. Flamur Sofiu /
Pijet dehëse dhe droga



Fryti i sinqeritetit: Paqja shpirtërore
Një Ajet - Një Hadith
Të nxitosh në punë të mira
Pijet dehëse dhe droga

37 / **A. Jasin Demirxhi**

38 - 39 /

40 / **Osman Nuri Topbash**

48 / **Ma. sci. Flamur Sofiu**

52 / **Xhahid Bushati**

Shkrimtari, personazhi, lexuesi i vogël - marrëdhënie, raporte dhe aspekte të komunikimit artistik në poezinë për fëmijë të A. R. Mamaqit

55 / **Prof. dr. Selman Sheme**

60

Prof. dr. Selman Sheme /
Shpërngulja me dhunë e popullsisë Çame...



Shpërngulja me dhunë e popullsisë Çame dhe pasojat e kolonizimit grek

58 / **Zani i t'kaluemes**

60 / **Imam Naim Drijaj**

62 / **Ma. Artur Tagani**

Gjeologjia dhe metereologjia në historinë e shkencës islame

64 / **Enciklopedi Islame**

Ibn Hazmi dhe vepra e tij "Gjerdani i pëllumbeshës"

67 / **Ma. Ermal Nurja**

Xhamia e Ethem Beut

PROGRESI
BOTIME
www.progresibotime.com

Adresa:

L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi

Shkodër / Albania

Tel: +355 22 254 634

Fax: +355 22 254 633

Zyra e përfaqësimit Maqedoni

Rr. Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25

Shkup / Maqedoni

+389 71 956 271

Zyra e përfaqësimit Kosovë:

Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin

Prizren / Kosovë

Tel: +381 29 222 795

Fax: +381 29 222 797

+377 441 63 651

Çmimi:

Shqipëri: 150 Lekë

Abonim (një vjetor): 1500 Lekë

Kosovë: 1 Euro

Abonim (një vjetor): 10 Euro

Maqedoni: 60 DEN

Abonim (një vjetor): 720 DEN

Europë: 2 Euro

Abonim (një vjetor): 24 Euro

SINQERIETI

Standardi fetar i kualitetit të njeriut

Ahmet Tashgetiren

Fsnjë fjalë, fjali apo përkufizim që gjendet në Kuran, nuk është pa vend. Çdo fjalë, fjali, shembull dhe përkufizim përmban një mesazh në lidhje me njeriun.

Për shembull, në shumë ajete të Kuranit shprehet qëndrimi: **“Ata që fenë e tyre e kanë vetëm për Zotin e tyre.”** (Araf, 29; Junus, 22; Ankebut, 65; Llukman, 32; Gafir, 14, 65; Bejjine, 5) Një sure që gjendet në Kuran, quhet surja e sinqeritetit – Ihlas, në të cilën janë përvijuar konturet e të qenit rob i Allahut.

Kjo do të thotë se ekziston mundësia që njeriu të kryejë një veprim që ka të bëjë me besimin, por nga ana tjetër të mos e kryejë atë me sinqeritet vetëm për hir të Zotit.

Për të kuptuar se kush janë “ata që fenë e kanë vetëm për hir të Zotit të tyre”, është e nevojshme që, jo vetëm të kuptojmë përkufizimin me gjithçka që përmbledh ai, por edhe të kuptojmë se çfarë përjashton kjo shprehje.

Në një kuptim, kjo do të thotë të pastrosh papastërtinë.

Me fjalë të tjera, të arrish të përjetosh fenë në formën e saj më të purifikuar.

Nuk ka dyshim se vendimin përfundimtar për këtë çështje do ta japë vetë Allahu i Lartësuar.

Pra, është Allahu i Lartë, Ai që do të caktojë se cilët janë personat që fenë e tyre e kanë vetëm për hir të Tij dhe cilët janë ata që në fenë e tyre kanë lënë vend tjetër për gjëra të përkohshme përkrah Zotit të tyre.

Për të kuptuar përkufizimin e fesë “që i përket vetëm Zotit”, para së gjithash duhet të njihet në vetvete se çfarë përfshin dhe nënkupton koncepti fe.

Njësoj me këtë edhe njohja e marrëdhënies mes fesë dhe Allahut përfshihet brenda "njohurive mbi fenë".

Ndoshta në përpikërinë e "fesë vetëm për hir të Zotit" fiton rëndësi përpikëria e përvijimit të kornizës së këtij dedikimi vetëm për Zotin. Pra pyetja në vijim do të jetë: A është Zoti Ai, që e përcakton fenë apo gjëra të tjera, siç janë epshet dhe vatrat e fuqisë që zotërojnë mbi njeriun?

Pra "dedikimi i fesë vetëm Allahut" do të thotë që korniza e fesë të mos përcaktohet nga askush tjetër përveç se Allahu, sepse e drejta e përcaktimit të fesë i takon atij që e krijoi njeriun, pasi feja është diçka që përmban parametrat e fuqisë që përcakton arsyen e ekzistencës së njeriut, parametra të përcaktuara nisur nga fakti që njeriu nuk është krijuar më kot dhe se ato janë kriteret që duhet të zbatohet ai gjatë aventurës së tij në këtë jetë.

Pra që t'ia dedikoni fenë tonë Allahut, duhet të synoni që çdo sjellje juaja të miratohet dhe të pëlqehet vetëm prej Tij.

Pasi çdo sjellje do të paraqitet para Tij më vete dhe do të presë gjykimin e Tij.

Do të vijë dita kur vendim-arrja do t'i përkasë vetëm Atij.

Jo më kot, përpara njeriut, Kurani sa e sa herë lëshon thirrjen "atë ditë".

Atë ditë që...

Për të mos qenë nga ata njerëz, ndaj të cilëve Allahu do të shprehë pakënaqësinë e Tij...

Për të mos qenë nga njerëzit ndaj fesë së të cilëve do të shprehë hidhërimin e Tij.

Atë ditë...

Që Allahu të mos thotë:

Xhihadi yt është i rrejshëm, sepse luftove që njerëzit të të thurnin lavde!

Bamirësia që dhe, është e rrejshme, sepse shpërndave ndihma që njerëzit t'i thurnin lavde bujarisë tënde!

Dituria jote është e rrejshme, sepse mësove që njerëzit të thoshin se sa i ditur ishe!

Namazi yt është i rrejshëm, sepse vetëm përthyeje dhe drejtoje trupin tënd, gjë për të cilën Unë nuk kam nevojë!

Agjërimi është i rrejshëm, sepse vetëm sa nuk

hëngre ushqim dhe nuk pive ujë, por Unë nuk kam nevojë që stomaku yt të mbetet i zbrazët!

Zemra jote është e rrejshme, sepse është fëlliqur dhe brenda saj ka zënë vend çdo gjë, me përjashtim të adhurimit, si i ka hije Zotit tënd.

Sytë, veshët, truri yt janë fëlliqur. Po kur të fillojnë të flasin duart dhe këmbët e tua e të tregojnë se sa mbrapsht i ke përdorur ato.

Mos të na dridhen duart dhe mos t'i mbyllim sytë, kur të na kërkojnë të lexojmë ditarin e jetës sonë.

"Ai ua mundëson (njerëzve) udhëtimin nëpër tokë dhe det. E, kur gjenden në anije që lundron me ta me erën e përshtatshme e ata i gëzohen kësaj, arrin një stuhi dhe i sulmojnë valët nga të gjitha anët e mendojnë se do t'i vënë poshtë, (atëherë) i luten Allahut sinqerisht, duke i premtuar besimin: "Nëse na shpëton nga kjo, me të vërtetë, do të jemi mirënjohës!" (Junus, 22)

Pa lexojeni këtë ajet kuranor:

"Ne ta shpallëm ty librin për hir të së vërtetës, ndaj ti adhuroje Allahun duke qenë i sinqertë në adhurimin e Tij!

Vini re! Adhurim i sinqertë është vetëm ai për Allahun! Ndërsa ata që, në vend të Tij adhurojnë miq të tjerë (duke thënë): Ne nuk i adhurojmë ata për tjetër, vetëm që të na afrojnë sa më afër Allahut, s'ka dyshim se Allahu do të gjykojë mes tyre për çfarë ata ishin në kundërshtim. E është e vërtetë se Allahu nuk udhëzon në rru-

gë të drejtë atë që është gënjeshtar, jobesimtar." (Zumer, 2,3)

Këto janë vetëm dy nga ajetet e Kuranit që flasin për sinqeritetin fetar.

Duhet t'i lexojmë me kujdes këto ajete dhe të themi se "ndërsa bashkohemi me adhuruesit e sinqertë të fesë", duhet ta dimë se "feja e kulluar i përket Allahut" dhe nuk ka arsye që "të kërkojmë mbrojtës tjetër përveç Allahut".

Pra përveç Allahut nuk duhet të kërkojmë zotëri dhe mbrojtës tjetër në asnjë nga dimensionet e jetës dhe të besimit tonë.

Marrëdhënia e brendshme mes grupeve të ajeteve të Kuranit është shumë e rëndësishme që "fenë t'ia kushtojmë Allahut". Madje në suren Nisa, ka një grup ajetesh që nxjerrin në pah se me çfarë rreziqesh do të ballafaqohet njeriu që hedh pas krahësh





“Përveç atyre që u penduan, u përmirësuan, iu përmbajtën Allahut (mësimeve të Tij) dhe praktikojnë sinqerisht fenë e tyre për Allahun. Të tillët do të jenë bashkë me besimtarët, e Allahu ka për t’u dhënë besimtarëve shpërblim të madh.”

këtë përpikëri.

Teksti i ajetit 146 të sures Nisa është:

“Përveç atyre që u penduan, u përmirësuan, iu përmbajtën Allahut (mësimeve të Tij) dhe praktikojnë sinqerisht fenë e tyre për Allahun. Të tillët do të jenë bashkë me besimtarët, e Allahu ka për t’u dhënë besimtarëve shpërblim të madh.”

Në pjesën e mësipërme të ajetit bëhet fjalë për disa lloje njerëzish:

Njerëz që gabojnë...

Në një anë janë personat që janë të kapur pas Allahut, ia kushtojnë fenë vetëm Atij. Madje edhe kur gabojnë dhe largohen prej Zotit, kërkojnë falje për këtë gjë. Ata janë personat e cilësuar “besimtarë” në librin e Allahut dhe Allahu do t’i presë me shpërblime të mëdha në audiencën e Tij.

Po të tjerët kush janë?

Ata që nuk pendohen dhe nuk kapen pas Allahut dhe nuk ia kushtojnë fenë vetëm Zotit. Çfarë do të ndodhë me ta?

Deri sa të vihet në këtë pjesë të ajetit të sures Nisa, më parë hyn në veprim mekanizmi i purifikimit thelbësor në intelektin e njeriut dhe përvijohet korniza themelore e besimit. Ja çfarë thuhet:

Pa shihni, kini kujdes, ejani në vete!

“O ju që besuat! Të jeni vazhdimisht dëshmues të drejtë për hir të Allahut, edhe nëse është kundër (interesit) vetvetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmeve, le të jetë ai (për të cilin dëshmohet) pasanik ose varfanjak, se Allahu di më mirë për ta. Mos ndiqni pra emocionin e t’i shmangeni drejtësisë. Nëse shtrembëroni ose tërhiqeni, Allahu di hollësisht ç’ka punoni.”(Nisa, 135)

Pa shihni, kini kujdes, ejani në vete!

Pra ejani në vete dhe hidhini një vështrim çdo gjëje që është prona e Allahut, qiejt dhe tokën. Pse të mohoni, pse të jeni mosmirënjohës? Ku keni për të shkuar, si mund t’u shkojë ndër mend mosmirënjohja? Për ku mund të arratiseni nga prona e Zotit? Çfarë mund të mendoni, përveç se të strehoheni tek i Fuqishmi që ka aftësi t’ju asgjësojë dhe t’ju zëvendësojë me të tjerë?

Njeriu duhet të perceptojë këtë të vërtetë.

Të mos kemi nevojë që ditën e gjykimit të hutohemi nga pështjellimi “Ku të strehohem?” Prandaj sa jemi në këtë botë, duhet që çdo gjë ta vëmë në vendin e vet dhe të mos krijojmë konfuzion.

Allah, Allah, Allah...

Ai është fuqia absolute...

Duhet të kapemi fort pas Tij.

Pa ejani dhe shihni se si Allahu, i Fuqishmi që ju ka krijuar, ka caktuar nëpërmjet “fesë” kriteret e kësaj jete. Lexojini mirë këto ajete dhe rregullojeni jetën tuaj sipas tyre:

“Janë ata që, përkundër besimtarëve, i miqësojnë jobesimtarët. Vallë, a mos kërkojnë fuqi te ta? S’ka dyshim, e tërë fuqia i takon Allahut.

Juve ju është shpallur në libër (Kuran) që, kur të dëgjoni se po mohohet Kurani i Allahut dhe po bëhet tallje me të, mos rri me ata derisa të mos hyjnë në bisedë tjetër. Përndryshe, ju do të jeni si ata. Allahu do t’i tubojë tradhtarët dhe jobesimtarët që të gjithë në xhehenem.” (Nisa, 139-140)

Ja disa dimensione të tjera që ajeti na mëson, në lidhje me “korruptimin e thellë të shpirtit”.

“Janë ata që presin se ç’po ju ngjan juve. Nëse me ndihmën e Allahut ngadhënjoni, ata thonë: “A nuk ishim me ju?” E nëse jobesimtarëve u takon ndonjë fitim, ata thonë: “A nuk mbizotëruam ne mbi ju (por nuk deshëm të mposhtim) dhe penguan prej jush besimtarët!” Allahu do të gjykojë mes jush ditën e gjykimit. Ai nuk u mundëson kurrsesi jobesimtarëve mbizotërim të plotë mbi besimtarët.

Mynafikët përpiqen të mashtrojnë Allahun (duke u paraqitur rrejshëm si besimtarë), por Allahu mbi-zotëron dinakëritë e tyre. Edhe kur falen, ata falen me përtaci dhe vetëm sa për t'u dukur te njerëzit dhe fare pak e përmendin Allahun.

Ata janë të luhatshëm ndërmjet atij dhe atij (besimit dhe mosbesimit) e nuk janë as me ata (me besimtarët) as me ata (me jobesimtarët). Po atë që e mposht Allahu, ti nuk mund ta shpëtosh.

O ju që besuat! Mos i zini miq jobesimtarët e t'i lini mënjane besimtarët! A doni t'i sillni Allahut argument të qartë kundër vetes?

S'ka dyshim. Mynafikët do të jenë në shtresën më të ulët (në fund) të zjarrit dhe për ta nuk do të gjesh mbrojtës". (Nisa 141-145)

Po mynafikët... Kurani e numëron këtë kategori njerëzish si atë që nuk kapet me gjithë shpirt pas Allahut dhe nuk ia kushton fenë vetëm Atij.

Ata që nuk janë përbrenda siç duken përjash-ta...

Ata që e përmendin shumë pak Allahun...

Ata që mendojnë se mund ta mashtrojnë Allahun..

Që kur falen, falen me përtaci të madhe...

Që duan vetëm sa të duken...

Që nuk dinë se ku kanë për tu ndalur, por shkojnë e vijnë mes imanit dhe kufirit... që një çast besojnë, pastaj mohojnë dhe, kur mohojnë, e kalojnë kufirin me mosbesimin e tyre...

Që braktisin besimtarët dhe bëhen miq me qafirët...

Që qëndrojnë së bashku me besimtarët në raste fitoreje dhe mbajnë qëndrim kundër tyre në rast se ata pësojnë disfatë...

Që kërkojnë të bëhen të fortë dhe të nderuar për jobesimtarët...


Sipas asaj që mësojmë nga Kurani, këta persona do të jenë në shtresën më të ulët të xhehenemit.

Një nga përfundimet që nxjerrim është se, në rast se nuk ia kushtojmë fenë Allahut, atëherë do të përlyhem me njollat e dyfytërisë në fe.

Fjala hyjnore kërkon nga njeriu që ai të jetë i ndërgjegjshëm për këtë lloj korrumpimi shpirtëror dhe të pendohet në rast se është në këtë situatë. Të bëjë kthesë prej saj dhe të përpiqet të pastrohet.

Sinqeriteti...

Të jemi besimtarë të pastër... të mos orientohemi drejt preferencave mendore dhe akteve që e prishin pastërtinë fetare.



Të mos përziejme me njëra-tjetrën të pastrën dhe të fëlliqurën në marrëdhëniet me fenë.

Të jemi të lidhur fort pas fesë dhe jo të kapemi vetëm për një cep të saj.

Të dimë se fundi i udhëtimit tonë do të përfundojë tek Allahu dhe të mundohemi të shkojmë tek qetësia hyjnore me besim të sinqertë.

Të mos e mashtrojmë veten me fenë që kemi krijuar me duart tona. Ta lodhim mendjen se "Çfarë është feja e Allahut?" dhe të mos i shndërrojmë dëshirat tona në fe apo të adhurojmë vetveten.

.....

"Ta kesh fenë vetëm për Allahun" është një paralajmërim hyjnor. Krijuesi i bën të ditur njeriut se në marrëdhëniet e tij me fenë, mund të përjetojë devijime nga feja e vërtetë dhe, me këtë rast, e paralajmëron që "të mos shkojmë tek Ai me një fe të zbrazët apo të përzier me gjëra të kësaj bote".

Ta falënderojmë Zotin tonë, që me këtë paralajmërim, na e ka zbardhur rrugën në këtë botë duke na bërë të ruhemi që të mos shkojmë të verbër tek vendtubimi i jetës tjetër (mahsher).

Zoti na e mundësoftë të shkojmë tek Ai të pajisur me fenë e sinqertë.

Amin.



Reportazh me të nderuarin z. Ahmet Tashgetiren

Ne ju njohim ju, por dëshirojmë që t'ju dëgjojmë nga gjuha juaj. Shkurtimisht, a mund të flisni rreth vetes suaj?

Unë kam lindur në Kahramanmarash, në vitin 1948, si fëmija i pestë i një familjeje me dhjetë fëmijë. Kam mbaruar medresenë dhe Institutin e Lartë Islam të Stambollit. Në vitin 1969 filloi jeta ime letrare dhe gazetareske. Momentalisht administroj drejtorinë e botimit. Në gazetën "Sot" shkruaj artikuj ditorë dhe në revistën "Aksion", artikuj javorë. Veçanërisht në radion Burç FM, çdo ditë përveç fundjavës, u përgjigjem pyetjeve rreth Turqisë, botës dhe njerëzisë, nën titullin "Komenti i ditës". Nganjëherë marr pjesë edhe në programe televizive.

Si e ndiqni rrjedhën aktuale të politikës ditore, si gazetar dhe shkrimtar?

Qoftë Turqia apo bota islame, brenda së cilës ndodhet ajo, kanë probleme serioze. Droga, al-

kooli, dhuna dhe luftërat që shtypin të dobëtit, janë disa prej tyre.

Ne si myslimanë, kemi disa probleme në lidhje me praktikimin tonë të islamit. Për shembull: me të vërtetë, a mund t'i pasqyrojmë bukuritë e islamit në personalitetet tona?

Ajo që po përpiqemi të bëjmë është: t'i shikojmë të gjitha këto, t'i ndajmë këto me njerëzit dhe t'ua komunikojmë lexuesve sugjerimet e zgjidhjeve të cilat i konsiderojmë të sakta...

Ju keni një të kaluar letrare të gjatë dhe të ndritur. Si duhet të ushqehet një shkrimtar? Si duhet ta rinovojë veten e tij?

Një pyetje e rëndësishme. Sigurisht që edhe shkrimtari, nëse nuk e rinovon veten e tij, ngrin. Për këtë arsye, ai duhet të ushqehet me literaturë të re. Si ushqehet një shkrimtar? Sigurisht që duke lexuar dhe duke ndjekur çdo lloj zhvillimi

dhe rrjedhe intelektuale në botë... Ne këtë po mundohemi të bëjmë. Një pjesë e rëndësishme e jetës sonë ditore kalon duke lexuar.

Sipas jush, cila është gjendja e sotshme e botës islame dhe problemet e saj?

Gjendja e sotme e botës islame ka lidhje me zhvillimet që kanë ndodhur përgjatë dy luftërave botërore. Ato krijuan realitete të reja që konsistojnë në transformime regresive në lidhje me statusin social dhe politik të botës islame. Në kushtet e këtij realitete është ngjallur një frymë pasiviteti dhe bota islame kundrohet nga jashtë më shumë si objekt sesa si subjekt. E tillë është hapësira gjeopolitike, sistemet, individët drejtues, trajtimi aseteve kombëtare... Kjo situatë në botën islame në përgjithësi, lind rezultatit e të mosqenit vetvetja, në çdo fushë. Por që nga disa dekada e deri tani, ka një përpjekje pozitive për t'u bërë vetvetja. Tani bëhet fjalë për një përpjekje për të shpëtuar nga pasiviteti dhe të qenit objekt në duart e të tjerëve. Po përjetohen disa çrregullime, por unë i vlerësoj këto si dhembjet e lindjes.

Cilës çështjeje duhet t'i japin më shumë rëndësi myslimanët? Ku i kemi mangësitë?

Sigurisht se ngritja e nivelit të arsimit është shumë e rëndësishme. Ka një mangësi edukimi, ka një mangësi të kapitalit të njeriut të edukuar. Këto duhen eliminuar. Për t'u rritur rëndësia specifike e 1.5 miliardë myslimanëve, ka nevojë për njerëz të edukuar. Edhe në fushën e shkencave islame edhe në fushën e shkencave sociale e themelore, ka shumë nevojë për njerëz të përgatitur. Për këtë arsye, investimi më jetik, sipas meje, është investimi në arsim. Nëse do të ndërtohet një e ardhme që i ka hije historisë së botës Islame, kjo mund të arrihet vetëm me njerëz të përgatitur.

Kush janë tre mendimtarët e mëdhenj të islamit, prej të cilëve je ndikuar dhe je ushqyer më shumë dhe pse?

Në rini kam lexuar veprat e Nexhip Fazëllit, Sezai Karakoçit, Nurettin Topçuit, Bediuzzamanit dhe të Ihanëve. Por për të edukuar veten duhet

një lexim shumë më i gjerë. Për këtë arsye, nuk është e drejtë që t'i përkufizosh njerëzit me emra të kufizuar në këtë mënyrë. Klasikët e Lindjes e të Perëndimit, tekstet mistike, veprat në lidhje me politikën e botës, shënimet historike etj... gjithmonë duhet të jenë brenda fushës së leximit.

Shkrimet tuaja, rregullisht, takohen me lexuesit në revistën tonë. Çfarë ndjenje provon kur lexohesh në gjuhë të ndryshme dhe në vende të ndryshme të botës?


Kjo është një përgjegjësi e madhe. Mendoni, një njeri i cili takohet me *Etikën*, në sediljen e pasme të një taksie. Ai do të lexojë shkrimin tuaj dhe në botën e tij do të mbarten disa gjëra. Unë kam përgjegjësinë që ato gjëra të jenë të pastra. Që të transmetoj dritë në jetën e një njeriu. Me të vërtetë, kjo është një çështje shumë emocionuese dhe që të ngarkon përgjegjësi të madhe.

Me vëllezërit shqiptarë në Ballkan, historia e përbashkët ka qenë e gjatë. Cili është mesazhi juaj për popullin shqiptar?

Islami na ka bërë vëllezër. Jemi popuj vëllezër dhe hallkë rreth të të Dërguarit të Allahut. Jemi pasardhësit e heronjve të islamit, Selman, Bilal, Suhejb dhe Ebu Dherr... Për një turk është pasuri e madhe që të jetë vëlla me një shqiptar apo me një boshnjak, me një kurd, me një arab dhe me një mallaj. Unë mendoj se këto vëllazëri duhet t'i bëjmë më të fuqishme dhe më funksionale. Le të hamë ushqim së bashku, le të pimë ujë së bashku, të luajmë, t'i ndajmë bashkë gëzimet dhe hidhërimet tona. Përsëri, përsëri, përsëri...

Së fundi, cilat janë mesazhet që do t'u jepni lexuesve tuaj shqiptarë?

E di se atje, në jugun e Europës, ka zemra që ndajnë me mua të njëjtat ndjenja. I dua shumë. Uroj që ata të shpëtojnë një çast e më parë nga vështirësitë që kanë përjetuar dhe të jetojnë ditë shumë më të bukura. Fjala ime e fundit përsëri do të jetë mbi njeriun e përgatitur. Uroj që prej fëmijëve shqiptarë të dalin shkencëtarë, burra shteti, artistë dhe dijetarë islamë, me famë botërore.



Përkujdesja madhështore e Allahut

Shpëtim Kelmendi

Të përfshirë në rrjedhën e turbullt të botës materiale, njerëzit shpeshherë ankohen ndaj vështirësive të jetës, ndaj mungesave sado të thjeshta, ndaj padrejtësive, ndaj pamundësisë së realizimit të dëshirave, ndaj zhgënjimeve të ndryshme që u ndodhin gjatë harkut të shkurtër kohor në të cilin shtrihet ekzistenca e tyre. Në gjendje dëshpërimi ata humbasin durimin dhe ankohen me veten e tyre ose me zë, shpeshherë duke menduar se Zoti i ka lënë pas dore dhe në një farë mënyre i ka nxjerrë nga vëmendja e Tij. Kësisoj, me apo pa vetëdije, përbluajnë pakënaqësi brenda vetes dhe u duket sikur Zoti po vonon për t'u dhënë një përgjigje gjendjeve të tyre. Mungesa e durimit është një tipar që shfaqet tek njerëzit, për shkak të mosdijes, besimit të pakët, dashurisë së tepruar për dynjanë dhe mospasjen e një ideje të qartë mbi përmasat e pafundme të mëshirës që Allahu ka për krijesat e Tij.

Allahu i madhnueshëm, as nuk vonon e as nuk nxiton në përmbushjen e vullnetit të Tij që lidhet me krijimin dhe krijesat e gjalla, sepse Ai është gjithashtu edhe Krijuesi i përpikmërisë dhe përpikmëria Vetë. Allahu është i drejtë në përmbushjen e vullnetit të tij! Duke qenë se të gjitha cilësitë e tij kanë vlerë absolute, duke qenë se Ai është edhe krijuesi i vetë kohës,

është krejtësisht e pamundur që Ai të vonohet në përmbushjen e vullnetit të tij dhe të nevojave tona. Ndihma e Tij shfaqet në kohën e duhur, në vendin e duhur, në personin e duhur, me një saktësi dhe një masë të përkryer.

Allahu i di nevojat tona shumë më mirë se sa ne. Është pikërisht Ai, që na ka krijuar me dashurinë dhe mëshirën e Tij të pakrahasueshme, që kapërcejnë çdo lloj përfytyrimi njerëzor. Ai e do secilin prej nesh pafundësisht, më tepër nga sa ne arrijmë ta duam veten tonë, fëmijët tanë, të afërmit tanë. Shpeshherë, ajo që ne gabimisht konsiderojmë dashuri dhe mëshirë për veten, s'është gjë tjetër veçse ego e sëmurë, poshtërim i vetes dhe hapi i radhës drejt një vetshkatërrimi të pandalshëm. Mund të na duket sikur e duam veten dhe sikur po kërkojmë më të mirën për të, por në të vërtetë, në shumicën e rasteve ne thjesht e dëmtojmë veten tonë. Pavarësisht se kemi shumë dëshira të cilat shpresojmë t'i përmbushim, është veç Allahu Ai që e di se ç'është e mirë dhe ç'është e dëmshme për ne. Sa rëndë gabojmë kur sukseset tona në këtë botë ia

mveshim vetes dhe krenohemi me to, kur në të vërtetë, të gjitha falënderimet, të gjitha përlëvdimet, të gjitha adhurimet, i takojnë Atij, më të mirit, Allahut të madhnueshëm. Dhe Ai kurrë nuk urdhëron që ne ta adhurojmë për hatër të Tij, sepse Ai është i lirë nga çdo lloj nevoje për të qenë i adhuruar, sepse Ai është i Vetëdijshëm për të qenët shumë i Lartë. Ai do që ne ta adhurojmë e të besojmë në të, veç për hir të vetes sonë, për hir të asaj që na bën njerëz të vërtetë dhe besimtarë të devotshëm, që të meritojmë begatitë e Tij në këtë botë e në botën e përjetshme.

PROFETI MUHAMED (A.S.), LAJMËTARI I DRITËS

Nëse në hierarkinë madhështore të krijimit universal njeriu shfaqet si kurora më e lartë dhe si drita më vezulluese në konstelacionin e krijimit, Profeti Muhamed (a.s.), shfaqet si modeli më i përkryer dhe më i pakrahueshëm midis njerëzve që e kanë banuar ndonjëherë këtë botë. Ai ishte dhe mbetet një lajmëtar, por një lajmëtar i dritës, sepse lajmi hyjnor që ai solli, ka depërtuar përmes errësirës së epokave kohore të kësaj bote, si një shtizë e ndritshme, duke u hedhur përtej kohës e përtej imagjinatës. Duke qenë se zbatimi dhe përmbushja e porosisë së madhe që ai solli në këtë botë na mundëson lumturinë e botës së përjetshme, atëherë na rezulton se edhe lajmi që ai solli, pra Islami, është i përjetshëm. Po ashtu, Profeti Muhamed (a.s.), është ura e mrekullueshme e komunikimit që lidh vullnetin e Allahut me vetëdijen njerëzore, është një pikë e pashmangshme orientimi për të kuptuar dhe për ta ndjerë më qartë e më thellë dashurinë, mëshirën, bujarinë dhe drejtësinë e Allahut. Personaliteti i Profetit Muhamed përbën modelin më të mirë të mundshëm që duhet të ndjekim, nëse duam të arrijmë në majat më të larta të virtytit njerëzor. Zoti e begatoi botën tonë duke sjellë në të Profetin Muhamed (a.s.), i cili u shfaq me thjeshtësi, si të ishte njëri prej nesh, por i ngarkuar me një mision të jashtëzakonshëm të cilin nuk mund ta përmbushte askush tjetër përveç tij. Jemi mësuar të themi se ai ishte njëri prej nesh, që jetoj e vuajti në këtë botë si ne, por nuk do harruar se, përsa i takon fuqisë së besimit, bukurisë së virtytit, mirësisë, dhembshurisë dhe të gjitha cilësive të tjera, ai qëndron më lart se çdo krijesë njerëzore që ka jetuar apo që do mund të jetojë ndonjëherë në këtë botë. Në rrafshin njerëzor ai e mbështeti jetën e tij mbi një parim fare të thjeshtë, por që në të njëjtën kohë është parim madhështor: njësimi i fjalës me veprën. Kurrë në jetën e tij Ai nuk tha diçka të cilën s'e shndërroi në vepër, s'la pa përmbushur asnjë nga premtimet e tij dhe asnjëherë s'kërkoi nga të tjerët diçka të ci-



Personaliteti i Profetit Muhamed përbën modelin më të mirë të mundshëm që duhet të ndjekim, nëse duam të arrijmë në majat më të larta të virtytit njerëzor.



lën s'ia kish kërkuar më parë vetes. Ky personalitet i mrekullueshëm e kaloi jetën e tij në këtë botë me një thjeshtësi të paimagjinueshme që qëndron përtej përfytyrimit tonë mbi thjeshtësinë, duke u mjaftuar vetëm me të domosdoshmen dhe pa e njohur asnjëherë teprimin. Profeti Muhamed (a.s.), është një ndër bekimet më të mrekullueshme që Allahu i madhëruar i ka bërë njerëzimit.

MREKULLIA E BESIMIT NË ALLAHUN

Ka njerëz që jetojnë në këtë botë dhe mendojnë se janë të gjallë. Ata lindin, rriten, jetojnë, kryejnë funksione njerëzore normale, krijojnë marrëdhënie me njëri-tjetrin dhe me botën materiale që i rrethon. Aktiviteti i pareshtur që ata ushtrojnë gjatë ekzistencës së tyre, i bën të mendojnë se janë të gjallë. Por, prapëseprapë, për të pohuar se je gjallë, nuk mjaftojnë as këto e as një mori bëmash të tjera me të cilat njeriu krenohet e mburret gjatë ekzistencës së tij në këtë botë. Ata nuk e kuptojnë se vetëdija e tyre e të qenit gjallë nuk është gjë tjetër veçse një iluzion i mendjes. E pra, ajo që e përcakton qenien gjallë nuk është mendja, por zemra. Dhe jo çdo zemër, por vetëm ajo që është e mbushur me besim ndaj Allahut. Nëse



një zemër është e zhveshur nga besimi në Allahun, ajo është e vdekur. Dhe, nëse një zemër njerëzore është e vdekur, atëherë njeriu s'është hiç më shumë se hija e atij që duhej të ishte. Në këtë rast, njeriu nuk gjallon, por thjesht ekziston. Në këtë rast mund të thuhet se ai pothuajse nuk ka lindur fare!

Besimi në Allahun e Madhëruar është e vetmja mënyrë për të pohuar se jemi gjallë. Besimi në Allahun është lindja jonë e vërtetë, është udha e mrekullueshme e gjallnisë së përjetshme që shpaloset para nesh, është shfaqja më e bukur e ngjyrave, e tingujve dhe e bukurive hyjnore, është begatia më e madhe me të cilën Zoti mbush zemrat tona. Kur në zemër shfaqet besimi, marrin arratinë frika, arroganca, injoranca, ligësia, e sa e sa vese të tjera dhe në vend të tyre shfaqen dashuria, mirësia, dhembshuria, bujaria, bukuria, shfaqet prania e mrekullueshme e Zotit.

NJË PIKË UJI NË OQEANIN E NJËSISË SË ALLAHUT

Në një vështrim të parë, njeriu është një pikë e vogël uji. Ai e fillon ekzistencën duke u ngjizur nga një pikë uji, por edhe mbetet përnjëmend një pikë uji, nëse e krahasojmë me oqeanin e pafundëm të Njesisë së Allahut. Nëse qëndron e shkëputur, ajo mbetet diçka e vogël, e papërfillshme, e pavlerë, duke të kujtuar vazhdimisht një pikël vese që avullon çilembyll sytë nën rrezet e para të agimit. Një pikël uji është diçka, por një diçka e vogël dhe pa ndonjë vlerë të konsiderueshme.

Njeriu është diçka, por ç'vlerë ka kjo diçka, nëse nuk i bashkohet tërësisë për t'u shndërruar në gjithçka? Me përkushtimin e lartë shpirtëror, me besimin e thellë në Allahun, me asgjësimin e egos, e cila e mban të shkëputur e të veçuar duke e katandisur në diçka të vogël, me zgjimin e vetëdijes hyjnore, me rizgjimin e kujtesës shpirtërore të origjinës, kjo pikël e vogël uji përfshihet e tretet në oqeanin e pafundëm të njesisë së Allahut. Tashmë kjo pikël uji resht së qeni diçka e vogël dhe e pavlerë, madje resht së qeni diçka, për t'u bërë pjesë e madhësisë absolute. Pra, nëse mbetemi të veçuar e me ndjesinë se jemi diçka, kjo do të thotë se jemi thjesht të burgosurit e egos sonë. Por nëse shkrihemi në oqeanin e pafundëm të besimit në Allahun, atëherë mund të themi se jemi përjetësisht të lirë.

JETA TOKËSORE PËRBALLË PËRJETËSISË

Jeta e kësaj dynjaje është e shkurtër dhe e shpejtë si rrahja e krahëve të një fluturë. Përballë frymëmarrjes së përjetësisë, kjo jetë tokësore nuk zgjat as dhe një sekondë. Kjo jetë e shkurtër e kësaj bote nuk ka rëndësi në vetvete, por ka rëndësi në përgatitjen e njeriut për udhëtimin e pandalshëm të përjetësisë dhe të shkrirjes në njësinë e Allahut. Kjo jetë është provimi që secili prej nesh duhet të kalojë, për të shtyrë portën e përjetësisë e për të përqaftuar mrekullinë e pasosur të hyjnitetit e të begatave të Zotit. Allahu na e ka thënë këtë nëpërmjet librit, por po aq përsosmërisht na e ka përcjellë nëpërmjet mënyrës se si jetoi në këtë botë Pejgamberi i Tij më i lartë i dërguar ndonjëherë në këtë botë, profeti Muhamed (a.s.). Nëse ato që thuhet në Kuranin famëlartë kanë marrë ndonjëherë një formë të gjallë në mënyrë të plotë dhe janë trupëzuar tërësisht në një personalitet njerëzor, ky personalitet është pa asnjë dyshim profeti Muhamed (a.s.). Pra, ky zotëri i lartë është Libri i shndërruar në njeri. Ai jetoi në këtë botë, por nuk jetoi për këtë botë. Florudha e udhëtimit të tij e kapërcen ku e ku jetën tokësore dhe shkon në përjetësi. Ai nuk erdhi për të jetuar në këtë botë, nuk erdhi për ta shijuar këtë botë, nuk erdhi për t'u lidhur pas kësaj bote, por erdhi thjesht për të na mësuar si jetohet dhe për të na kujtuar se jeta e kësaj bote është veçse një hije e zbehtë e botës së vërtetë, se jeta e kësaj bote është vetëm një tingull i vetëm përballë simfonisë së jashtëzakonshme të përjetësisë. Dhe të gjitha këto i bëri duke u hedhur përtej kuptimit të rëndomtë të fjalëve. Ai nuk tha fjalë, por u shndërrua në Fjalën. Dhe Fjala e tij ishte gjest, dhe Fjala e tij ishte vepër, dhe Fjala e tij ishte një mënyrë e përkryer të jetuari, e cila do të mbetet shembull i gjallë për njerëzit në të gjitha kohët, përtej kohëve, në jetë të jetëve.



Le të jetë e vogël por të jetë për Allahun

Mustafa Erish

Siç transmetohet, Ebu Mansur bin Zukejr (Allahu e mëshiroftë), ishte një njeri i devotshëm dhe i sinqertë. Gjatë viteve të fundit të jetës qante shumë dhe nuk i përmbante dot lotët. Një ditë e pyetën:

- Përse po qan tani që po të afrohet vdekja?

- Sepse po shkoj në një udhëtim që nuk e kam bërë më parë. Unë nuk e di se me çfarë do të përballem atje dhe nuk e di nëse veprat e mia do të më bëjnë dobi apo jo. Duke menduar këto, zemra ime drithërohet, shpirti më digjet dhe nuk i mbaj dot lotët.

Pasi ndërroi jetë, djali i tij e pa në ëndërr dhe e pyeti:

- I dashur baba, si të priti Allahu?

- O biri im! Nuk është aspak ashtu siç kujton. Të japësh llogari është diçka shumë e vështirë. Veprat e të gjithë jetës sime nuk më bënë dobi. Më Mëshiruesi i mëshiruesve, më i Drejti i të drejtëve, Zoti im urdhëroi dhe më tha:

- O Ebu Mansur! Unë të fala 70 vite jetë. Çfarë ke sjellë me vete sot?

- O Zot, bëra 30 herë haxhin - thashë unë.

- Nuk t'i kam pranuar ato - tha Ai.

- O Zot, kam dhënë lëmoshë 40 mijë dirhem me dorën time.

- Edhe ato nuk t'i kam pranuar.

- Në 60 vite të jetës sime, ditën kam agjëruar dhe natën kam bërë adhurim.

- Edhe ato nuk t'i kam pranuar .

- Atëherë unë jam prej të humburve, o Zoti im!

Pas këtyre fjalëve, Zoti im më tha:

- O Ebu Mansur! Ke bërë shumë vepra të mira, por çdo vepër mban erë hipokrizi dhe sëmundja e hipokrizisë i çon dëm të gjitha veprat e mira. I bën ato të pavlefshme. Prandaj dhe veprat e tua nuk të bënë dobi dhe shkuan dëm. Mirëpo, nuk i shkon Bujarisë Sime të të dënoj, pas gjithë këtij mudi që ke bërë. Ndër veprat e tua, ke një vepër e cila nuk është përlyer me hipokrizi. Ajo vepër që ke kryer

vetëm për kënaqësinë Time, është shkak i mëshirës Sime ndaj teje.

A e kujton atë ditë kur hoqe nga rruga një gur, me qëllim që të mos pengohej ndokush dhe të mos dëmtohej ndonjë krijesë? Ja pra, për shkak të asaj pune që e ke kryer me sinqeritet, Unë të mëshirova dhe të shpëtova nga dënimi dhe humbja. S'ka dyshim se Unë e shpërblej dhe nuk ia humb askujt punën e tij të mirë, qoftë ajo edhe sa një grimcë. Mjafton që puna apo vepra që kryen, qoftë edhe e vogël, të bëhet për kënaqësinë Time.

Nga kjo histori kuptojmë se një vepër e vogël, siç është heqja e pengesave nga rruga, nëse bëhet me sinqeritet, bëhet shkak i mëshirës së Allahut. Kjo do të thotë se, t'i lehtësosh vështirësitë një njeriu, bëhet shkak për një mëshirë dhe falje më të madhe.

Profeti (a.s.) ka thënë:

"Kush largon vështirësitë e një besimtari në këtë botë, Allahu do t'i largojë vështirësitë e tij në botën tjetër..." (Muslim, Dhikr, 38.)

Ndërsa në një hadith tjetër ka thënë:

"Bëhu i sinqertë në fenë tënde! Nëse bëhesh i tillë, të mjaftojnë edhe pak vepra të mira" (Hakim, IV, 341.)

Prandaj e kemi për detyrë që të veprojmë me sinqeritet dhe të mundohemi t'u largojmë vështirësitë vëllezërve tanë. Duhet të luftojmë me egon dhe shejtanin, që të shkojmë në botën tjetër pa dëmtuar dhe pa fyer askënd dhe veçanërisht myslimanët, fëmijët dhe familjen. Islami kërkon prej nesh këto mirësi dhe kjo duhet të jetë sjellja e një myslimani.

Profeti (a.s.) ka thënë:

"Mysliman është ai, që prej gojës dhe dorës së tij, janë të sigurtë myslimanët e tjerë." (Buhari, Iman, 4; Muslim, Iman, 65.)

Allahu na ruajtë prej urrejtjes dhe mendjemadhësisë, prej hipokrizisë dhe zilisë dhe na bëftë myslimanë të sinqertë dhe të sigurtë për të tjerët. Amin!



Fugia dhe MENDJEMADHËSIA

Xhemal Nar

Mendjemadhësia është diçka që njeriu e do kur e ka vetë, por e urren kur e kanë të tjerët. Por ana më e rrezikshme e mendjemadhësisë, që pak a shumë gjendet në çdo njeri, është se njeriu nuk e dallon lehtë, kur ajo ndodhet tek vetë ai. Ndërsa kjo është ana më “naive” e mendjemadhësisë.

Me fjalën mendjemadhësi nënkuptohet mburrja, kryelartësia, fodullëku, krekosja, krenaria e tepërt, arroganca dhe mashtrimi i vetes. Po, mashtrimi i vetes! Të gjithë njerëzit mendjemadhënj dhe arrogantë, janë njerëz që mashtrojnë veten e tyre. Janë ata që e mbajnë veten për të mëdhenj ose kujtojnë se ndodhen në një pozitë më të lartë seç janë dhe, kur u kap këmba bosh, poshtërohen dhe bëhen rezil para gjithë botës. Ky është mashtrimi i tyre.

Në fakt, përpjekja e njeriut për t’u bërë “njeri i madh”, pa rënë pre e mendjemadhësisë, duke përballuar vështirësitë e brendshme dhe të jashtme, duke shtrënguar dhëmbët për të realizuar me durim qëllimin, duke mbajtur lart moralin dhe duke iu mbështetur Allahut me gjithë vetëbesimin që zotëron, është diçka për t’u lavdëruar.

Për t’u bërë i madh, njeriu duhet të studiojë, të mendojë, të shoqërohet dhe të këshillohet me njerëz të ditur dhe ta jetojë jetën brenda një plani dhe disipline të caktuar. Këto janë të domosdoshme. Asnjë sukses nuk është i lehtë dhe i rastësishëm. Lumturia varet nga niveli i suksesit.

Ky sukses dhe kjo lumturi e merituar, padyshim që është diçka e bukur, që ia vlen të lavdërohet. Nëse e kërkon puna, duhet të lavdërohet dhe të merret si shembull. Por këtë duhet ta bëjnë të tjerët, sepse nuk është e hijshme që dikush të lavdërojë dhe të vlerësojë veten e tij. Kështu i hapet dera edhe mendjemadhësisë.

Nëse njeriu u përmbahet atyre që thamë më lart, veprimi i tij nuk quhet mendjemadhësi apo arrogancë. Por, nëse dikush mundohet ta tregojë veten e tij më lart se të tjerët, si të ishte “i pazëvendësueshëm”, atëherë ky veprim, jo vetëm që do të ishte i turpshëm, por edhe qesharak.

Mendjemadhësia është injorancë. Është një perde që mbulon mendjen. Njeriu mendjemadh, në të shumtën e rasteve është një fodull, i cili nuk i dallon dot ata që e lavdërojnë nga ata që e tallin

apo e ofendojnë. Nëse dikush të lavdëron, duke të veshur cilësi dhe pozitë që nuk i zotëron apo të uron për suksese që nuk i ke arritur, kjo do të thotë se ai po tallet dhe po të vë në lojë. Por për arsye se mendjemadhi nuk e kupton këtë, pranon të mbajë rreth vetes dhe të ushqejë shumë servilë dhe hipokritë, të cilët nuk e duan aspak dhe vazhdimisht tallen me të.

Ajo që i ka hije njeriut, është të tregohet modest, edhe nëse është i madh. Këto janë virtyte që e bëjnë të madhin edhe më të madh. Njerëzit me të vërtetë të mëdhenj, e çmojnë njeriun dhe dinë ta vlerësojnë. Ata ruhen nga veprimet që do t'ua ulnin vlerat. Nuk u japin rëndësi komplimenteve që u bëjnë të tjerët, pasurisë, famës dhe pozitës. Ruhen nga fjalët dhe veprimet e parëndësishme dhe nuk përzihen kurrë në ngjarje të tilla. Ata nuk ndjejnë nevojë për lajka dhe gjithmonë e ruajnë nderin dhe e mbajnë atë më lart se çdo gjë.

Nëse njeriu mendon mirë, e kupton se mendjemadhësia është me të vërtetë budallallëk. Të vjetrit, për të thyer mendjemadhësinë e dikujt, thoshnin: "Fillimi yt është veç një pikë uji, ndërsa fundi yt një cofëtinë që kundërmon erë të keqe. Ç'të bën të krekosesh kaq shumë?" Në të vërtetë, dora e njeriut, këmba, vetulla, syri, madje i gjithë trupi, vendi dhe shoqëria ku jeton, ekzistojnë plotësisht jashtë vullnetit të tij. Pra, si mund të mburret dikush, kur nuk ka asnjë meritë në krijimin e tyre?

Ndërsa mirësitë, si dija dhe pasuria, që pjesërisht fitohen me punë, nuk janë të qëndrueshme. Kemi parë me qindra njerëz që i harrojnë krejt ato që dinë ose u ikën mendja. Gjithashtu kemi parë edhe shumë të pasur që varfërohen. Prandaj njeriu me mendje dhe logjikë të shëndoshë nuk mburret me këto.

Madhështia është një atribut që i ka hije vetëm Allahut, i cili krijoi gjithçka nga asgjëja. Ajo që i lartëson të tjerët përveç Tij, është modestia dhe thjeshtësia. Ja pra, për këtë arsye, mendjemadhësia më e keqe është ajo që gjendet tek dijetarët, të cilët duhet ta njohin mirë këtë fakt.

Një herë ishim mbledhur dhe po bisedonim me njëri-tjetrin. Njëri prej nesh, i cili është edhe mësues në fakultetin teologjik, sa herë që merrte fjalën, fillonte me "ne akademikët" dhe theksonte se ne të tjerët nuk ishim të tillë. Por, nga fodullëku i tepërt nuk e kuptonte se tashmë e thërrisnim "ne akademikët" dhe nuk e shihte se asnjëri prej nesh s'e donte me gjithë shpirt. Por a janë të gjithë aka-



demikët kështu? Sigurisht që jo. Ka edhe prej atyre njerëzve të ditur, por modestë, që fillojnë të flasin me "më falni".

Jo çdo i pasur është mendjemadh, por ka të tillë që nuk mund t'u afroresh, prej arrogancës. Pranë tyre mund të qëndrojnë vetëm servilët dhe grykësit. E pyetën njërin prej tyre: "Si duroni?" Duke qeshur tha: "Kafshata qyl është e shijshme".

Një komandant në pension ende jep urdhra, kur bisedon me dikë. Kujt? Vëllezërve, komshinjve dhe shokëve. Përreth tij veç buzëqeshje tallëse sheh, por ai nuk mund ta harrojë gradën që kishte...

Ata që e vendosin veten artificialisht në pozita të larta dhe ndihen shumë lart, kur bien në humnerë dëmtohen dhe poshtërohen më shumë. Mendjemadhësia bëhet më e keqe, kur ndodhet tek njerëzit e fuqishëm. Nëse dikush zotëron edhe fuqi edhe mendjemadhësi, nga ai duhet të kesh frikë dy herë. Të gjithë diktatorët, mbretërit tiranë dhe ushtarakët fashistë, anarkistë dhe terroristë janë të kapluar nga këto komplekse.

Ajo që urrej më tepër është servilizmi i intelektualëve, i dijetarëve, i mediave dhe i burokratëve të lartë ndaj personave (të fuqishëm) e mendjemëdhenj dhe nxitja e tyre në veprime të gabuara. Në fakt, detyra e tyre është t'i paralajmërojnë këta njerëz me pushtet dhe me cilësi mendjemadhësie. T'i bëjnë ata t'u nënshtrohen rregullave dhe të ruajnë besimin dhe forcën e ligjit. Epërsia e demokracisë mbi diktatin është diku në këto vija.

Nuk duhet ta anashkalojmë moralin dhe nuk duhet ta nënvleftësojmë fenë tonë, e cila është burimi i tij. Përndryshe na del përpara si "fatkeqësi" në çdo çast të jetës. Kjo është për sa i përket kësaj bote. Por kemi edhe botën tjetër, e cila ekziston, pavarësisht nëse ti i beson apo jo asaj...



Edison Çeraj

KULTURA MASIVE

Për çfarë kulture bëhet fjalë? Apo kemi të bëjmë vetëm me një aspekt të qytetërimit?

Në vijim do përpiqemi të provojmë se e ashtuquajtura kulturë masive apo popullore, nuk është gjë tjetër vetëm se një ndër shumë fytyrat e qytetërimit (*civilization*). Pra një aspekt tipik i tij përgjatë shtrirjes dominuese mbi jetën tonë, aq më tepër sot, kur kjo kulturë përfaqësohet përmes spektaklit, mekanizmat e të cilit njohin vetëm evoluimin, të përcaktuar si progresiv, por të papërcaktuar në rrafshin teleologjik.

Në fjalorin sociologjik të Gordon Marshall, kur kërkon për 'kulturën masive', udhëzimi tregon për të konsultuar zërin "kultura popullore", duke vënë kështu shenjën e barazisë ndërmjet këtyre dy nocioneve, që mendojmë se nuk është e njëjta gjë, siç do të përpiqemi ta provojmë nga trajtesa, por edhe nga një shpjegim tjetër, po nga një fjalor sociologjik, autori i të cilit e ka veçuar si zë më vete "kulturën masive". Por le ta citojmë këtë zë, për t'i rikthyer në vijim ndryshimit midis dy nocioneve:

"Kultura është koncepti qendror i antropologjisë

dhe tregon krejt dijen, teknologjitë, vlerat, besimet, zakonet dhe sjelljet e përbashkëta të njerëzve. Nëse shoqëritë e thjeshta mund të kenë një kulturë të vetme të integruar, që është e përbashkët për të gjithë, shoqëritë komplekse mund të pranojnë shumë shtresa dhe nivele kulturash dhe nënkulturash. Një nga dallimet e rëndësishme është ai ndërmjet kulturës popullore dhe asaj që zakonisht quhet kulturë e lartë. Në këtë të fundit hyjnë gjëra të tilla si muzika klasike, romanet serioze, poezia, baleti, arti i lartë dhe produkte të tjera kulturore që çmohen zakonisht nga një numër relativisht i vogël njerëzish të shkolluar (ose "me dije" – E. Ç.). Kultura popullore, ndonjëherë e quajtur kulturë masash, është shumë më e përhapur dhe më e rrokshme për këdo. Puna kryesore e kulturës popullore është zbatimja, ndërsa në Evropë dhe në Shtetet e Bashkuara (p.sh.) mbizotërohet nga sportet, televizioni, muzika popullore e regjistruar. Tradicionalisht, që nga Wordsworth-i e këtej, janë ankuar për cilësinë e mjerueshme të kulturës popullore. (...)"

Kurse të *Fjalori i sociologjisë*, i Ali Pajazitit, lexoj-

më këtë interpretim:

"Kultura masive (mass culture) – Kategori që përfshin shenjat specifike dhe veçantitë e prodhimit shpirtëror e material, të orientuara drejt masives, popullores, zbavitëses, kalimtares dhe pas asaj që, tërësisht ose pjesërisht, është më pak e rëndësishme, sipas A. Kloskovska-s, kultura masive përbën një tërësi të përmbajtjeve kulturore, të shpërndara përmes mjeteve të komunikimit masiv në mjediset e shoqërive bashkëkohore të industrializuara dhe të urbanizuara, që karakterizohen nga vlera të caktuara të masave dhe të "dendësisë" shoqërore. Ky term lidhet me shoqërinë industriale, me prodhimin serik, i cili ndryshe nga prodhimi individual, nuk ka origjinalitet. Dihet se prodhimi serial vlerësohet vetëm nga këndi i konsumit (numri i konsumatorëve). Tregu është rregullatori kryesor i prodhimeve të kulturës masive, si ushqimi, veshmbathja, mobiliet, muzika, letërsia, filmat, sporti etj. Kjo kulturë, të cilën G. Greenberg-u e barazon me biçin, ka lindur atëherë kur kultura popullore humbi kuptimin e vet dhe vendi i saj është plotësuar me produkte që sjellin me vete konsumimin dhe sjelljen e njëtrajtshme. Ky lloj i kulturës mbështetet fuqishëm, apo më mirë, imponohet dhe përcillet anekënd botës përmes mjeteve të komunikimit masiv. Kultura masive e humb largësinë mes grupeve shoqërore, krijon konsumatorë masivë, bën internacionalizimin e (jo)vlerave kulturore, bën kushtëzimin e njerëzve që t'i përdorin "të mirat e teknologjisë", krijon kohë të lirë¹, e ndryshon hierarkinë e vlerave. Kultura masive e zhdruk frymën krijuese të kulturës në formësimin e jetës shoqërore, këtë cilësi qenësore të kulturës së vërtetë. Kultura masive nuk krijon kënaqësi të vërtetë shpirtërore, nuk kërkon kurrfarë mundimi, nuk kërkon

1. 'Koha e lirë' është një shpikje gjeniale për pushtetin, pasi edhe atëherë kur njeriu del nga mekanizmat e tij kontrollues (kopshti, shkolla, universiteti, puna, rregullat e qarkullimit, detyra etj.), është i shtrënguar të bjerë në mekanizma të tjerë, sepse koha e lirë është e përcaktuar: të bësh një shëtitje (për ata që kanë ku e bëjnë), të shkosh në kinema, në ndonjë ndeshje sportive (perandorët duan të argëtohen), të bësh pazar (shopping) etj.

asgjë nga klientët, pos parave të tyre. Popullariteti i kësaj kulture është rezultat i faktit se ajo është zbavitëse dhe informative, nuk krijon ndonjë kënaqësi më të thellë estetike ose ndijore, por i kënaq vetëm shtresat sipërfaqësore të nacionalitetit dhe emocionalitetit. Kultura masive pengon kontaktin e vërtetë me botën; bombardimi me informata, të cilat s'është e thënë të jenë të sakta ose të vërteta, e çon njeriun në shkarje që ai të mendojë se është i informuar për botën në të cilën jeton, se është i lirë dhe se në mënyrë krijuese e shfrytëzon kohën e vet të lirë. Për Morin-in, kultura masive luan rolin e mitologjisë së shekullit tonë, sepse është anti-utopike, antivizionare dhe sipërfaqësore, e ndan fantazinë e jetës dhe e shndërron në fushë të ikjes dhe të kompensimit."

E pamë të udhës që t'i sjellim këto dy shpjegime, sepse plotësojnë njëri-tjetrin, pra atë paqartësi ose mangësi që mund të vërejmë te njëri, e gjejmë të trajtuar tek tjetri. Ajo që është me peshë, është fakti se nga këto dy shpjegime, pak a shumë, ne kemi kuptuar ku qëndron ndryshimi mes kulturës masive dhe asaj popullore.

Megjithatë, le ta shohim më gjerë nocionin dhe realitetin praktik të kulturës masive.

Subjekti i çdo kulture është njeriu si individ, si personalitet, si individualitet i papërsëritshëm. Ndërkohë, subjekti (ose objekti) i kulturës masive është masa ose "njeriu-masë"². Njeriu mbart shpirtin, ndërsa masat nevojat. Prandaj mund të kundrojmë se si çdo kulturë shënon ngritje, pra përsosje të njeriut; kurse kultura masive priret drejt plotësimit të nevojave.

Kultura rreh për individualitetin, ndërsa kultura masive ndjek të kundërtën: për njësimin (*uniformization*) shpirtëror. Në këtë pikë, kultura masive

2. Nocioni "njeriu-masë" i përket Ortega Y. Gasset-it. Masa është një turmë e individëve anonimë. Kur një turmë njerëzish humb personalitetin, degradon në masë. Njeriu-masë është produkti përfundimtar i qytetërimit të zhveshur, gjendje në të cilën, nuk ka më dyshime dhe "paragjykime" të kulturës.



veçohet me etiketë, kështu që pashmangshëm ndahet nga kultura. Kultura masive ka ngritur një mekanizëm të madh për të arsimuar, por jo për të edukuar. Përmes prodhimeve në seri të të ashtuquajturave të "mira shpirtërore" dhe me *kitsch*-in; me të pakuptimtën për individualen, ajo shpie drejt mënjanimin të thelbit të kulturës dhe drejt një shpërftyrimi të saj në mendjet e njerëzve. Ndryshe nga kultura autentike, kultura masive e ngushton lirinë njerëzore pikërisht me prirjen për njësim/standardizim, pasi liria mbetet përherë kundërshtuese e standardizimit. (Horkheimer)

Një nga paragjykimet e përhapura, është edhe vënia e shenjës së barazisë midis kulturës masive dhe asaj popullore, që, me sa duket, përbën padrejtësi ndaj së dytës. Ndryshe nga kultura masive³, kultura popullore është burimore, veprimtare dhe e drejtpërdrejtë. Ajo nuk e njeh *kitsch*-in dhe prodhimin në seri, dukuri tipike të jetës urbane. Kultura popullore bazohet tek marrëveshja, kurse parimi mbizotërues i kulturës masive është manipulimi. Ritet, vallet apo këngët, janë çështje e përbashkët e fshatit ose e fisit: nuk ka ekzekutues në njërin anë dhe dëgjues e shikues në anën tjetër; kur nis kremtimi, përfshihen të gjithë; të gjithë janë pjesëmarrës. Kultura masive na jep një shembull krejtësisht të kundërt: njerëzit janë të ndarë rreptësisht në "prodhues" dhe "konsumues" të "të mirave" kulturore. A ekziston ndonjë që mendon se mund të ndikojë vërtet në përmbajtjen e programeve televizive, nëse nuk bën pjesë në atë grup të vogël e të ngushtë njerëzish që ndërton programet? Të ashtuquajturat mjete të komunikimit

3. Shih: *The culture industry – selected essays on mass culture*, vepër e Th. W. Adorno-s

masiv, si: shtypi, radioja, televizori dhe interneti, në fakt janë mjete të manipulimit masiv. Nga njëra anë kemi bordet që krijojnë programet, në anën tjetër një auditor prej miliona njerëzish pasivë. (Izetbegović, 1990)

Një anketë e vitit 1971 tregoi se një anglez mesatar qëndron para televizionit 16 deri në 18 orë në javë, po sot – sigurisht që kjo kohë është trefishuar.⁴ Një ndër tre francezë nuk arrin të lexojë kurrë një libër të plotë; ndërkohë që, përgjithësisht, pjesën dërrmuese të kohës francezët e kalojnë para ekranit të televizionit.⁵

Një sondazh i bërë me rastin e "Javës së librit", në vitin 1975 në Japoni, dëshmon një situatë të njëjtë. Rreth 30 % e japonezëve nuk arrijnë të lexojnë një libër të vetëm, ndërkohë që para televizionit qëndrojnë mesatarisht dy orë e gjysmë në ditë. Prof. Horikava, nga Universiteti i San Franciscos pohon se niveli i brezit të ri është nën kriteret universitare. Këtë dukuri Horikava e shpjegon kështu: "Televizioni zëvendësoi letërsinë dhe meditimin; zvogëloi veprimtarinë e brendshme dhe në përgjithësi pengoi intelektin. Ai jep zgjidhje të gatshme për të gjitha çështjet e jetës."

Koha jonë ofron shembuj të shumtë se, si mjete masive, si televizori dhe interneti, aty ku janë në dorë të pushteteve të caktuara, kryesisht ekonomiko-politike, ia dalin me shumë përdëllim e delikatesë të akullt, të fabrikojnë idhuj (që perëndojnë) e sajesa nga më të paimagjinueshmet për t'u "shërbyer" njerëzve. Sot nuk ka më asnjë nevojë të përdoret gjuha e dhunës së vrazhdë për të sunduar një popull kundër vullnetit të tij. Tanimë kjo arrihet "në mënyrë të ligjshme", duke paralizuar vullnetin e njerëzve; duke ofruar për masat e topitura "të vërtetat" e gatshme e gjysmë të gatshme, ku me aktivitete (ndërgjegjësuese, emancipuese, kulturore etj.), mitingje dhe argëtime vulgare, u merret koha për të shëstuar e për t'u përpjekur të formojnë opinionin e vet për njerëzit dhe ngjarjet.

Psikologjia e masave na mëson dhe praktika e

4. Të dhënat janë nga publikimi "Synimet e shoqërisë", vjetari statistikor i qeverisë angleze.

5. Këto janë përfundimet e të përkohshmes "Le point" (1975), ku shihet se mbi 87 % e popullsisë kanë si argëtim kryesor "kulturor" televizionin, dhe në fund të listës gjenden opera dhe baleti.

vërteton, se përsëritjet e vazhdueshme me ngulm, mund t'i bindin njerëzit për mite e iluzione që s'kanë kurrfarë lidhjeje me realitetin e jetuar. Psikologjia e mjeteve masive të komunikimit, në veçanti televizioni, kahet për të nënshtruar, jo vetëm pjesën e vetëdijshme të njeriut, por edhe pjesën instinktive dhe emocionale, për të krijuar kësisoj ndjesinë që zgjedhja e imponuar të konsiderohet si e tij. (Izetbegović)

Sistemet totalitare e shihnin si një shans të madh televizorin, prandaj dhe e shfrytëzuan aq **sistematikisht** atë. Kështu, televizori si i tillë, e rrezikon lirinë më shumë se policia, burgu dhe kampet e dikurshme të përqendrimit.

Ka të ngjarë që brezat e ardhshëm, nëse nuk u asgjësohet plotësisht aftësia për të menduar lirisht, do përjetojnë një neveri të madhe nga martirizimi që po vuan brezi i sotëm, brez i cili iu nënshtrua ndikimit të pakufishëm të kësaj fuqie të pakontrolluar. Në qoftë se në të kaluarën kushtetuta bëhej për të penguar pushtetin e pakufishëm të sundimitarit apo të regjimit në përgjithësi, sot nevojitet një kushtetutë e re për të gjithë botën, për të penguar pushtetin e këtij rreziku të ri që kërcënon të ushrojë robërinë më të papë shpirtërore.

Kultura masive shkakton një gjendje shpirtërore, të cilën Johan Huizinga e ka quajtur *puerilism*⁶. Huizinga doli në përfundimin se njeriu i sotëm sillet si fëmijë, në kuptimin negativ të fjalës, domethënë, shkalla e tij mendore është si e një adoleshenti: argëtime banale, nevoja për sensacione të forta, prirja për parada masive dhe slogane, mungesa e humorit të mirëfilltë, narkoza që përjeton nga mallrat kallpe, fjalë ekstreme për urrejtjen dhe për dashurinë, mallkime dhe lëvdata gjithaq ekstreme dhe të përdorura vend e pa vend, brutaliteti në rritje etj.

Në këtë kontekst shfaqet dhe një raport i ndryshëm ndaj makinerisë dhe teknikës. Te kultura hasim "frikën nga makineria", refuzimin instinktiv të teknikës. Teknika është mëkati i parë i kulturës. (Berdyayev) Ky qëndrim përvijohet nga fakti se makineria, duke manipuluar sendet, manipulon dhe njerëzit. Le të kujtojmë këtu paralajmërimet

6. Sipas fjalorit *Dictionary.com* (<http://dictionary.reference.com/browse/puerilism>) në internet, *puerilism*-i shpjegohet si 'sjellje foshnjore ose djaloshare e një të rrituri'.

Teknika është mëkati i parë i kulturës. Ky qëndrim përvijohet nga fakti se makineria, duke manipuluar sendet, manipulon dhe njerëzit.



e Tagore-s, Tolstoy-t Heidegger-it, Neizvestny-t, Faulkenr-it etj. Nga ana tjetër, marksisti Henry Léfèbvre gjykon ndryshe: "Shkalla më e lartë e lirisë do arrihet në atë shoqëri, ku teknika do të zhvillojë të gjitha mundësitë e veta – në shoqërinë komuniste." Ajo shoqëri, e cila merr si model të afërm e të largët utopinë, domosdo që do bëjë aleancë me makinerinë dhe teknikën. Teknika ofron një ndihmë (nuk kundërshton në asnjë rast) *sui generis* për të manipuluar njerëzit dhe sendet. Ajo jep një kontribut të pazëvendësueshëm për konformizmin dhe uniformizimin, që arrihet me anë të arsimit dhe medimeve masive (shtypi, radioja, televizioni dhe interneti); ajo kërkon bashkëpunim (ose punë të përbashkët) me një numër të madh njerëzish, të organizuar në një mekanizëm të ngjashëm dhe identik (grupi, kolektivi, stafi, bordi), të udhëhequr **sistematikisht** në formë centraliste, dhe tekembramja, në perspektivë ajo premtion kontrollin e plotë të shoqërisë (në fakt të pushtetit) mbi individin, përmes një vëzhgimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë mbi veprimtarinë, të folurit dhe të menduarit e tij.

Kësisoj, nëse teknika rrezikon dikë apo diçka, atëherë ajo rrezikon personalitetin e lirë; ajo nuk e rrezikon kurrë anëtarin anonim të një kolektivi/stafi, funksioni i të cilit (është) realizohet përmes prodhimit dhe konsumimit, pikërisht dhe konkretisht për të përsosur mënyrën dhe teknikën me të cilën prodhon dhe konsumon.

Referencat:

- Adorno, Th. W. (2005) *The culture industry – selected essays on mass culture*. Londër: Routledge.
- Izetbegović, A. (2000) *Islami ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit*. Shkup: Logos-A
- Marshall, G. (2009) *Fjalor sociologjik*. Tiranë: IDK.
- Pajaziti, A. (2009) *Fjalor i sociologjisë*. Shkup: Logos-A.
- Zecchi, S. (2006) *Njeriu është çka ai sheh*. Tiranë: Max.

Besimi islam në dritën e njohjes racionale

Nexhat Ibrahim

JETA NË VARR, NJË HAP DREJT RINGJALLJES

Si dëshmi kundër ekzistencës së jetës pas vdekjes (Berzah, disa njerëz me mendje të kufizuar) marrin atë që njeriu me shqisa nuk mund ta njohë, faktin që te i vdekuri nuk vërehen kurrfarë shenja vuajtjesh apo dëfrimesh, që nuk shihen pranë tij melekët duke e marrë në pyetje, që nuk është parë varri i tij të ngushtohet apo zgjerohet dhe vrojtime të tjera të ngjashme. Mirëpo, përgjigjja nuk është aq e ndërlikuar sa duket në shikim të parë. Me fjalë të tjera, atyre do t'u thuhet se Allahu i madhërishtëm ka përcaktuar tri stacione (vendqëndrime) për njeriun: 1. *Dunjaja* (kjo botë), *Berzahu*¹ (bota në varre pas vdekjes e deri në ringjallje) dhe *Dar'ul-karari*, vendqëndrimi në të cilin përhershmerisht do të qëndrojë pas ringjalljes. Për secilin nga këto

1. Berzah nga gjuha arabe do të thotë: Pengesë, barrierë, pengesë ndërmjet dy objekteve apo vendeve; gjendje e ndërmjetme. Në aspektin përmbajtësor *berzah* do të thotë pika e kalimit ku të ngjashmit, por entitete të ndryshme, paraqiten së bashku. Periudha pas vdekjes, pas largimit të shpirtit nga trupi dhe para ringjalljes, kiametit. Edhe Kurani e përmend në disa raste në kontekste të ndryshme: 25, 53; 55, 19-20; 23,99-100. Sipas: Nexhat Ibrahim, Leksikoni Islam, Vepra 9, Shkup, 2009.

vendqëndrime ka vendosur ligjshmëritë përkatëse. Sa i përket kësaj bote, Ibn Kajjimi² shpjegon se Zoti e ndërtoi njeriun prej trupit dhe shpirtit dhe dispozitat e përcaktimet në këtë botë i ka lidhur me trupat, duke i vënë shpirtrat në plan të dytë. Kështu ne pranojmë vetëm atë që ka shprehur gjuha ose që ka bërë ndonjë organ, qoftë kjo edhe kundër asaj që shpirtrat fshehin në vete. Nga ana tjetër, ligjshmëritë që ekzistojnë në *berzah* pranojmë në mënyrë primare shpirtrat, deri sa trupat janë në plan të dytë. Në *berzah* shpirti ia përcjell trupit ëndjet dhe vuajtjet, sikurse në këtë botë ëndjet dhe vuajtjet ia përcjell trupi shpirtit.³ Këtë do të mund ta kuptojmë pak a shumë edhe nga shembulli i kësaj bote. Çaste të këndshme apo të trishta që njeriu përjeton në gjumë, korrespondojnë me shpirtin e tij, duke e lënë trupin në plan të dytë, vetëm si pjesë dytësore të suitës. Ndosht që njeriu pas gjumit të paretshëm të ndihet i lodhur. Kjo do të ndodhë edhe në *berzah*. Dhembja do të ndihet edhe në trup, por në mënyrë më të

2. Shih: Ibnu'l-Qajjim El-Džewzije, Knjiga o duši, poglavlje o Berzahu, Sarajevë, 2003.

3. Po aty.

drejtpërdrejtë. Kjo do të ndodhë edhe më dukshëm në ringjalljen në Ahiret. Edhe pse arsyeja këtu nuk ka hapësirë, meditimi më i thellë tregon se ringjallja është e arsyeshme. Nëse dikush do të kundërshtojë, problemi është tek ai që botën përtej e ngatërron me kriteret e kësaj bote.⁴

RINGJALLJA DHE DHËNIA E LLOGARISË

Ringjallja ekziston. Këtë e dëshmon ky rend i mrekullueshëm hyjnor, i cili përfshin gjithë universin, ku çdo gjë funksionon sipas planit të krijuar urtësisht. Ky rend funksionon në gjërat e mëdha dhe të vogla, deri te elektroni. Pse të ekzistojë ringjallja? Besimtari do të thotë se ajo do të vijë. Këtë e kërkon jeta jonë e padrejtë në këtë botë. Ndjenja për drejtësi e për barazi na çon në përfundim se ajo ekziston dhe do të vijë, por jo në këtë botë, e cila është, sikurse edhe vetë njeriu, me mangësi e kufizime. Ne e ndjejmë këtë nevojë, por nuk e njohim, sikurse ndjejmë nevojën për drejtësi absolute, edhe pse nuk e kuptojmë thelbin e saj. Ajo është absolute dhe e botës përtej, kurse perceptimi ynë është i kësaj bote dhe joperfekt, rezultat i arsyes dhe veçorive të kësaj bote. Për këtë na mëson Krijuesi ynë nëpërmjet Shpalljes, mësuesit absolut të njeriut.

Edhe vetë jeta e njeriut, herë në gjumë e herë pa të, shoqëron jetën dhe vdekjen, sepse sa mbaron, fillon sërish. Gjumi është vdekja e vogël; njeriu vdes që të rizgjohet, sepse vdekja nuk është tjetër veç jetë – kalimi nga jeta e shqisave në jetën e kuptimeve. Këto kuptime të veçuara janë të mangëta, por së bashku plotësojnë njëra tjetrën. Këto janë ligjësi të Krijuesit dhe çdo gjë ndodh sipas planit të mirëpërcaktuar paraprakisht. Kuptimi është se fillimi dhe fundi nuk është vdekja përfundimtare, por fundi i një cikli për të filluar tjetri, siç ndodh me bimët, kur pas vyshkjes, mbin filizi i ri. Këto ngjarje nuk janë halucinacion as ëndërr, por realitet për të cilin duhet dhënë llogari, sepse Allahu është Ai i cili krijon nga fillimi dhe pas vdekjes kthen në jetë...

4. Ersan Grahovac, po aty.



Kuptimi është se fillimi dhe fundi nuk është vdekja përfundimtare, por fundi i një cikli për të filluar tjetri, siç ndodh me bimët, kur pas vyshkjes, mbin filizi i ri.



DREJTËSIA

Duke parë se ç'po ndodh në botë, shumë njerëz shtrojnë pyetjen: përse ndodh kjo? A është dënim nga Zoti? A është Zoti i drejtë? Përse Zoti na i merr gjërat më të dashura etj. etj.?!?

Harrojmë se gjithëçka kemi nuk është e jona. Ato i kemi gjetur dhe i kemi në shërbim për një kohë të caktuar. Harrojmë se ne nuk jemi krijues të jetës, të shoqërisë, të pasurisë, por vetëm shfrytëzues të përkohshëm. Po ashtu, harrojmë se atë që e quajmë fund të diçkaje, vdekje të më të dashurës, është tek fillimi i jetës së vërtetë, i jetës së përhershme. Prandaj duken të pavend fjalët se "Zoti e vdiq dikë", "Zoti e mori" e të ngjashme. Sepse, si e mori Zoti, si e vdiq Zoti, kur ajo është e Zotit, Ai është krijues i tij etj. Zoti është *El-Mubdiu we'l-mu'idu*, d.m.th. Ai që krijon nga hiçi dhe pas vdekjes kthen në jetë. Kjo jetë e ëmbël shërben të tregojë vetëm mangësitë e saj e jo joshjet e madhështitë, kalueshmërinë e jo përhershëmërinë. Është si dërgimi i fëmijës te mjeku nga nëna. Fëmija fillimisht mendon se mjeku dhe nëna nuk ia duan të mirën, por më vonë e kupton se pikërisht dhembja, është e mira për të. Kështu është

edhe me vdekjen. Ajo është e dhembshme, por ëmbëlsia fillon pas vdekjes, në botën tjetër, në kopshtet e xhenetit.

Përse dyshojmë? Përse arsyeja nuk mund të jetë autoriteti kryesor? Sepse, burimet e informacionit për arsyen janë të mangëta dhe përfundimet do të jenë relativisht objektive. Arsyeja e tij ka mundësi ta perceptojë Udhëzimin, por jo që edhe vetë të bëhet udhëzim. Absoluten dhe relativen mund ta gjykojë me objektivitet maksimal vetëm Krijuesi, i cili e di absolutisht të vërtetën dhe është i privuar nga mangësitë botërore. E vërteta absolute është diçka që ekziston, por duhet të ndjejmë nevojë për të, siç ndjejmë nevojë për ujin edhe pa e parë se ai ekziston. Vetë etja është dëshmi për të. Kësisoj edhe nevoja për absoluten është dëshmi që ajo ekziston, sepse nevoja jonë për të e dëshmon këtë. Edhe nevoja për drejtësinë në këtë botë na udhëzon se drejtësia absolute ekziston. Por ku? Në këtë botë sigurisht që jo, sepse jemi të mbështjellë me emocione e dhimbje, uri e etje, pasuri e varfëri, dashuri e urrejtje. Po ku është drejtësia absolute? Patjetër që ajo ekziston, por jo në këtë botë, sepse kjo botë është vend "sprove e sfide". Por sërish, nevoja jonë për drejtësi kundrejt padrejtësive në këtë botë dëshmon se ajo ekziston në botën përtej. Atje ku nuk ndikojnë dhimbja dhe dashuria, varfëria dhe pasuria, altruizmi e egoizmi. Kjo botë nuk na e dëshmon drejtësinë absolute, sepse është e ngjizur në relativitet e mangësi, veçori këto të krijesave. Drejtësinë absolute e dëshmon pikërisht nevoja jonë, etja jonë për botën përtej.

Besimtari e ka të qartë se, çdo gjë që na është marrë në këtë botë kalimtare, do të na jepet në botën tjetër, atëherë kur na nevojitet më shumë ndihma e Krijuesit.⁵

5. Ersan Grahovac, po aty.

REFUZIMI I UDHËZIMIT, DIKUR DHE SOT

Pse shumë popuj e refuzojnë udhëzimin hyjnor? Pse ata mohojnë cilësinë kundrejt jocilësisë? Pse injorojnë ftesën e hapur për përqaftim të së vërtetës? Ndonëse nuk është e lehtë, do të përgjigjemi me gjuhë popullore. Udhëzimi është dritë, kurse brendia e tyre është e errët. Drita është aq e dukshme, sa e ndan qartë të vërtetën nga e pavërteta, vesin nga virtyti dhe vlerën nga antivlera. Ata që janë mësuar të jetojnë në terrin e mosbesimit, që kanë mëkatuar, që në jetën e tyre kanë mangësi dhe lajthitje, nuk e duan këtë dritë, sepse ajo i shfaq të gjitha lajthitjet dhe gabimet në publik. Ata nuk mund të pajtohen me këtë fakt dhe, në vend që të vetëdijësohen për gjendjen e tyre të keqe, në vend që t'i vështrojnë gabimet e tyre, t'i përmirësojnë mangësitë e tyre, t'i braktisin devijimet dhe mosdijen, ata më me dëshirë pasojnë epshet dhe, përkundër dëshmive të qarta, zgjedhin luftën e hapur kundër udhëzimit dhe bartësve të tij.

Përse nuk e pranojnë gjuhën e mirëkuptimit dhe udhëzimit, kur janë zhytur në gabime e mashtrime? Përgjigja mund të jetë: mendjemadhësia. Ky ves është i njohur qysh moti, nga mësuesi i së keqes, shejtani, i cili shfaq mendjemadhësi kundrejt njeriut dhe gaboi.

(Zoti) tha: "Ç'të pengoi ty që nuk u përule, kur të urdhërova?" (Iblisi) tha: "Unë jam më i mirë se ai. Mua më krijove nga zjarri, kurse atë e krijove nga balta". (El-A'raf, 12)

Përveçse shfaq mendjemadhësi, edhe fajësoi të tjerët përveç vetes. Harroi se mendjemadhësia është verbuesi më i madh dhe nuk sheh tjetër veç mbrapshti. Kur njeriu ndjek rrugën e shejtanit edhe ai bëhet njeri-shejtan, mendjemadh, egoist, koprrac dhe, ç'është më e keqja edhe neglizhent, përtac dhe refuzues i udhëzimit hyjnor. Por ç'është

mendjemadhësia dhe ç'e karakterizon këtë ves? Ekspertët e kanë përkufizuar si ves, i cili sheh veten dhe të tjerët i jorealisht. Respektivisht veten e sheh mbi të tjerët, kurse të tjerët si sklevër e shërbëtorë. Pse ndodh kështu? Sepse njerëz të tillë janë të vetëdijshëm për inferioritetin dhe vogëlsinë e tyre. Shprehja e mendjemadhësisë është tendencë që, nëpërmjet vrazhdësisë dhe egoizmit, t'i mbajnë të tjerët në distancë e largësi, sepse autoriteti i tyre është i ndërtuar në pavlerë dhe gënjeshtër. Njerëzit e mëdhenj janë të kapshëm për publikun, sepse ata zotërojnë cilësi për të gjithë të interesuarit. Institucionet e mëdha janë të hapura, sepse nuk kanë asgjë për të fshehur. Vlerat që kanë realizuar gjatë së kaluarës nuk i frikësojnë ata që të jenë publikë dhe komunikues. Kjo është si rasti me luanin. Ai nuk shtret si i fortë, as si mbret i shkretëtirës, sepse është mbret dhe këtë e bën vetëm kur ka nevojë.⁶

Pse njeriu bëhet mendjemadh dhe arrogant? Sepse dashurinë e tij e orienton drejt vetvetes, vetëdashurohet, bëhet narcist dhe botën e sheh në shërbim të vetvetes e jo veten në shërbim të të tjerëve dhe vetë vlerave. Ai harron se krijimi i tij nuk është qëllim më vete, por që të jetë në shërbim të Krijuesit, në adhurim të Tij. Kjo ndiqet me pasoja negative, rrënohet baraspesha shpirtërore dhe njeriu çdo herë e më shumë largohet nga baza e tij, njerëzia. Kjo bëhet e rrezikshme sidomos, kur kjo vetëdashuri shkon kah kulmi, kur njeriu vetëdashurohet, vetadhurohet dhe kërkon të adhurohet, siç ndodhi në të kaluarën te faraonët, te Nemrudi apo në kohën moderne te shqiptarët me Enver Hoxhën.

Allahu nuk lë problem pa rrugëdalje, prandaj edhe kjo rrugë ka dalje, që do të thotë se duhet respektuar e çmuar vetvetja, por jo që bota të rrotullohet rreth teje, por t'i bashkë me të tjerët rreth botës e të gjitha këto në shërbim të Krijuesit, për dashuri të Tij dhe në emër të Tij. Shembull për këtë duhet të marrim nga natyra madhështore, nga bota bimore, shtazore dhe çdo gjë që na rrethon, e dukshme dhe e padukshme. Pse anarkia ekziston vetëm në botën e njeriut? Pse kjo nuk ndodh edhe në natyrë? Sepse njeriu shkeli zotimin e "halifit të Zotit" në tokë, duke e shpallur veten pronar

6. Shih: Edin Tule, Čovjek s kraja grada, Sarajevë, 2006.



*“Xhindët dhe njerëzit
i kam krijuar
vetëm që të Më adhurojnë.”*

(Edh-Dharijat, 56)



të çdo gjëje. Njeriu harron se Allahu e ka krijuar çdo gjë në shërbim të njeriut, por jo për abuzim të saj, por për marrje mësimi nga i gjithë ky rend kozmik, nga vetë krijimi i njeriut, botës bimore e shtazore dhe e gjithë kjo për falënderim dhe mirënjohje ndaj Krijuesit:

“Xhindët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.” (Edh-Dharijat, 56)

Në këtë botë njeriu është si politikani. Po e menaxhoi drejt qeverinë, do të përkrahet nga pasuesit. Por, po e menaxhoi keq, do të kundërshtohet. Nëse politikani në fund të karrierës e sheh veten në një shtatore bronzi apo metali tjetër në qendër të qytetit, njeriu besimtar duhet ta shohë veten në lartësitë shpirtërore, në atdheun e përhershëm – xhenet, që shpirti t'i bëhet fluturakja e tij, që bota t'i bëhet vendbanim i përkohshëm, që ekstremistët t'i bëhen shërbëtorë, që arsyeja t'i bëhet ministër, që epshi t'i bëhet fuqi punëtore, që urrejtja t'i bëhet polic....duhet t'i kultivojmë këto gjëra që mos vijë rrënimi dhe vuajtja por ngritja cilësore dhe kënaqësia me begatitë e shumta.



Statusi

i sinqeritetit

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Sinqeritet (*ihlas*) do të thotë të qëndruarit larg çdo lloj shirku, larg bestytive dhe ndjenjave negative, si dhe shmangia nga marrëdhëniet që mbështeten vetëm në interesin e kësaj bote. Shkurt, mund të themi se sinqeritet është të synosh vetëm pëlqimin e Zotit dhe jo kënaqësitë apo pakënaqësitë e njerëzve.

Sinqeriteti për adhurimet dhe veprat (*amel*) është si shpirti për trupin. Në këtë botë, për sa kohë që njeriu është bashkë me shpirt dhe trup, ka kuptim. Trupi nuk ka kuptim pa shpirtin, siç nuk ka as shpirti pa trupin. Veprat fitojnë vlerë me sinqeritet, sepse ashtu si nuk ka kuptim një vepër pa sinqeritet, po ashtu edhe sinqeriteti pa vepër është i pavend.

Sinqeriteti nuk është një vlerë që arrihet lehtë. Madje, të vetëndihesh i sinqertë, është shenjë e pasinqeritetit. Sufitë kanë tërhequr vëmendjen rreth lidhjes së ngushtë që gjendet mes *siddk*¹-ut dhe *ihlas*-it. Ata i vlerësojnë si dy vlera me të njëjtën domethënie.

Njeriu i sinqertë është ai që me dëshirën dhe vullnetin e tij përpiqet të arrijë *ihlas*-in, duke shpëtuar nga dobësitë dhe veset e pashpirtshme. Në Kuran thuhet: ***Iblisi tha: "Zoti im, për shkak se më çove në humbje, unë do t'u zbukuroj atyre (njerëzve) rrugën e gabuar në Tokë dhe të gjithë do t'i shpie***

1. Ky term i përmendur në Kuran (Nisa, 69) nënkupton ata ndjekës të profetëve, të cilët ishin më të parët që u besuan atyre. Kjo është grada më e lartë që një besimtar mund të arrijë. (shën. i përkth.)

në mashtrim, përveç robërve të Tu të sinqertë”.
(Hixhr, 39-40.)

Kurani thotë se, atij që i përkushtohet me sinqeritet adhurimit të Allahut dhe që përpiqet të fitojë pëlqimin e Tij, Zoti i Madhëruar do t’i mundësojë të bëjë vepra të sinqerta: ***“Ata që shpenzojnë pasurinë e vet, për të kërkuar kënaqësinë e Allahut dhe që e forcojnë veten me punë të mira, shembëlajnë me një kopsht të mbjellë në rrafshnaltë, në të cilin bie shi i bollshëm, ndaj jep fruta dyfish.”*** (Bekare, 256) Allahu, i Cili sheh gjithçka që bën njeriu, e di më së miri nëse robi i Tij vepron diçka për hir të Tij apo për dikë tjetër.

Flitet për katër armiq, që e pengojnë njeriun të arrijë sinqeritetin. Këta janë: dynjaja, shejtani, nefsi dhe dëfrimet. Këto katër pengesa zhvillojnë tek njeriu të kundërtën e sinqeritetit, e cila është hipokrizia. Prandaj, të arrish në sinqeritet është një betejë më vete ndaj këtyre katër armiqve dhe mençuri të arrish të qëllosh secilën me armën e duhur.

Sinqeriteti është manifestimi i virtytit më të lartë, i cili meritohet si rezultat i përkushtimit ndaj Allahut. E kundërta e sinqeritetit dhe ajo që shtrembëron çdo vepër, është dyfytërsia. Dyfytërsia është mbi të gjitha një dobësi shpirtërore, që ushqen ndjenjën e famës dhe atë të të qenit në vëmendje gjatë shërbimit që u bën njerëzve. Mënyra për të shpëtuar nga kjo dobësi është të mos i vësh aspak krijesat e Zotit, ndërkohë që je duke adhuruar Atë. Të bësh kujdes ndaj suneveve, kur vepron për hir të Zotit dhe të ndjesh kënaqësi për veprën që bën për hir të Tij. Allahu i Madhëruar në Kuran thotë: ***“E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë...”*** (Bejjine, 5)

Dyfytërsia mund të shërohet përmes dy metodave:

1. Prerja e venës së hipokrizisë. Pra, eliminimi i shkaqeve të dyfytërsisë.

2. Shmangia nga dyshimet që lindin në zemër gjatë adhurimit.



Sinqeriteti është manifestimi i virtytit më të lartë, i cili meritohet si rezultat i përkushtimit ndaj Allahut.



Sinqeriteti ka një veçori që njeriun mund ta ngrejë në statusin e mirësisë (*ihsan*). Prandaj ai është si një mburojë që ndërtohet (1) duke kryer farzet, (2) sunetet dhe (3) me edukatë të mirë. Sinqeriteti i mbron njeriut *imanin* dhe i ndryshon gjendjen shpirtërore. Sikur të vësh trojmë nga jashtë brenda, shtresa e jashtme e këtij muri mbrojtës është edukata e mirë e njeriut. Nëse njeriu kujdeset për edukatën e mirë, shejtani nuk mund të depërtojë tek ai. Sapo njeriu fillon të shkujdeset ndaj edukatës, shejtani menjëherë e bind atë për lënien e suneteve dhe më pas, për braktisjen edhe të farzeve. Atëherë dobësohet edhe qëndrimi kundër orientimeve të shejtanit. Ndaj njeriu duhet t’i kushtojë vëmendje të madhe edukatës së mirë, për të qenë i fortë përballë ndërhyrjeve të shejtanit dhe të nefsit. Të bëjë kujdes ndaj kryerjes me rigorozitet të suneteve dhe farzeve. Ai duhet të jetë gjithnjë në telashin e ngjites me sukses në statusin e të sinqertit.

Mevlana e shpjegon kështu këtë të vërtetë, në Mesnevi:

“Në një çast besnikun heretik;

Prapë, në një çast e ngre të pafenë në nivel zahid...

*Sepse robi i sinqertë po s’që i sigurt në vetvete,
Është gati të bjerë në rrezikun e kurtheve...*



*Sepse i sinqerti është udhëtar dhe në rrugë ka djaj;
Vetëm ata nën amanetin e Zotit shpëtojnë andej...*

*Vetëm ata me pasqyrën e zemrës së pastër janë të
sinqertë;
Të tjerët s'kanë kapur ende të vërtetën...*

*I sinqerti që arrin pozitën e principialitetit,
Arrin pozitën e garancisë dhe fiton mbi nefsën dhe
djajtë..."*

(Mesnevi, përkth. M. Hoxha, v. II, 5270-5275, Logos-A, 2010)

Sinqueriteti është një enigmë shpirtërore që përpiqet të ndërtojë botën e brendshme të njeriut. **Xhunejd Bagdadi** thotë: "Sinqueriteti është një enigmë mes njeriut dhe Zotit. As engjëjt s'mund ta shkruajnë si sevap, ngaqë nuk e njohin e as shejtani s'e njeh, ndaj s'mund ta zhbëjë." Mes sinqueritetit dhe dyfytërisë ekziston një vijë e hollë ndarëse. Shpeshherë njerëzit, duke menduar se janë të sinqertë, bëhen hipokritë. **Fudajl Bin Ijad** jep një mendim që nuk duhet harruar: "Dyfytëri është edhe të braktisë një vepër fetare, për arsye se do të të shohin të tjerët. Ndërsa, të veprosh (amel) se do të të shohin të tjerët, është shirk i fshehtë." E rëndësishme është që të përqafojmë sinqueritetin dhe të ruhem nga të dy këto skaje që përmendi **Xhunejdi** më lart.

Mevlana, në Mesnevinë e tij, shpjegon përmes një tregimi se si krijohet një konflikt ndjesor mes dyfytërisë dhe sinqueritetit:

*"Njëri po nisej të hynte në xhami,
Kur njerëzit e tjerë ishin duke dalë që aty..."*

*Njëri i tha: Profeti e fali namazin në bashkësi
Dhe u çlirua tashmë nga e fshehta e tij...*

*Pra, o njeri patëkeq, pse po hyn brenda?
Profeti tashmë selamin e dha...*

*Njeriu i vonuar rënkoj "ah!"; nga dolën tymëra;
"Ah"-u i tij kundërmonte erë gjaku nga zemra...*

*Një tjetër i tha: Ma jep atë "ah";
Të qoftë falë namazi im që fala...*

*I tha: Ta dhashë "ah"-un dhe e mora namazin;
Tjetri e mori "ah"-un me lutje e falënderim...*

*Pastaj, në gjumë, një zë i tha me miratim:
Bleve eliksir dhe shërim...*

*Për hir të kësaj zgjedhjeje që bëre,
U pranua namazi i të tërëve..."*

(Mesnevi, përkth. M. Hoxha, v. II, 6719-6725, Logos-A, 2010)

Për të kuptuar më qartë se cila është rruga për të shpëtuar nga dyfytëria, shpesh jepet si shembull ky krahasim: "Nuk është i njëjtë ai që e konsideron si një arritje faljen e tehexhudit (namazi i natës), bërjen e duave dhe adhurimet e tjera në gjysmë të natës, ndërkohë që të tjerët flenë, me atë që nuk ka mundur të zgjohet për të falur tehexhudin dhe që e ndjen mungesën e mosfaljes së tij. I dyti është më lart se i pari."

Qëllimi i veprimeve duhet të jetë pëlqimi i Zotit dhe synim për të dalë faqebardhë në botën tjetër. Përqendrimi në çështjet e dynjasë, bën që veprat e mira të zbehen, si dhe bëhet shkak të ndryshohet qëllimi i veprave. Ky ajet kuranor ofron një kriter të rëndësishëm në këtë kontekst: **"Atyre që duan jetën e kësaj bote dhe bukuritë e saj, Ne do t'u shpërblejmë krejtësisht punët e tyre dhe në të nuk do t'u lihet gjë mangut. Këta janë ata, për të cilët në botën tjetër nuk do të ketë kurrjë, përveç zjarrit. Do t'u shembet çdo gjë që kanë bërë në këtë jetë dhe do t'u zhvlerësohet ajo që kanë punuar."** (Hud, 16 – 17.)

Qëllimi i ndryshëm mund të ndryshojë rezultatit e veprës. Është i njohur një tregim që i atribuohet Hz. Aliut. Në luftë, gjatë dyluftimit, Hz. Aliu rrëzon përdhe armikun e pafe. Ndërkaq, sapo do që ta vrasë, armiku e pështyn në fytyrë atë. Për çudi, Hz. Aliu e lë armikun, nuk e vret. Armiku i

habitur, pyet Hz. Aliun se përse e bëri këtë veprim. Imam Aliu (r.a.), i thotë: "Unë po të vrisja për hir të Zotit. Por, kur më pështyve, u nevrikosa dhe m'u përzien nervat në veprim. Nervat janë ndjenja e pshore që mbajnë aromë hakmarrjeje. Nëse do të të vrisja me një ndjenjë të tillë, vepra ime do të tejkalonte kufijtë e sinqeritetit dhe atëherë unë s'bëhem tjetër veçse një vrasës."

Sinqeriteti është një ndjenjë e lartë, e cila fton ndihmën hyjnore dhe realizon një forcë të madhe shpirtërore. Njerëzit që zotërojnë sinqeritetin, janë më të fuqishëm dhe më të suksesshëm, krahasuar me të pasinqertët. Në Kuranin Fisnik, Allahu i Madhëruar thotë: **"Sa herë, me ndihmën e Allahut, një ushtri e vogël ka ngadhënjyer mbi një ushtri të madhe (për arsye të sinqeritetit të tyre)! Allahu është me të durueshmit."** (Bekare, 249)

Rruga për t'u bërë i sinqertë kalon përmes heqjes dorë prej dëshirave dhe kënaqësive të nefsit, mospritjes me shpresë nga dynjaja apo njerëzit dhe përgatitja me tërë seriozitet për ahiretin. Pa e bërë këtë, edhe veprave që duken si të sinqerta mund t'u përzihen dyfytërsia dhe interesat e kësaj bote. Një njeri rrëfen diçka për t'u bërë kujdes: "Prej tridhjetë vitesh falja namazin me xhemat, në xhami dhe në rresht të parë. Kjo gjë më shijonte shumë dhe kisha përshtypjen se ishte vepër e sinqertë. Një herë, fala namazin në rresht të dytë, sepse shkova me vonesë, por u ndjeva i turpëruar para shokëve, për këtë vonesë. Atëherë kuptova se, që prej tridhjetë vjetësh, më ishte përzier në adhurimin tim një hipokrizi për të falur namazin në rresht të parë dhe që të më shikonin të tjerët. Kjo gjë më preku shumë. I rifala kaza namazet e tridhjetë viteve me plot pendesë e kërkim faljeje ndaj Allahut."

Interesi, dëshirat e pshore dhe tendencat e devijimit të shejtanit, sulmojnë veprën e njeriut si mikrobe dhe prishin sinqeritetin e adhurimeve. Lidhur me këtë temë, Allahu i Madhëruar thotë kështu në Kuran: **"Ditën e Kiametit, njerëzit do të përballen me atë që nuk e kanë llogaritur."** (Zumer, 47)


Nëse adhurimet bëhen larg sinqeritetit, të shkëputura nga emocioni dhe ndjenja, atëherë ato kalojnë në nivelin e një pune të zakonshme të përditshme.




Sinqeriteti ekziston si në adhurime, ashtu edhe jashtë tyre. Sinqeriteti në adhurime është të menduarit vetëm kënaqësinë e Zotit, gjatë adhurimeve. Edhe sinqeriteti në veprat jashtë adhurimeve qëndron tek qëllimi për të vepruar për hir të Allahut. Nëse veprat e ndryshme të përditshme bëhen me sinqeritet, ato ngrihen në gradën e adhurimeve. Nëse adhurimet bëhen larg sinqeritetit, të shkëputura nga emocioni dhe ndjenja, atëherë ato kalojnë në nivelin e një pune të zakonshme të përditshme. Ndërsa, nëse bëhen me hipokrizi, bien në gradën e gjynahut.

Nuk është gabim të kërkosh pasurinë e hallallit të dynjasë. Gabimi qëndron tek bërja mjet e veprave (*amel*) për çështjet e dynjasë. Vendi, ku veprat do të marrin vlerën e vërtetë, është bota tjetër. Njerëzit e sinqertë nuk presin nga kjo botë shpërblimin e veprave. Madje, ata mendojnë se, duke u shpërblyer në këtë botë, do t'u pakësohen të mirat në botën tjetër. Atyre që konsumojnë fitesën e botës tjetër për dhuntitë e kësaj bote, Allahu u tërheq vëmendjen në këtë mënyrë: **"Ju keni shfrytëzuar gjithë të mirat në jetën tuaj tokësore dhe jeni kënaqur me to, ndërsa sot do të ndëshkoheni me dënim poshtërues."** (Ahkaf, 20)

Sinqeriteti është kushti plotësues i adhurimeve dhe sjelljeve. Ashtu sikurse ka kushte fizike për adhurimet, po aq me rëndësi është edhe sinqeriteti, si kusht shpirtëror. Për të pasur sinqeritet dhe për ta arritur atë, njeriu duhet të marrë një edukim të mirë në këtë fushë. Mjafton të mos bëhesh pre e pasinqeritetit. Të meritosh prej Allahut statusin e të qenit i sinqertë, është një dhuratë e papërshkrueshme.





XHAMIA E PLUMBIT, 1938
SHKODËR

FOTOJA E MUJAJIT



Një analizë e zhvillimit të turizmit në Shkodër

Prof. dr. Sadije Bushati

Turizmi është një nga sektorët më prioritarë të zhvillimit të sotëm në Shqipëri dhe në shumë vende të tjera të globit. Zhvillimi i teknologjisë ka rritur informacionin dhe prej tij është rritur interesi për njohje të zonave të reja, për zhvillimin e tyre, historinë e kulturën, zakonet, doket etj. Një vend i tillë konsiderohet Shqipëria, i quajtur "sekreti i fundit në Europë", e cila përveç kulturës dhe traditave, zotëron edhe pasuri të tjera të çmuara për zhvillimin turistik, si zona të pasura arkeologjike, 400 km vijë bregdetare, zona malore me peizazhe nga më të bukurat, ujëra të freskëta e të pandotura, liqene e lumenj, larmi kafshësh e bimësh, popullsi mikpritëse, bujare dhe në harmoni fetare.

Një nga zonat e mbushura me këto pasuri është rrethi i Shkodrës me kryeqendrën e veriut të vendit, qytetin e Shkodrës. Me bukuritë natyrore, me kulturën e historinë, ajo ofron turizëm kulturor në format e trashëgimisë, të arteve, qytetare dhe moderne; turizëm detar, me qendër në Velipojë, turizëm liqenor në qendrat Shirokë dhe Zogaj, turizëm malor me qendrat Theth, Bogë e Razëm e me shpella të shumta ndër to.

Numri i turistëve dhe i vizitorëve vjen gjithnjë duke u rritur si në Shqipëri ashtu edhe në Shkodër. Në vitet e fundit është llogaritur për Shkodrën, një rritje prej afro 30% e numrit të turistëve për çdo vit. Një numër mjaft i konsiderueshëm turistësh vjen edhe nga Mali i Zi, me qëndrim të shkurtër 1-2 ditore, si rezultat i bashkëveprimit ndërmjet operatorëve turistikë të Malit të Zi dhe atyre të Shkodrës. Investimet në sektorët publikë kanë si qëllim edhe promovimin e qytetit si destinacion turistik. Disa nga produktet promovuese dhe informuese të prodhuara janë: web sitet, "Guida turistike", "Shkodra in your pocket", "Kështjella e Shkodrës, Rozafa", "Shkodra, the region of privacy", "Kujtesë historike për bushatlinjtë" etj.

Investime publike të tjera, që lidhen me turizmin, mund

të përmenden: pedonalja në hyrje të qytetit dhe në qendër të tij; ndërtimi i Urës së re të Bunës; Unaza e qytetit, rikonstrukcione të trotuareve në qytet, i lulishtes pranë Grand Hotel Europa, i rrugëve të qytetit etj.

Qytetarët shkodranë krenohen për kulturën dhe artin që trashëgojnë; ata e vendosin Shkodrën si të parin qytet të Shqipërisë për:

- Bibliotekën shtetërore (biblioteka e Bushatlinjve, 240 vjet më parë);
 - Spitali i parë në Shqipëri (në lagjen Ajasëm, në vitin 1831), ndërsa mjekë të ndryshëm vijnë në Shkodër që në mesin e shekullit të 14-të;
 - Fotografia e parë, në vitin 1858;
 - Gazeta e parë e botuar shqip "ISHKODRA", në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit";
 - Banka e parë shqiptare në Shkodër, më 04.02.1863
 - Filaturat e para shqiptare, në mes të shekullit 19;
 - Romani i parë shqiptar "Shkodra e rrethume", e Dom Ndoc Nikaj;
 - Banda e parë shqiptare, në vitin 1878;
 - Në Shkodër u panë për herë të parë biçikleta, pajtoni e automobili;
 - Shfaqet për herë të parë filmi (1912).
 - Klubi i parë i futbollit në Shqipëri, në 1919;
 - Opera e parë shqiptare, "Mrika" e Preng Jakovës;
 - Ekspozita e parë shqiptare me grup autorësh në pikturë dhe skulpturë, në vitin 1923, ku shoqëria "Rozafa" ekspozon 200 vepra;
 - Statutet e Shkodrës të shek. XIV (1346), të zbuluara në fund të shek. XX, tregojnë për vetëqeverisjen e qytetit dhe konsiderohen si monument i kulturës mesjetare shqiptare.
- Më poshtë paraqitet analiza Swot, e cila përmban anët e forta, anët e dobëta, shanset dhe kërcënimet për zhvillimin e turizmit në Rajonin e Shkodrës.

ANALIZA SWOT

1. ANËT E FORTA

Pozicioni gjeografik: Shkodra ndodhet në veriperëndim të Shqipërisë; qyteti më i madh i kësaj zone, 9,5-24 m mbi nivelin e detit. Në veriperëndim të tij ndodhet liqeni me të njëjtin emër, Liqeni i Shkodrës, më i madhi në Ballkan. Në lindje kalon lumi i Kirit, 43 km i gjatë, që derdhet në lumin Drin, i cili kalon në jug të qytetit. Lumi i Bunës, 44 km i gjatë, buron nga liqeni, bashkohet me Drinin dhe derdhet në detin Adriatik. Ky i fundit ndodhet gati 30 km larg qytetit, në plazhin e Velipojës. Në jugperëndim të qytetit ndodhet kalaja e Rozafës, 130 m e lartë dhe sipërfaqe 3,6 ha. Në veri ndodhet fusha e MbiShkodrës dhe pastaj fillojnë Alpet e Shqipërisë.

Potenciale të shumta të rajonit të Shkodrës për zhvillim të turizmit: kulturor, detar, liqenor, malor.

Rritja e interesit për udhëtime e njohje të vendeve të panjohura. Viti 2011 po e vendos Shqipërinë në vendet më interesante për t'u zbuluar. Sipas disa studimeve, parashikohet që në vitin 2020 numri i turistëve vetëm në Europë do të dyfishohet. Kjo gjë është vërejtur vit pas viti edhe në rajonin e Shkodrës.

Turizmi është prioritar në politikat e Qeverisë Shqiptare dhe, sipas strategjisë së zhvillimit të turizmit 2003-2012, parashikohet që turizmi të krijojë 15% të PBB në vitin 2012 nga 4% në fillim të periudhës. Infrastruktura është përmirësuar mjaft si rezultat i investimeve të bëra nga shteti.

SUPERSTRUKTURA TURISTIKE E RAJONIT TË SHKODRËS

Hotelet në qytetin e Shkodrës ofrojnë mundësi të ndryshme akomodimi. Hotelet më luksoze kanë çmime që variojnë nga 30 deri në 60 euro, ndërsa të tjerët kanë çmim 10-20 euro; kapaciteti gjithsej është rreth 300 shtretër.

Në plazhin e Velipojës kapaciteti është më i madh, rreth 15 000 shtretër, shumica përdoren për pushime familjare me kosto të lirë.

Në zonat malore, kryesisht në Theth, janë ndërtuar disa shtëpi – bujtina e hane, që ofrojnë fjetjen dhe ushqimin me çmime 10-30 euro nata.

Restorantet që ofrojnë kuzhinë tradicionale, mesdhetare dhe kryesisht italiane, janë në qendër të qytetit si dhe pranë lumenjve që qarkojnë Shkodrën, Drinit e Bunës dhe në brigje të liqenit. Edhe në plazhin e Velipojës ka restorante mjaft cilësorë. Në të gjitha restorantet mund të themi se çmimet janë mjaft konkurruese; një darkë normale shkon 10-15 euro.

Anëtarësimi në NATO qe një arritje shumë e madhe, sepse u realizua siguria e ardhjes së turistëve, kur dihet që më parë disa ambasada u sugjeronin vendasve të vet të mos frekuentonin Shqipërinë pikërisht për pasigurinë e saj.

Universiteti i Shkodrës me degën e Turizmit jep mundësinë e diplomimit të specialistëve të lartë në fushën e turizmit, duke plotësuar burimet njerëzore për një menaxhim sa më të mirë të të gjitha institucioneve publike



apo private.

PIKAT TURISTIKE MË TË FORTA:

Kalaja e Shkodrës është kalaja më e madhe në Shqipëri, 2400 vjeçare, me objekte turistike: sistemi fortifikues, kisha e Shën Stefanit e shek. XIV, e shndërruar më pas në xhami, kapiteneria, burgu, saranxhat dhe daljet sekrete. Muzeu i kalasë, ku ruhen gjurmë antike, mesjetare dhe të periudhës së Bushatlinjve.

Muzeu historik, i ndodhur në një shtëpi karakteristike shkodrane të shek. XVIII, shtëpia e Oso Kukës, përmban tre sektorë: të arkeologjisë, historisë dhe etnografisë. Sektori arkeologjik me rreth 500 objekte, mbulon periudhat nga neoliti (6000 vjet p.e.r.), deri në shek. XVI në Mesjetë. Sektori i historisë ka shumë relike historike, nga shek. XV e deri sot, si dhe 3000 materiale të filmuara dhe fonotekë. Sektori i etnografisë përmban 1500 objekte të shek. XVIII- XIX. Janë prodhime artizanale të zonës së Shkodrës dhe përreth.

Fototeka Marubi ka një fond me 400 000 negativë, që nga fotografia e pare, e vitit 1858 deri në vitet 1970. Afro gjysma e fondit i takon familjes Marubi, ndërsa pjesa tjetër u takon familjeve të fotografëve Pici, Rraboshta, Jakova, Nënshati. Në fototekë ruhen edhe regjistrat origjinalë me emrat e personave dhe datat e fotografimit.

Liqeni i Shkodrës me sipërfaqe 368 km² dhe lartësi 4.5 m mbi nivelin e detit, ndodhet në veriperëndim të Shqipërisë dhe të vetë Shkodrës. Vetëm 149 km² ndodhet në territorin shqiptar; pjesa tjetër në Malin e Zi. Ai ka florë dhe faunë shumë të pasur, me afro 65 lloje peshku, 240 lloje shpendësh dhe 800 lloje bimësh. Shiroka dhe Zogaj, të vendosura buzë tij, janë të njohura edhe për klimën e tyre kurative.

Plazhi i Velipojës ndodhet në largësi 36 km nga Shkodra, në bregdetin e Adriatikut, ku harmonishëm takohen bukuritë e detit, lumit, malit, ishullit, lagunës dhe pyllit. Ai është i gjatë 14 km dhe gjerësi mesatare 150 m; shtrihet nga delta e Bunës deri në rrëzë të malit Maja e Zezë.

Thethi ndodhet në veri të komunës Shalë, i vetmi park kombëtar i Shkodrës, me sipërfaqe 2630 ha, në lartësitë 750-950 m mbi nivelin e detit. I rrethuar nga Alpet e Shqipërisë, me lartësi deri në 2559,4 m, aty rrjedhin 70 burime uji. Ky vend pasurohet nga 1100 lloje bimësh, që përbëjnë 1/3 e llojeve të bimëve në vend. Gjendet rreth 65 km nga



qyteti i Shkodrës.

Shpellat. Në rajonin përreth Shkodrës ka një numër të konsiderueshëm shpeshash, të cilat janë mjaft tërheqëse për shumë turistë të kësaj fushe dhe ka shumë vite që ato vizitohen edhe për larminë që paraqesin. Më të njohurat janë shpella e Jubanit, shpella e Gajtanit, shpella e Zhylës në Prekal, shpella e Shkambit të Kuq, shpella e Rrencit, shpella e Preng Calit, shpella e Majës së Harapit në Theth, shpella e Bogës, shpella e Synit të Sheganit në Bajzë, shpella e Gjollajve, të studiuara nga speleologë shkodranë që në vitin 1685 (Pjetër Bogdani) dhe të huaj që në shek. XIV. Këto janë bërë të njohura nga banorët shumë kohë më parë. Prej tyre kanë mbërritur legjendat dhe këngët popullore, ku shpellat janë vendbanime të zanave e shtojzovalleve.

Ura e Mesit, e ndërtuar në kohën e Bushatlinjve; objektet e kultit të tri feve: xhamia e Parrucës dhe Ebu Beker, kisha e madhe dhe kisha ortodokse, Sahati i Inglizit, banja e vogël, shtëpia ku ka banuar familja e Nënë Terezës, shtëpi karakteristike shkodrane etj.

PEDONALJA ME TREGUN E PUNIMEVE ARTIZANALE

Dy-tri herë në vit, si në ditën e luleve, më 6 maj, ose në ditë të paracaktuara, disa shoqata në bashkëpunim me Bashkinë e Shkodrës, organizojnë panaire të punimeve artizanale nga artizanët shkodranë, si qilima e sixhade, mbulesa e çarçafë, të punuara me dorë me pambuk, punime me dru, me argjend etj. Panairët organizohen kohët e fundit në pedonalen në qendër të qytetit, e cila vizitohet nga shumë qytetarë.

ANËT E DOBËTA

Papastërtia

Qendra e qytetit mbahet e pastër dhe përgjithësisht mund të thuhet se kohët e fundit gjendja e qytetit ka përmirësim. Megjithatë, mjafton të largohesh nga qendra dhe gjen grumbuj mbeturinash anës rrugës apo në kanale, siç ndodh gjatë rrugës për në Velipojë, Shirokë e Zogaj, për në Muriqan apo në Han të Hotit. Kjo mund të konsiderohet si një nga defektet më të mëdha që haset kudo në Shqipëri.

INFRASTRUKTURA

Rrugët në qytet janë shtruar dhe shumë nga trotuaret janë rregulluar. Rruga për në Han të Hotit (prej nga vijnë pjesa më e madhe e turistëve), akoma nuk po rregullohet, megjithëse duhet të kishte përfunduar disa vjet më parë. Edhe rruga për Velipojë ka filluar të prishet para kohe. Mungon transporti për qëllime turizmi dhe përgjithësisht shërbimet janë në nivel të ulët.

MUNGESA E STABILITETIT POLITIK

Mungesa e stabilitetit politik natyrshëm shkakton tërheqje dhe frikë nga ana e turistëve për të vizituar një vend.

2. SHANSET

Premtimet e Qeverisë

Duke njohur rëndësinë e zhvillimit të turizmit për ekonominë e vendit, qeveria Shqiptare po angazhohet gjithnjë e më shumë për zhvillimin e turizmit.

Drejt anëtarësimit në BE

Synimi ynë është të jemi anëtarë të BE, por edhe BE ndihmon vendet që punojnë për anëtarësim me anën e projekteve dhe investimeve të huaja. Nga ana tjetër, vendet e BE bëhen kureshtarë për të vizituar vendin që do të anëtarësohet. Pra, ka shumë shanse të rritet numri i turistëve.

3. KËRCËNIMET

Kriza botërore

Kriza ekonomike botërore tashmë është në kalim, por ndikimi i saj ekziston akoma në buxhetet e familjeve dhe kjo mund të reflektohet edhe këtë vit në numrin e turistëve të huaj.

Ndryshimet klimaterike

Si rezultat i këtyre ndryshimeve, kanë ndodhur përmbytje dhe fatkeqësi natyrore në shumë vende dhe kjo përsëri mund të zvogëlojë numrin e turistëve.

Turizmi te fqinjët

Shtetet fqinjë, si Mali i Zi, Kroacia, Greqia kanë turizëm shumë të zhvilluar dhe të njohur në botë.

Literatura:

1. Agim Parruca, "Shkodra, bastion i qytetërimit shqiptar", Tiranë, 2001
2. Gëzim Uruçi, "Historia e zhvillimit të shkencës së speleologjisë në Shqipëri", "Shkodra në shekuj", 1994
3. Kristina Jançe, "Statutet e Shkodrës, dëshmi e qytetërimit mesjetar", "Hulumtime ekonomike", Ulqin, 2010
4. Sadije Bushati, "Shkodra në mes proceseve të integritimit dhe zhvillimit turistik", "Hulumtime ekonomike", Ulqin, 2010



Shpëtimi I MADH

M. Sami Ramazanogllu

Allahu i Madhëruar urdhëron:
“Ka njerëz që e fllojnë veten, për të fituar pëlqimin e Allahut. Allahu është shumë i mëshirshëm me robtë e Vet.” (El-Bekare, 207.)

Transmetohet se ky ajet fisnik është zbritur në lidhje me Suhejb-i Rumi (r.a.). Suhejb bin Sinaner-Rumi (r.a.), ishte rreth njëqind vjeç dhe doli nga Meka për të emigruar në Medine pas Profetit (a.s.). Gjatë udhëtimit, një grup prej mushrikëve (idhujtarëve) kurejshë, u vu në ndjekje të tij. Mushrikët e arritën dhe vranë të gjithë myslimanët që ishin bashkë me Suhejbin. Por ai ishte një harkëtar shumë i zoti dhe, për këtë arsye, u drejtua nga mushrikët dhe u tha:

“O grup i kurejshëve! Ju e dini shumë mirë se unë nuk kam cënuar askënd prej jush. Mirëpo, nëse do ta bëja, vallahi do ta ngulja këtë shigjetë në zemrën e ndonjërit prej jush dhe, deri sa të më mbarojnë shigjetat, nuk do të keni mundësi të më afroheni. Pasi të më mbarojnë shigjetat, ata që do të kenë ngelur prej jush, do t’i fshija me këtë shpatë. Vetëm pas kësaj, mund të më bënit diçka. Siç e shikoni, unë jam njeri i moshuar. Prandaj dhe qëndrimi im në anën tuaj nuk do të kishte vlerë për ju. Në shtëpinë time në Meke kam lënë një sasi malli. Shkoni, merreni atë dhe, në këmbim, më lejoni të shkoj në rrugën time. Por dijeni se unë do të jem përjetësisht mysliman.”

Pas këtyre fjalëve, mushrikët e lejuan Suhejbin të shkonte në Medine. Kur arriti në Medine, i pari që e priti, ishte Ebu Bekir es-Sidiku (r.a.), i cili, sapo e pa, i tha:

- Urime o Suhejb! Tregtia jote doli me fitim.
- Çfarë tregtie o Ebu Bekir?. - pyeti Suhejbi (r.a.).

Ebu Bekri (r.a.), e lajmëroi Suhejbin për ajetin fisnik, të cilin Allahu i Madhëruar e kishte zbritur enkas

për të. Kur i dëgjoi këto fjalë, Suhejbi (r.a.), u gëzua jashtë mase.

Nëse marrim për bazë këtë ndodhi, kuptimi i fjalës (تَشْرِي), që përdoret në ajet, është “bleu”. Dhe në fakt, ngjarja ndodhi njësoj si shitblerje, sepse Suhejbi (r.a.), e bleu (shpëtoi) jetën duke u dhënë mushrikëve mallin e tij.

Duhet të dimë se besimtarët e shesin jetën e tyre me dëshirë dhe vlera e jetës së besimtarit është xheneti. Edhe robët e dashur të Allahut (evliatë) e shesin jetën e tyre me dëshirë. Mirëpo vlera e jetës së tyre është kënaqësia e Allahut të Madhëruar. Midis këtyre dhe të parëve ka shumë ndryshime. Prandaj ai që ndodhet në rrugë të Allahut dhe dëshiron të bëhet luftëtar dhe dëshmor shpirtëror i vërtetë, duhet të largohet prej vendlindjes dhe të afërmeve të tij.

Profeti ynë (a.s.), në një hadith thotë: “Lum për të huajt.” (Muslim, Iman, 232) Ndërsa në një hadith tjetër thotë: “Kush vdes si i huaj, vdes si dëshmor”. (Ibën Maxhe) Me këto fjalë, profeti ynë (a.s.), shpjegon gjendjen e atyre që janë të huaj, të shkëputur nga të afërmit, por të drejtuar nga Krijuesi, gjë e cila është e padëshirueshme nga shumë njerëz dhe tradita.

Për të qenë plotësisht i dedikuar ndaj Allahut, njeriu duhet të nënshtrojë egon e tij. Prandaj, njeriu i zgjuar duhet ta kujtojë shumë shpesh Allahun, sepse përkujtimi pastron botën e brendshme dhe ndriçon zemrën. Allahu i Madhëruar urdhëron: **“O besimtarë! Kur të ndesheni me ndonjë forcë armike, qëndroni të patundur dhe përmendni shumë Allahun që të fitoni”.** (El-Enfal, 45)

A ka fitim më të mirë se sa bashkimi i robit me Allahun?

Një shikim modern i mendimeve dhe konstatimeve të Ibën Haldunit në lidhje me politikat e administrimit publik dhe ekonomik.

Mendimet dhe konstatimet e Ibën Haldunit do të mundohemi t'i shqyrtojmë në dy kapituj: **Politikat e administrimit ekonomik** dhe **Politikat e administrimit publik**:

POLITIKAT E ADMINISTRIMIT EKONOMIK

Para se të fillojmë të shqyrtojmë mendimet e Ibën Haldunit në këtë çështje, e pamë të arsyeshme të bëjmë një rikujtim. Për të mos rënë në anakronizëm, gjithmonë duhet të kemi parasysh faktin se kushtet në të cilat ka jetuar një mendimtar para më shumë se gjashtëqind vjetësh, nuk mund të krahasohen me kushtet e viteve pas revolucionit industrial dhe kushtet e kohës sonë. Prandaj dhe kemi preferuar që termin "Politikat e administrimit ekonomik" ta japim në thonjëza. Ajo që duam të theksojmë këtu, është ngjashmëria e mahnitshme e disa mendimeve të Ibën Haldunit me parimet e menaxhimit dhe marketingut të ditëve të sotme.

Kur për të njëjtat çështje, kolegët e tij paraardhës, pasardhës dhe mbase disa të kohës sonë, bëjnë shpjegime të thata, si "furnizimi vjen prej Allahut", duke mos shpjeguar çështjet të cilat qëndrojnë pas dhe duke kujtuar se me këtë fjali i kanë zgjidhur të gjitha çështjet në lidhje me jetën ekonomike, por në fakt vetëm sa i kanë prekur në mënyrë sipërfaqësore, Ibën Halduni, në çështjet ekonomike, si shpërndarja e të ardhurave etj., bën analiza dhe konstatime aq racionale dhe shkencore, sa është e pamundur të mos e përgëzosh.

Nëse shohim me vëmendje kushtet e asaj periudhe, vëmë re se kapitali i madh dhe veprimtaritë ekonomike ekzistonin vetëm në fushën e tregtisë. Prandaj dhe mendimet në lidhje me çështjen, të cilën me terminologjinë e ditëve të sotme e shprehim me "Politika e administrimit ekonomik", janë në lidhje me bizneset e tregtisë midis qyteteve dhe shteteve.

Shumë më herët se Maks Ueberi dhe duke përdorur një terminologji dhe koncepte të ngjashme me të tijat (Maks Ueberit), Ibën Halduni i shpreh kështu rregullat që duhet të ketë parasysh një tregtar i zgjuar dhe largpamës gjatë punës së tij:



- Një tregtar, i cili dërgon mallin për ta shitur në qytete dhe shtete të tjera, duhet të veprojë me zgjuars, mençuri dhe me kujdes të veçantë dhe jo në mënyrë të pakujdesshme. Më parë duhet të studiojë gjendjen ekonomike të blerësve në ato vende, mallrat që kërkohen dhe, sipas asaj, të vendosë llojin, cilësinë dhe sasinë e mallit që do të dërgojë, sepse çmimet e pazarit përcaktohen nga oferta dhe kërkesa e tregut vendas.

- Jo të gjithë kërkojnë çdo lloj malli. Disa lloje mallrash kërkohen vetëm prej njerëzve të një shtrese të caktuar. Një tregtar largpamës sjell mallra të një cilësie mesatare, për të cilat ka nevojë çdo shtresë e shoqërisë. Kështu që ka mundësinë ta shesë të gjithë mallin e tij dhe nuk përballet me rrezikun e mungesës së blerësve, duke sjellë mallra të cilat kërkohen vetëm prej një numri të kufizuar njerëzish.

- Nga ana tjetër, një tregtar që dëshiron të fitojë më shumë, duhet të zgjedhë dhe të shkojë në vende të largëta dhe të vështira, ku konkurrentët e tij do të nguronin të shkonin, sepse në ato vende, për shkak të ofertës së pakët, kërkesa për mallrat e tij do të jetë e madhe, numri i konkurrentëve do të jetë më i vogël dhe kështu, fitimet do të jenë më të mëdha.

Ibën Halduni, për të treguar vërtetësinë e këshillave të tij, sjell si shembull tregtarët më të pasur të kohës së vet, të cilët dërgonin dhe sillnin mall nga vendet e lindjes, si Sudani, ku vësh-

tirësitë dhe largësitë ishin më të mëdha.

- Një sipërmarrës duhet të jetë njeri i guximshëm dhe këmbëngulës, por përveç kësaj duhet të jetë edhe largpamës dhe çdo punë duhet ta bëjë me llogari. Një tregtar i mirë është "i aftë dhe i kujdesshëm në llogari" dhe nuk i bën punët shkel e shko.


- Përveç llogarive, tregtari duhet të dokumentojë çdo shitblerje me shkrim dhe përballë dëshmitarëve. Nëse nuk vepron kështu, në raste mosmarrëveshjeje do ta ketë të vështirë të mbrojë të drejtën e tij dhe mund të pësojë dëme të konsiderueshme, sepse personat që do të gjykojnë në lidhje me mosmarrëveshjen, do të marrin vendim në bazë të provave që kanë në dorë.

- Nuk duhet harruar se tregtia bazohet në fitimin që sjell ndryshimi i çmimit midis blerjes dhe shitjes. Në bazë të kësaj, tregtari largpamës i ndjek me vëmendje lëvizjet e tregut, ndryshimet e çmimeve sipas stinës dhe periudhës. Ai duhet t'i blejë mallrat në periudhën kur ato janë më të lira dhe duhet të ndjekë tregjet dhe lagjet në të cilat çmimet janë më të larta.

- Nga ana tjetër, një biznesmen largpamës e ka më mirë të shesë shumë mall me çmim të ulët, sesa të shesë pak mall me çmim të lartë. Në këtë mënyrë, tregtari me kapital të madh fiton më shumë.

- Një tregtar i zoti e di mirë se siguria e pasurisë së tij është e varur nga ligjet dhe mbrojtja që i ofron shteti. Prandaj, duke llogaritur se punën e tij mund ta kryejë vetëm nën mbrojtjen e shtetit dhe të punonjësve të tij, duhet të mbajë lidhje të mira me drejtuesit e shtetit dhe t'i përforcojë vazhdimisht ato.

Një çështje tjetër, së cilës Ibën Halduni i jep shumë rëndësi, është personaliteti i tregtarëve. Ai shqetësohet se mos përpjekjet dhe veprim-



taria e përditshme e tregtarëve për të blerë me çmim të ulët dhe shitur me çmim të lartë, ndikon negativisht në karakterin e tyre. Është e mundur që disa tregtarë, për të gjetur mall të lirë dhe për ta shitur atë sa më shtrenjtë, të bëjnë çdo lloj mashtrimi dhe hileje, duke mos marrë parasysh asnjë parim të moralit. Madje, duke krijuar stoqe të mallrave, për të cilat njerëzit kanë më tepër nevojë, të mësohen me spekulime tregtare. Nëse tregtia bëhet e tillë, atëherë kthehet në një "lloj kumari". Numri i tregtarëve, të cilët mund të shpëtojnë veten e tyre nga këto dobësi të moralit të keq, është shumë i vogël. Për këtë arsye, Ibën Halduni hedh idenë se në jetën tregtare dhe ekonomike, subjektet tregtare, në brendësi duhet të kenë vlera morale, ndërsa nga jashtë duhen kontrolluar nga shteti me anë të ligjeve.

Nëse i shohim me vëmendje mendimet e mësipërme, mund të themi se Ibën Halduni hedh idenë e një marrëdhënieje ekonomike të bazuar në "konkurrencë" dhe "garë" (të ndershme), e cila kontrollohet nga parimet morale dhe ligjet shtetërore dhe jo bazuar në "luftë" dhe "përplasje". Nga kjo kuptojmë se Ibën Halduni, në krahasim me kolegët e tij, i këshillon tregtarët të jenë më largpamës dhe të punojnë me llogari për të qenë gjithmonë të suksesshëm dhe para konkurrentëve të tjerë dhe jo t'i pengojnë ata në punën e tyre.

Para se të shqyrtojmë konstatimet e Ibën Haldunit në lidhje me administrimin shtetëror, po tregojmë një analizë interesante në lidhje me punësimin e personave në një ndërmarrje ose në çfarëdo lloj pune. Megjithëse në lidhje me klasifikimet dhe përgjithësimet ka vend për kritika, nëse vlerësohet nga pikëpamja që kërkon të na tërheqë vëmendjen, duket se është një analizë shumë mësimdhënëse dhe kuptimplote:

"Personat që do të punësohen si punëtorë ose

Një sipërmarrës duhet të jetë njeri i guximshëm dhe këmbëngulës, por përveç kësaj duhet të jetë edhe largpamës dhe çdo punë duhet ta bëjë me llogari.



si shërbyes personal, ndahen në katër kategori. Këta janë ose persona profesionistë dhe të besueshëm, ose joprofesionistë dhe jo të besueshëm. Dy kategoritë e tjera janë ose profesionistë dhe jo të besueshëm, ose joprofesionistë dhe të besueshëm. Dy mundësitë e para le t'i lëmë mënjanë, sepse kush është ai që merr në punë një person, i cili nuk është as profesionist dhe as i besueshëm? Një njeri i tillë, me punën e dobët dhe tradhtinë e tij, mund t'i sjellë dëme të mëdha punëdhënësit. Nga ana tjetër, është pothuajse e pamundur të gjesh persona që janë edhe profesionistë edhe të besueshëm. Njerëz të tillë, jo vetëm që janë të rrallë, por mund të mos pranojnë të punojnë për të tjerët, sepse në sajë të zotësisë së tyre, mund të fitojnë më shumë duke punuar për vete, se sa duke punuar për të tjerët. Personat e kësaj kategorie, duke menduar për famën dhe respektin që do të fitojnë, zgjedhin të punojnë vetëm pranë njerëzve të rëndësishëm. Prandaj, ai që dëshiron të punësojë një njeri, është i detyruar të zgjedhë nga dy kategoritë e tjera.

Vallë, cili duhet zgjedhur? Personi profesionist, por jo i besueshëm apo personi i besueshëm dhe joprofesionist? Kjo është një çështje e rëndësishme mbi të cilën duhet menduar mirë. Po të më pyesni mua, nëse s'gjendet një person i besueshëm, edhe nëse nuk është i besueshëm, zgjidhni një profesionist, sepse dëmet që mund të sjellë ai është e mundur të parandalohen. Por nëse nuk është profesionist, sado që mund të jetë i besueshëm, edhe pse pa dashje, në punën që bën mund të dëmtojë të tjerët".

Vazhdon...

Fryti i sinqeritetit: Paqja shpirtërore

A. Jasin Demirxhi

Sinqeritet do të thotë që në fenë tënde t'i dedikohesh vetëm Allahut, punët t'i kryesh vetëm për të fituar kënaqësinë hyjnore dhe t'i pastrosh ato nga ndyrësitë.

Sinqeriteti është garantuesi i paqes shpirtërore dhe mburoja më e fortë kundër frikës...

Sinqeriteti është ilaçi i problemeve, i hidhërimit dhe dhimbjeve...

Allahu Teala, duke treguar pëlqimin e Tij për besën që i dhanë sahabët Profetit (a.s.), në "Besëlidhjen e Ridvanit", shprehet kështu:

"Allahu është i kënaqur me ata besimtarë, kur t'u be-tuan për besnikëri nën hijen e pemës. Ai e dinte se ç'kishte në zemrat e tyre, prandaj u dha atyre qetësi dhe i shpër-bleu me një fitore të afërt e me një plaçkë të madhe që do ta fitojnë. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë." (Surja El-Feth, 18-19)

Kur sahabët po i jepnin besën Profetit (a.s.), në zemrat e tyre kishte sinqeritet dhe i besuan pa kushte të gjitha ato që tha ai. Ajo që e kënaqi Allahun e Madhëruar, ishte se Ai e dinte që ata do ta mbanin besën që i dhanë Profetit (a.s.).

Për këtë arsye, Allahu zbriti menjëherë qetësi në zemrat e tyre.

U dha qetësi dhe siguri... ndjenjë besimi... paqe shpirtërore...

U dha vendosmëri për të qëndruar të fortë në fenë e tyre, me gjithë vështirësitë që mund t'u dilnin...

U dha mirësinë e të menduarit mirë për Allahun që i udhëzoi në rrugë të drejtë dhe Profetin e Tij (a.s.)...

Nëse pakësohet sinqeriteti, i cili siguron paqen shpirtërore, zemra ngushtohet dhe shqetësimet shtohen. Për arsye se adhurimin dhe nënshtrimin e bëjnë për dikë tjetër dhe jo për Allahun, zemrat e munafikëve, mushrikëve dhe

hipokritëve ngushtohen vazhdimisht.

Ibën Kajimel Xheuzije, e ngjason sinqeritetin dhe teuhidin me një pemë që ndodhet në zemër. Degët e kësaj peme janë veprat. Frytet e saj në këtë botë janë paqja shpirtërore dhe jeta e qetë. Ndërsa në botën tjetër janë mirësitë e pafundme. Edhe shirku dhe dyftyrësia janë si pema në zemër. Frytet e tyre në këtë botë janë frika, hidhërimi dhe ngushtimi i zemrës. Ndërsa në botën tjetër, dënimi i vazhdueshëm.

Si përfundim, për të qenë i sinqertë, duhet të kalosh provimin e kryerjes së punëve vetëm për hir të Allahut. Kur të jeni të sëmurë, t'i mbështeteni Allahut dhe, kur të jeni të shëndetshëm, ta përkujtoni shpesh Atë. Të falënderoni në mirëqenie dhe të mos ngrini krye në skamje, por të duroni. Pra, në çdo gjendje që të jeni, të jetoni për Allahun.

Fjala jonë e fundit le të jetë fjala e Allahut:

Thuaj: "Në të vërtetë, namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve." (Surja El-En'am, 162.)

La tahzen / Mos u hidhëro

Ai (shejtani) tha: "Beto hem në madhërinë Tënde se unë do t'i mashtroj ata të gjithë, përveç robërve Tu të sinqertë!" (Surja Sad, 82-83.)


La tahzen / Mos u hidhëro

Vepra e sinqertë të mjafton, edhe nëse është e pakët. Kemi fjalën e Profetit (a.s.): "Puno me sinqeritet! Nëse vepron kështu, të mjafton edhe puna e pakët." (Ihja-Ulumi'd-din, IV, 676.)

La tahzen / Mos u hidhëro

Edhe nëse hidhërohesh, hidhërohu për Allahun. Mos e ndrysho qëndrimin tënd, as kur të jesh mirë dhe as kur të jesh keq. Gëzohu dhe hidhërohu vetëm për Allahun.





Një Ajet

*Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!*

“Kush është besimtar më i mirë se ai që i dorëzohet sinqerisht Allahut, duke qenë bamirës dhe zbatues i fesë së pastër të Ibrahimit, të cilin Allahu e ka çmuar më së mirë?” (Nisa, 125)

Nëpërmjet këtij ajeti, Allahu na bën të qartë se feja e vetme autentike e pastër është feja islame. Besimtari më i mirë në këtë fe, është ai që i dorëzohet Atij me sinqeritet të plotë, duke e besuar si Krijuesin dhe Gjykatësin e çdo gjëje në këtë botë dhe në botën tjetër, duke qenë vepërmirë e i sinqertë në çdo veprim që kryen. Ky ajet i bën thirrje gjithë njerëzimit në përgjithësi dhe myslimanëve në veçanti, që të mos mjaftohen vetëm me besimin teorik, por t'i dorëzohen plotësisht Allahut, duke zbatuar me përpikmëri dhe sinqeritet fenë e Ibrahimit, që Allahu e ka vlerësuar në Kuran si mikun e Tij. Duke iu drejtuar njerëzve me një pyetje retorike, Allahu pohon se besimtar i mirë është ai që beson Atë dhe vepron sipas normave të vendosura prej Tij, duke qenë i sinqertë në besim dhe veprim. Që një vepër të jetë e vlefshme tek Allahu, duhet të plotësojë dy kushte: e para, të jetë sipas normave të vendosura nga Allahu Teala ose i Dërguari i Tij dhe e dyta, të jetë e sinqertë, duke iu dedikuar vetëm Allahut. Nëse vepra humb njërin nga këto kushte, bëhet e pavlefshme. Kur personi nuk plotëson kushtin e sinqeritetit, quhet hipokrit, kurse kur nuk plotëson kushtin e saktësisë, konsiderohet i devijuar, prandaj Allahu e ka cilësuar se zbatuesi i veprës duhet të jetë ndjekës i fesë së pastër të Ibrahimit (a.s.). Kur besimtari i plotëson të dyja kushtet, arrin gradën e "ihsanit", që do të thotë, ta adhurosh Allahun, sikur e shikon. Nëse ti nuk e sheh Atë, të jesh i bindur se Ai të shikon ty. Pra, të ndjesh mbikëqyrjen e Allahut në çdo veprim dhe moment. Kushti më i vështirë për t'u plotësuar nga besimtarët e pastër, mbetet sinqeriteti. Sinqeriteti do të thotë që çdo vepër ta bësh vetëm për hir të Allahut dhe ta mbash zemrën larg syfaqësisë, përfitimeve dhe interesave personale. Pejgamberi (a.s.), në një hadith thotë: *“Kush përfiton dituri, jo për hir të Allahut, por për të arritur disa qëllime në këtë botë, nuk do ta ndjejë aromën e xhenetit, në ditën e gjykimit.”* (Ebu Davudi) Të gjitha veprat vlerësohen sipas sinqeritetit. Një vepër e vogël dhe e parëndësishme në dukje, arrin nëpërmjet sinqeritetit, gradat më të larta tek Allahu. Për veprat, sinqeriteti është në rolin e shpirtit. Veprat nuk mund të bëjnë dot pa sinqeritetin. Allahu i ka urdhëruar të gjithë pejgamberët dhe popujt e tyre, që ta adhurojnë Allahun me sinqeritet dhe sipas mënyrës që u është komunikuar pejgamberëve: ***“E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zeqatin. Kjo është feja e drejtë.”*** (Bejine)

Një Hadith

*Ebu Hurejra, (r.a.) transmeton
se Resulullahi (s.a.v.s.) ka thënë:*



“Allahu nuk shikon formën trupore dhe fizionominë tuaj, por zemrat tuaja.”

Rreth transmetuesit:

Ky hadith transmetohet nga sahabiu i nderuar, Abdurrahman ibn Sahr, i njohur me emrin Ebu Hurejra. Ebu Hurejra (r.a.), e pranoi islamit në vitin e shtatë, pas emigrimit të myslimanëve në Medine. Ai qëndronte gjithmonë pranë Profetit (a.s.), duke treguar një zell të madh për të mësuar thëniet e tij. Është sahabiu që ka transmetuar më shumë hadithe profetike, plot 5374. Nga këto, 609 gjenden edhe në koleksionin e Buhariut edhe të Muslimit. Ka ndërruar jetë në moshën 78 vjeçare në Medine.

Komenti i hadithit

Njerëzit janë të prirur t'i vlerësojnë të tjerët nga pamja e jashtme. Në përgjithësi njerëzit që janë të bukur, të pasur, të pushtetshëm dhe të famshëm, janë më të vlerësuar në mesin e gjithë njerëzve të tjerë, kurse të varfërit dhe njerëzit jo të bukur nuk vlerësohen. Në fakt, këto janë kritere vlerësuese për njerëzit që janë larg botës shpirtërore. Kurse Allahu Teala, i vlerëson njerëzit nga veprat dhe sjelljet që burojnë prej zemrave të tyre. Kriteri kryesor për vlerësimin e njeriut është bukuria dhe pasuria shpirtërore dhe jo bukuria dhe pasuria materiale. Dhe më e rëndësishmja është, kur kjo bukuria dhe pasuria shpirtërore pasqyrohet me sjellje të mira dhe ibadet të sinqertë. Kryerja e veprave të mira dhe të sinqerta janë cilësitë që nxjerrin në pah vlerën e vërtetë të njeriut dhe e lartësojnë atë tek Allahu Teala. Duke përforcuar hadithin e mësipërm, Allahu Teala thotë në Kuran: **“As pasuria juaj, as fëmijët tuaj nuk do t’ju afrojnë më shumë te Ne, por vetëm ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira (e meritojnë këtë). Ata do të kenë shpërblim të shumëfishtë për atë që kanë bërë dhe do të jenë të sigurtë në banesa të larta (në xhenet)”**. (Sebe, 37)

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Allahu i vlerëson ibadetet dhe veprat e tjera të mira, sipas qëllimit dhe sinqeritetit.
2. Ajo që ka vlerë dhe rëndësi tek njeriu, është pasuria dhe bukuria shpirtërore.
3. Ajo që i bën të pranueshme dhe të vlefshme veprat, është zemra. Prandaj i duhet dhënë rëndësi asaj, duke e pastruar dhe ruajtur nga ndjenjat e këqija, si zilia, urrejtja etj.



TË NXITOSH NË PUNË TË MIRA

Allahu i Lartmadhëruar, në suren Asr, duke u betuar **“për kohën”**, na tërheq vëmendjen drejt kuptimit dhe përbërjes së jetës.

Koha është si një thikë me dy presa. Nëse shqyrtohet në atmosferën e Kuranit dhe të Sunetit, ajo nuk është asgjë tjetër veçse mjet për të fituar xhenetin. Ndërsa për ata që i janë dorëzuar nefsit të tyre, koha është si një vërshim prurjesh. Nuk duhet që njeriu të bëhet si një kërcu fatkeq në mesin e këtij vërshimi prurjesh.

Kohën që ke humbur nuk mund ta zotërosh më. Koha nuk mund të grumbullohet, nuk mund të merret a të jepet borxh, nuk mund të blihet. Njeriu edhe në qoftë se jep gjithë pasurinë e tij, nuk mund ta shtyjë, vonojë apo tjetërsojë exhelin (vdekjen) e tij.

Jeta e kësaj bote është faza përgatitore për në botën e përtejme, është si një thesar, pronari i të cilit je ti, por në mënyrë të përkohshme. Prandaj jetës duhet t’i dihet mirë vlera dhe t’i jepet asaj çfarë meriton. Ta shkatërrosh mirësinë e jetës, është një gabim i cili nuk mund të kompensohet më. Ta çosh dem kohën, duke vrapuar pas dëshirave të nefsit, a thua se ajo (koha) nuk do të mbarojë kurrë, duke neglizhuar apo shtyrë vazhdimisht detyrat e robërisë ndaj Zotit, do të bëhet

një pendim pikëllues në frymën e fundit!..

Jeta, një korridor kaq i ngushtë, që nga djepi e në tabut, përbëhet nga një numër i caktuar frymësh. Ky numër është i paditur për njeriun. Ndër këto frymë, sigurisht ajo që të shtyn të mendosh më shumë, është **“fryma e fundit”**. Fryma e fundit, me përfundimin e kësaj jete dhe me fillimin e tjetrës, përbën edhe momentin kritik të pikëprerjes së dy jetëve. Ky kalim është shumë i vështirë dhe i mundimshëm. Çdo besimtar me vizion dhe pjekuri, mendon dhe mediton thellë e në mënyrë të vazhdueshme, për këtë kalim kaq të vështirë, duke u përpjekur që t’i përshtasë të gjitha gjendjet e tij me frymën e fundit.

Fryma e fundit, që është edhe skena e fundit e jetës, është një pasqyrë në të cilën pasqyrohet qartazi fundi i çdokujt. Njeriu e njeh më së miri veten e tij, kur është përpara pasqyrës së frymës së fundit. Nuk duhet të harrojmë se, ndërsa ne mbi këtë tokë të përkohshme jemi duke konsumuar frymët tona, që janë copëza të çmuara të kohës, kamerat hyjnore janë duke regjistruar çdo moment. Kaseta e jetës që po mbushim, do të na jepet për t’u parë në një ditë kur do të urdhërohemi; **“Lexo librin tënd”**. Në atë çast, do ta njohim edhe më mirë veten tonë.

Për arsye se ne nuk e dimë kohën e frymës së fundit, sot është dita e përgatitjes për një llogari që do të na lumturojë në jetën e pafundme. Ky është thelbi i punëve të mira, të cilat janë furnizimi ynë për në botën tjetër. Në hadithet fisnike, paralajmërohem se do të japim llogari për çdo të mirë që zotërojmë dhe na këshillohet që të mos jemi të pavëmendshëm në lidhje me këto të mira. Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

“Në ditën e Kiametit (gjykimit), asnjë rob nuk do të lëvizë nga vendi pa u pyetur se ku e ka harxhuar jetën, çfarë ka vepruar me diturinë e tij, si e ka fituar dhe si e ka shpenzuar pasurinë dhe ku e ka konsumuar trupin e tij.” (Tirmidhi, Kiamet, 1)

“Shfrytëzo pesë gjëra, pa ardhur pesë të tjera: Rininë, pa ardhur pleqëria, shëndetin, pa ardhur sëmundja, pasurinë, pa ardhur varfëria, kohën e lirë, pa ardhur angazhimi, jetën, pa ardhur vdekja.” (Buhari, Rikak, 3; Tirmizi, Zuhd, 25)

RËNDËSIA E NXITIMIT NË DHËNIEN E SADAKASË

Rëndësinë e nxitimit në dhënie e sadakasë, Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na e ka treguar me dhjetëra shembuj gjatë gjithë jetës

së tij. Njërin prej këtyre shembujve e sjell Ukbe bin Harisi (r.a.), i cili thotë:

Një herë, isha duke falur namazin e ikindisë pas Resulullahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Resulullahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, pasi dha selam, u ngrit me shpejtësi dhe, duke nxituar, shkoi në dhomën e njëres prej bashkëshorteve. I gjithë xhemati u shqetësua prej nxitimit të tij. Por pas pak, Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, u kthye përsëri. Pasi e vuri re se xhemati ishte shqetësuar prej asaj që ndodhi, filloi të shpjegojë duke thënë:

“U kujtova se në dhomën tonë ndodhej pakëz flori (ose argjend). Prandaj, që të mos më pengonte për nxitim në punë të mira, urdhërova që të shpërndahej.” (Buhari, Ezan 158, el-Amel fi's-Salat 18; Nesai, Sehv, 104)

Në një hadith tjetër, Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

“Nxitoni në dhënie e sadakasë, sepse ajo pengon fatkeqësitë.” (Hejthemi, Mexhmau'z-Zeuaid, III, 110)

Siç është më i vlefshëm namazi, kur falet në kohën e tij, ashtu edhe sadakaja është më e vlef-



*“Shfrytëzo pesë gjëra,
pa ardhur pesë të tjera:
Rininë, pa ardhur pleqëria,
pasurinë, pa ardhur varfëria,
kohën e lirë, pa ardhur angazhimi,
jetën, pa ardhur vdekja.”*

(Buhari, Rikak, 3)

shme kur jepet pa u vonuar. Ky moral profetik, ka gjetur zbatim veçanërisht në jetën e dijetarëve, të cilët janë edhe trashëgimtarët e profetëve. Një ndodhi mësimdhënëse është edhe kjo ngjarje e Hasan Basriut (Allahu e mëshiroftë!):

Një nxënës kërkon diçka prej Hasan Basriut dhe ai ngrihet menjëherë e i jep këmishën e vet. Ata që ndodheshin aty thanë:

- O Hasan, do të ishte më mirë të shkoje dhe t'i jepje diçka prej shtëpisë!

Hasan Basriu tha:

- Një herë, një i varfër erdhi në mesxhid dhe tha: "Kam uri". Ne u treguam të pakujdesshëm dhe nuk i sollëm menjëherë diçka për të ngrënë. E lamë atë në mesxhid dhe shkuam në shtëpitë tona. Kur erdhëm në namazin e sabahut, pamë se ai kishte vdekur. E qefinosëm dhe e varrosëm. Ditën tjetër, në një aspekt shpirtëror, tek mihrabi pashë qefinin me të cilin kishim qefinosur njeriun e varfër dhe mbi të shkruhej: **"Merreni qefinin tuaj. Allahu nuk e pranoi!"**.

Atë ditë u betova: "Këtej e tutje, nëse shoh ndonjë nevojtar, nuk do t'ia vonoj ndihmën." (Suyuti, Tarihu'l-Hulefa, s. 103.)

Ja pra, Allahu i Madhëruar, ua qartëson në mënyrë të mahnitshme robërve të Tij të dashur, disa të vërteta. Qëllimi është që të ndikojë në zemrat e njerëzve dhe t'i udhëzojë në rrugën e drejtë. Nga kjo ndodhi, kuptojmë se vlera dhe fisnikëria e një të mire është kur bëhet në kohën e vet, pa u vonuar.

NJË PAMJE MËSIMDHËNËSE NGA FRYMA E FUNDIT.

Ja se si na e pasqyron Rebi bin Hejthem (Allahu e mëshiroftë!) gjendjen e trishtuar të njeriut që i shtyn punët e mira për më vonë dhe që nuk e ka pastruar shpirtin e tij:

"Njeriu e dorëzon shpirtin e tij ashtu siç ka jetuar. Një herë u gjenda pranë një njeriu i cili po jepte shpirt. Unë e këshilloja të thoshte "La il-lahe il-lallah!" por ai lëvizte gishtat sikur po numëronte



paratë."

Në të shumtën e rasteve, njeriu i shtyn punët e mira duke thënë "e bëj më vonë", por "më vonë" nuk gjen më kohë. Për këtë arsye, njerëzit e ditur kanë thënë: *"U shkatërruan ata që thanë -e bëj nesër-",* sepse në çdo moment mund të vijë një ditë e cila nuk ka të nesërme.

Ebu Hurejre tregon:

Një njeri erdhi tek Resulullahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem dhe e pyeti se cila sadaka e ka shpërblimin më të madh. Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, u përgjigj:

"Sadakaja të cilën e jep kur je i shëndetshëm, dorështrënguar, i frikësuar nga varfëria dhe dëshiron pasuri. Mos e vono atë (dhënien e sadakasë), deri kur të të afrohet vdekja dhe pastaj të thuash: «Jepini filanit kaq e filanit aq». Në të vërtetë, pasuria jote do të ndahet. Do t'i atij e këtij (sipas rregullave të trashëgimisë)." (Buhari, Zekat, 11)

Në një hadith tjetër profeti sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

"Një dirhem që jepet sadaka, kur njeriu është i shëndetshëm, është më i vlefshëm se njëqind dirhem që jepen sadaka, kur ai është duke vdekur." (Ebu Daud, Vasaja, 3/2866)

Shejh Sadi, duke u frymëzuar nga kjo e vërtetë, këshillon:

"Furnizimin për në botën tjetër, bëje vetë! Sepse, pasi të kesh vdekur, të afërmit e tu mund t'i kapë

*“Një dirhem që jepet sadaka,
kur njeriu është i shëndetshëm,
është më i vlefshëm se njëqind
dirhem që jepen sadaka,
kur ai është duke vdekur.”*



ambicia dhe nuk bëjnë asnjë bamirësi për shpirtin tënd. Floririn dhe të mirat që ke, jepi sot sa je gjallë! Pasi të kesh vdekur, këto të mira nuk mund t'i kesh më!

Ai që e përgatit vetë furnizimin për në botën tjetër, ka bërë punën më të rëndësishme. Kurrizin tim, duke menduar për mua, mund ta kruajë vetëm thoi im dhe askush tjetër.

Çfarëdo lloj pasurie të kesh, vendose në pëllëmbë të dorës dhe jepe aty ku duhet dhënë! Nëse nuk jep, nesër do të pendohesh dhe do të kafshosh duart.”

Me të vërtetë, nëse ke pasuri dhe nuk e jep në kohën e duhur, por ua lë trashëgim atyre që nuk kanë edukim shpirtëror dhe nuk dinë se si ta harxhojnë atë, në botën tjetër do të kesh mbi supe një llogari të rëndë. Kjo nuk është puna e një mendjeje të shëndoshë.

Sa urtësi ka në këto fjalë të Ebu Dherrit (r.a.):

“Një mall ka tre ortakë. I pari është i zoti i mallit, pra, ti. I dyti është kaderi (caktimi). Se çfarë do të të sjellë (ai mall), mirësi apo fatkeqësi, nuk të pyet ty. Ndërsa i treti është trashëgimtari yt. Ai pret me padurim që ti ta vësh kokën në tokë (të vdesësh) dhe, pasi të kesh vdekur, ai merr mallin tënd, kurse ti jep llogari për të. Nëse ke mundësi, mos u bëj më i dobëti i këtyre tre ortakëve!..” (Ebu Nuajm, Hilje, I, 163)

Njerëzit e kamur që falimentojnë kur vdesin, e kujtojnë veten e tyre të pasur në këtë botë fantazish. Por kur zgjohen me vdekjen në më-

ngjesin e së vërtetës, shohin se nuk zotërojnë asgjë nga ato që kishin në këtë botë. Këta pra janë të varfërit e pafundësisë. Pasuria e vërtetë, është të mos falimentosh me ardhjen e vdekjes. Pra, të arrish pasurinë e përjetshme.

I nderuari Mevlana thotë:

“Kjo botë nuk është tjetër, veçse një ëndërr. Të jesh i pasur në këtë botë, është si të gjesh një thesar në ëndërr. Pasuria e kësaj bote qëndron po në këtë botë duke u trashëguar nga brezi në brez.”

“Kur meleku i vdekjes i merr shpirtin të pasurit të pakujdesshëm, e zgjon atë nga gjumi i kësaj bote. Ndërsa ai, i habitur bën “o bobo” kur kupton se në këtë botë qenka rropatur për një pasuri që në të vërtetë nuk është e tij. Mirëpo, tashmë çdo gjë ka mbaruar.”

Pasi të kenë hyrë në dhe, edhe i varfëri edhe i pasuri bëhen e njëjta gjë. Çfarë të kenë vepëruar, atje do ta gjejnë. Ata që shkojnë nga kjo botë, le të shkojnë në daç si skllëvër, në daç si mbretër, kapitali i tyre do të jetë vetëm ajo që kanë marrë me vete. Atje është vendi ku ndahet shapi nga sheqeri. Ku vihet nën këmbë tirani që shëtiste mbi kokat e njerëzve. Ku shumë skllëvër do të jenë mbretër dhe shumë mbretër do të jenë skllëvër. Ku do të fshihen të gjitha postet dhe gradat të cilat nuk janë përdorur për hir të Allahut. Ku shumë të varfër do të bëhen të pasur dhe shumë të pasur të pakujdesshëm do të bëhen të varfër të përjetshëm dhe lypësit e mahsherit¹. Atje do të bëjnë dobi vetëm besnikëria e robit ndaj Allahut dhe zemrat e sinqerta dhe të drejta.

Në krye të gjërave, me të cilat Allahu i Madhëruar e sprovon njeriun në këtë botë, janë jeta, pasuria dhe fëmija. Nëse këto përdoren në rrugë të drejtë, janë mirësi, por nëse përdoren në rrugë të gabuar, bëhen shkak i një dënimi të dhembshëm. Ai që na e tregon të vërtetën të vërtetë dhe mirësinë mirësi, është vetëm zëri i fesë.

Në një ajet fisnik urdhërohet:

¹.Vendi ku do të mblidhen njerëzit për tu gjykuar në ditën e kiametit.

“O besimtarë! Mos lejoni që pasuria dhe fëmijët tuaj t’ju largojnë nga të përmendurit e Allahut. Ata që e bëjnë këtë, do të humbin. Prandaj jepni prej atyre mirësive që ju kam dhënë Unë, para se t’i vijë vdekja ndonjërit e ai të thotë: “O Zoti im! Sikur të më kishe lënë edhe një kohë të shkurtër në jetë, do të kisha dhënë lëmoshë dhe do të bëhesha ndër të mirët!” (El-Munafikun, 9-10)

Ndërsa gjendjen e atyre që, me pakujdesinë e tyre e çojnë dëm jetën e kësaj bote, Allahu i Madhëruar e shpreh kështu:

“Atje ata do të thërrasin: “O Zoti ynë! Nxirrna se do të bëjmë vepra të mira e jo nga ato që kemi bërë.” (Atyre do t’u thuhet): “Vallë, a nuk jua zgjatëm jetën aq sa të mund të mendohej ai që donte të kujtonte (Allahun)?! Madje, juve ju erdhi edhe paralajmëruesi. Ndaj, shijoni (dënimin)! Për keqbërësit nuk ka kurrfarë ndihmësi!” (El-Fatir, 37)

I nderuari Imam Gazzaliu na këshillon:

“Biri im! Mendo sikur vdiqe dhe u ktheve prapë në këtë botë. Mendo për emocionet e asaj gjendjeje! Që sot e tutje mos i afro gjynahut dhe mosbindjes dhe mos e çoj dëm asnjë çast të kësaj dite, sepse çdo frymë është një mirësi e paçmueshme.”

Pra, çdo ditë e re që na hapet prej kalendarit të jetës, duhet ta vlerësojmë si një afat të ri. Prandaj, pa humbur kohë, të nxitojmë në punë të mira.

ÇDOKUSH NDJEN PENDESË...

I Dërguari i Allahut, sal-lall-llahu alejhi ve sellem, për të na paralajmëruar ne, umetin e tij, ka thënë:

“Çdo njeri që vdes, pendohet.”

Kur u pyet: “Çfarë është ai pendim, o i Dërguari i Allahut?”. Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sellem, u përgjigj:

“(I vdekuri), nëse ka qenë një njeri i devotshëm, do të pendohet se pse nuk ka mundur ta shtojë

“O besimtarë! Jepni pa u kursyer nga të mirat që ju kemi dhënë Ne, para se të vijë Dita (e Gjykimit), në të cilën nuk ka shitblerje, as miqësi, as ndërmjetësi! Jobesimtarët janë keqbërësit e vërtetë.”



edhe më tepër këtë devotshmëri, por, nëse ka qenë njeri i keq, do të pendohet se pse nuk e ka rregulluar gjendjen e tij, duke hequr dorë nga e keqja.” (Tirmidhi, Zuhd, 59/2403)

Pra, edhe vepërmirët do të pendohen, se nuk i kanë shfrytëzuar më tepër të mirat që zotëronin në rrugë të Allahut. Ndërsa pendesa e të pakujdesshmëve as që mund të tregohet me fjalë.

Pyetjes se “Çfarë ka më shumë nën tokë?”, i nderuari Behlul Dana, i përgjigjet vetë duke thënë: “Ka thëniet e të vdekurve - ah sikur - i mjeri unë!”. Atëherë, pa ardhur ende dita e pendesës, të nxitojmë në çdo punë që gjendet kënaqësia e Allahut dhe të ruhemi nga shpenzimi i kohës sonë me gjëra të kota. Me vetëdije të thellë ta jetojmë çdo ditë si ditën tonë të fundit dhe me një zemër vigjëlente ta mbushim kohën me punë të mira.

Allahu i Madhëruar i këshillon robërit e Tij, të cilët në shumicën e rasteve e çojnë dëm kohën e tyre, kështu:

“Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpiqu fort (në adhurim) dhe përkush-tohu vetëm ndaj Zotit tënd!” (El-Inshirah, 7-8)

Kur të mbarosh një punë të mirë ose adhurim, nxito menjëherë në një punë apo adhurim tjetër. Pra, asnjë moment të jetës sate nuk duhet ta kalosh larg bamirësisë dhe adhurimit. Sa bukur e thotë Mevlana i nderuar:

“Prova se adhurimet e tua janë pranuar, është nxitimi yt për në adhurime të tjera të njëpasnjëshme, menjëherë pas adhurimeve të para.”

Siç thotë përsëri Mevlana:



“Duhet të japësh çdo gjë që duhet dhënë, pa ta marrë vdekja atë që të është dhënë.”

Ndërsa në një ajet fisnik urdhërohet kështu:

“O besimtarë! Jepni pa u kursyer nga të mirat që ju kemi dhënë Ne, para se të vijë Dita (e Gjykimit), në të cilën nuk ka shitblerje, as miqësi, as ndërmjetësi! Jobesimtarët janë keqbërësit e vërtetë.” (El-Bekare, 254)

Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në një hadith të nderuar thotë:

“Nxitoni në punë të dobishme, sepse në një të ardhme të afërt, disa fitne (ngatërresa) do ta kaplojnë vendin siç e kaplojnë netët e errëta. Në atë kohë, njeriu do të gdhiet besimtar dhe do të ngryset si kafir (mohues). Do të ngryset besimtar dhe do të gdhiet kafir. Ndërsa fenë e tij do ta shesë për diçka të vogël.” (Muslim, Iman 186; Tirmidhi, Fiten 30, Zuhd 3)

Prandaj, nxitimi në punë të mira dhe përgatitja për të udhëtuar në botën tjetër, duhet të jetë qëllimi kryesor i çdo besimtari. Nuk duhet të mashtrohemi prej të mirave kalimtare të kësaj bote dhe, pa harruar se ato të mira që zotërojmë janë si thesari i gjetur në ëndërr, të përgatitemi për botën e vërtetë dhe të përgjeshme.

PASURIA E VËRTETË ËSHTË AJO QË NJERIU DËRAGON NË BOTËN TJETËR

Familja e Profetit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kishte bërë kurban një dele dhe mishin e saj e

kishte dhuruar. Kur Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, pyeti se çfarë kishte ngelur prej deles, u përgjigjën:

“Ka ngelur vetëm kocka e kofshës.”

Por Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, me largpamësinë e tij profetike u shpreh:

“Pse nuk thoni se përveç kockës së kofshës, e gjitha na paska ngelur ne!” (Tirmidhi, Kiamet, 33)

Abdullah bin Shihhir (r.a.), tregon:

- Një ditë, Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, po lexonte suren Tekathur. Kur e mbaroi së lexuari, tha:

“Biri i Ademit rri veç duke thënë, pasuria ime, pasuria ime. O biri i Ademit! A mos ke pasuri tjetër përveç asaj që ha dhe konsumon, asaj që vesh dhe e vjetëron dhe asaj që e dërgon në botën tjetër si shpërblim që ke fituar, duke dhënë sadaka!?” (Muslim, Zuhd, 3-4)

Ndërsa në një hadith tjetër, Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na sjell një skenë prej ditës së kiametit:

“Allahu do të flasë me ju pa përkthyes. Njeriu do të shohë në të djathtë dhe nuk do të vërejë, përveçse ato që ka dërguar më parë në botën tjetër. Do të shohë në të majtë dhe nuk do të vërejë, përveçse ato që ka dërguar më parë në botën tjetër. Do të shohë përballë dhe nuk do të vërejë, përveç xhehenemit. Prandaj, edhe sikur të mos keni asgjë, ruajeni veten prej zjarrit të xhehenemit, qoftë edhe me një gjysmë hurme. Ndërsa ai që nuk e gjen edhe atë, ta ruajë veten, qoftë edhe me një fjalë të mirë (duke i fituar zemrën diku).” (Buhari, Zekat, 9-10, Rikak, 31, Teuhid, 36)

Pra, të mirat apo të këqijat, me të cilat do të përballë njeriu në botën tjetër, varen nga ato që ai bën në këtë botë. Për këtë arsye edhe Allahu i Madhëruar i ka paralajmëruar besimtarët në këtë mënyrë:

“O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe çdo

njeri le të shikojë se çka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju!” (El-Hashr, 18)

Shejh Sadiu thotë:

“Njerëzit e mençur e marrin pasurinë e tyre edhe kur shkojnë në botën tjetër. Ndërsa dorështrënguarit shkojnë duke lënë gjithçka në këtë botë.”

SHPËTO PREJ SËMUNDJES SË KOPRRACISË!..

Të bëhesh koprrac dhe të qëndrosh larg bamirësisë, vë në rrezik jetën e botës tjetër. Në një ajet fisnik, Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Shpenzoheni pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit.” (El-Bekare, 195)

Pasuria dhe malli që nuk shpenzohet në rrugë të Allahut, janë si shoku i pabesë. Vjen një ditë, kur ato mbarojnë dhe e tregojnë pabesinë e vet, duke e lënë njeriun të varfër dhe të mjerë. Ata që shpresojnë besnikëri prej pasurisë dhe mallit, duhet t’i dërgojnë në botën tjetër, duke i shpenzuar ato në rrugë të Allahut. Për këtë, duhet të shpëtosh prej koprracisë së egos. Në një ajet fisnik shprehet shumë mirë se, për të arritur shpëtimin e përjetshëm, duhet të shpëtosh prej koprracisë:

“...Kushdo që ruhet nga ambicia dhe koprracia e egos, me siguri që do të jetë fitues.” (El-Hashr, 9)

Mirëpo, iblisi, për t’ia nxirë të ardhmen njeriut, aplikon çdo lloj dredhie, duke hedhur në zemrat

e tyre farën e dyshimit. Megjithëse rrishtun e jep Allahu, ai (iblisi) mundohet të ndikojë në mendjen e njeriut. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Shejtani ju frikëson me skamje e varfëri dhe ju urdhëron të bëni vepra të pamoralshme. Kurse Allahu ju premtot faljen dhe mirësinë e Tij...” (El-Bekare, 268)

Halifi i katërt, Aliu (r.a.), i cili i njihte mirë këto dredhi të shejtanit, valitë (prefektët) e tij i këshillonte gjithmonë të ishin altruistë dhe bujarë:

“Kini kujdes! Në këshillin tuaj, mos e fusni koprracin, i cili do t’ju frikësojë me varfëri dhe do t’ju pengojë nga bamirësia! Mos fusni as frikacakun, i cili do t’ju dobësojë ambicien për punë të mëdha. Gjithashtu, mos fusni as lakmitarin, që do t’ju aëmbëlsojë lakminë, e cila do t’ju çojë në padrejtësi!”

Atyre që shpëtojnë prej koprracisë së egos dhe dyshimeve të shejtanit, nuk do t’u humbë asgjë nga ajo që kanë dhuruar. E dinë shumë mirë se ajo që kanë dhënë, është kthyer në një kapital lumturie, që po i

pret në botën tjetër. Në lidhje me këtë, Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

“Për tri gjëra mund të flas duke u betuar. Dëgjojini mirë: Nuk pakësohet pasuria duke dhënë sadaka. Allahu ia shton fisnikërinë atij që duron, kur i bëhet padrejtësi. Atij që hap derën e lypjes, Allahu i hap derën e varfërisë...” (Tirmidhi, Zuhd, 17)

Sa bukur e shpreh Mevlana faktin se sadakaja nuk e pakëson pasurinë:

“A mund të mos mbijë fara e pastër dhe e shë-



“Shpenzoheni pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit.”

(el-Bekare, 195)

ndetshme që hidhet në tokën e Allahut?”

“Nëse kjo tokë e përkohshme dhe kalimtare nuk resht së dhëni bimë, fruta dhe prodhime të ndryshme, a është e mundur që bota e vërtetë (dhe e përjetshme) e cila është më e gjerë se ajo, të mos japë frytet e saj?”

“Prodhimi që jep toka e kësaj bote është i pallogaritshëm. Madje edhe prej një kokrrë dalin shtatëqind të tjera. Shikoje mirë këtë dhe kuptoje vetë se sa do të jetë prodhimi i botës tjetër! Nuk pakësohet pasuria duke dhënë sadaka. Bamirësia e ruan pasurinë!”

Adhurimet dhe punët e mira, të cilat përbëjnë kapitalin e paçmueshëm të çdo çasti të jetës së kësaj bote, janë xhevahiret e përjetësisë dhe farat e botës tjetër. Nëse njeriu i mbjell këto farëra në tokën e kësaj bote, do t'i korrë ato në botën tjetër. Por, nëse hutohet dhe i çon dëm, duke i hedhur në rrugën e dëshirave të egos, ku do të zvarriten në rrëketë dhe vorbullën e së keqes, këto farëra do të kthehen në fryte të xhehene-mit. Mjerë për ta! Ndërsa koha që zbukurohet me shpirtin e Kuranit dhe Sunetit, është fara e lumturisë që do të lulëzojë në kopshtet e përjetshme të xhenetit.

Pra, ndërsa pasuria që nuk shpenzohet në rrugë të Allahut është si një shok i pabesë, ajo që shpenzohet në rrugë të Allahut është si një shok besnik. Këtë e shprehin shumë bukur edhe këto hadithe:

“Sa shok i mirë është pasuria për një mysliman! Mjafton që atë pasuri t'ia japë të varfrit, jetimit dhe udhëtarit!” (Ahmed, III, 21)

“Derisa të fillojë llogaridhënia (në ditën e gjykimit), të gjithë do të jenë nën hijen e sadakasë.” (Ibën Hibban)

Ndërsa Ubejd bin Umejr (r.a.), në lidhje me këtë çështje, thotë:

“Në ditën e kiametit, njerëzit do të ringjallen me një uri dhe etje të madhe dhe të zhveshur. Mirëpo, Allahu do ta ushqejë atë që ka ushqyer për hir të Tij. Do t'i japë të pijë atij që ka dhënë të pijë për hir të

Tij dhe do të veshë atë që ka veshur për hir të Tij.”

Në një ajet fisnik, Allahu i Madhëruar shprehet kështu, në lidhje me ata që do të shpëtojnë në ditën e vështirë të kiametit:

“Ata që japin nga pasuria e tyre natën dhe ditën, fshehurazi dhe haptazi, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre; ata nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen.” (El-Bekare, 274)

Me një fjalë, duke e kthyer dhurimin në një pjesë të natyrës, të mundohemi që në çdo kohë dhe me të gjitha mundësitë të dhurojmë dhe të nxitojmë në punë të mira, duke e ditur vlerën e kohës. Allahu i Madhëruar urdhëron; ***“Betohem në agimin!”***. Çdo agim hap për ne një faqe të re nga kalendari i jetës. Si do ta mbushim këtë faqe? Sa do të punojmë për veten dhe sa do të jemi altruistë dhe të gjendemi pranë të mjerëve dhe të të vetmuarve? Çfarë do të shkruajnë melekët Kiramen Katibin në dosjen tonë? Ja pra, besimtari duhet ta shpenzojë kohën e tij në punë të mira, duke analizuar këto të vërteta me një zemër të pastër. Duhet që fjalët e Omerit (r.a.): *“Gjykojeni veten, para se të gjykoheni (nga Allahu)”*², t'i bëjë parim të jetës së tij.

Për ne është e rëndësishme të jemi të përgatitur që të dalim me zemër të pastër para Allahut, në ditën kur të përmbushet kontrata e jetës sonë dhe në ditët në vijim.

Ashtu siç thotë edhe Omer bin Abdulaziz (Allahu e mëshiroftë!):

“Përgatituni për të shkuar në botën tjetër, atje ku dëshironi!”

E mbyllim fjalën tonë, duke i thënë “amin” kësaj duaje të Ebu Bekrit (r.a.):

“O Allah! Bëj që periudha më e mirë e jetës sime të jetë fundi, pjesa më e mirë e punëve të mia të jetë rezultati dhe dita më e mirë e ditëve të mia të jetë dita, kur do të takohem me Ty.” (Sujuti, Tarihu'l-Hulefa, faq 103)

Amin!

2. Ibën Kethir, Tefsir, I, 27.

Pijet dehëse dhe droga

Ma. sci. Flamur Sofiu

"O ju që besuat! S'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall), janë vepra të ndyra nga shejtani. Pra largohuni prej tyre, që të jeni të shpëtuar. Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveçse nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedhë armiqësi mes jush, t'ju pengojë nga të përmendurit e Zotit dhe t'ju largojë nga namazi. Pra, a po i jepni fund (alkoolit e bixhozit)?"¹

HYRJE

Në të drejtën islame shohim se nuk ka çështje dhe fenomen që të mos ketë shpjegime dhe sqarime të hollësishme, sepse sheriatu islam është i zbatueshëm në çdo kohë dhe në çdo vend. Pa dyshim se pijet dehëse dhe llojet e drogave janë një sfidë shumë e madhe për shoqërinë njerëzore në përgjithësi. Pikërisht për këtë sheriatu islam ka parashikuar rregulla dhe masa ndëshkuese për secilin që konsumon pije dehëse dhe ndonjë lloj të drogës. Kur lexojmë librat e jurisprudencës islame, shohim se ata kanë përdorur për pijet dehëse shprehjen (حد الشرب), "masat ndëshkuese për pijet dehëse", me të vetmin qëllim që të bëjnë te qartë se çdo lloj pijeje që përmban elementin e dehjes, të konsiderohet e ndaluar dhe të zbatohen sanksionet e caktuara. Dihet fare mirë se në ajetet kuranore është përdorur shprehja (الخمر) "vera", por çfarë synon kjo shprehje e ka shpjeguar më së miri i Dërguari (s.a.v.s.), kur ka thënë: "Çdo pije dehëse është

1. El-Maidetu: 90-91

verë dhe çdo verë është haram"² Ligjet dhe rregullat islame janë treguar shumë efektive në pengimin e përhapjes së këtij fenomeni, ndërsa ligjet njerëzore, të cilat i kanë përcaktuar shumica e sistemeve shoqërore, shumë pak ose fare kanë pasur sukses. Është gabim i madh që dikush të mendojë se feja islame ka përcaktuar norma shumë të ashpra kundër konsumimit të pijeve dehëse dhe llojeve të ndryshme të drogës. Sheriatu islam i ka mbyllur të gjitha rrugët që dërgojnë deri te konsumimi i pijeve dehëse, sa që e ka mallkuar çdo njërin, i cili ndihmon qoftë direkt apo indirekt në konsumimin e këtyre pijeve.

Urtësitë e ndalimit të konsumimit të pijeve dehëse dhe drogës i di më së miri Allahu i Lartësuar e neve si mysliman na mbetet t'i nënshtrohemi urdhrat dhe ndalesës që sjell Ai. Në të njëjtën kohë, ne kemi bindje të prerë se çdo urdhër apo ndalesë që vjen prej Krijuesit, është në dobinë e njerëzimit, pavarësisht nëse jemi në gjendje ta kuptojmë apo jo urtësinë e saj. Njëra prej tyre është se pija dehëse përbën burimin e të gjitha të këqijave, duke i shkaktuar dëme të mëdha shoqërisë dhe konsumuesit, ngaqë nën ndikimin e pijeve dehëse njeriu mund të bëjë shumë veprime të dëmshme dhe të rrezikshme.

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOHEN PËR ZBATIMIN E DËNIMIT PËR PIJET DEHËSE

Për t'u zbatuar dënimet e përcaktuara me sheriat,

2. Transmeton: Muslimi

që kanë të bëjnë me konsumimin e pijeve dehëse, duhet doemos të plotësohen disa kushte:

1. Konsumuesi i pijeve dehëse të jetë i shëndoshë në aspektin mendor. Nëse personi që ka konsumuar pije dehëse është me të meta mendore, ndaj tij nuk mund të zbatohet asnjë masë ndëshkuese.

2. Konsumuesi i pijeve dehëse të jetë i moshës madhore. Fëmija, i cili ende nuk ka hyrë në moshën madhore, nuk dënohet për dehje.

3. Konsumuesi të mos ketë presion për të konsumuar pije dehëse. Kur ndodh që dikush detyrohet nga dhuna dhe presioni të përdorë pije dehëse, nuk zbatohet dënimi, sepse nuk ka vepruar me vullnet të lirë. I Dërguari (s.a.v.s.), ka thënë: "Për umetin tim nuk konsiderohet si mëkat, kur ai bën ndonjë të keqe pa dashje apo nga harresa a presioni".

4. Konsumuesi ta ketë përdorur pijen dehëse vetëm e vetëm që të shpëtojë jetën. Kur ndodh që dikush detyrohet të përdorë pije dehëse për të shpëtuar prej vdekjes, ndaj tij nuk zbatohet asnjë dënim P.sh.: nëse dikush mbetet pa ujë dhe po i kanoset vdekja, atëherë i lejohet të përdorë pije dehëse, vetëm sa për të kaluar krizën e etjes.

5. Konsumuesi ta ketë të qartë se pijet dehëse janë të ndaluara në shariatin islam. Nëse ndodh që dikush, sapo e ka pranuar islamin dhe, ende nuk ka njohuri se pijet dehëse janë haram, ndaj tij nuk zbatohet asnjë dënim.

6. Konsumuesi të dijë se ajo që po konsumon është pije dehëse. Kur ndodh që dikush përdor ndonjë pije, por nuk e di që është dehëse, ndaj tij nuk zbatohet asnjë masë ndëshkuese.

TË VËRTETUARIT E KONSUMIMIT TË PIJEVE DEHËSE

Sipas ujdisë së të gjithë juristëve myslimanë, vërtetohet se dikush ka konsumuar pije dehëse sipas këtyre dy mënyrave:

1. Dëshmia. Kur dëshmojnë dy burra të drejtë myslimanë se filani ka konsumuar pije dehëse. Në rastin e dëshmisë mjafton që dëshmitarët të thonë se "filani ka konsumuar pije dehëse".

2. Miratimi. Nëse ai që ka konsumuar pije dehëse e pranon. Imam Ebu Jusufi (r.a.), është i mendimit se, kur bëhet miratimi nga vetë personi, ai duhet të shprehet dy herë.

Shënim: Nuk mund të vërtetohet duke u bazuar vetëm në aromën e pijes, ngase ekziston mundësia që të konsumohet ndonjë pije jodehëse që e ka aromën e njëjtë me pijen dehëse. Për këtë arsye, nuk lejohet të zbatohet dënimi për konsumimin e pijeve dehëse,

"O ju që besuat, s'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyra nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre, që të jeni të shpëtuar."



duke u bazuar vetëm në aromën e pijes. Imam Muhamedi (r.a.), mendon se duhet të pranohet dëshmia dhe miratimi edhe nëse konsumuesi nuk ka aromë të pijes dehëse, por dëshmia pranohet vetëm nëse nuk ka kaluar një muaj prej kohës së konsumimit.

NORMAT E PIJEVE DEHËSE:

1. Ndalohet konsumimi i pijes dehëse në çfarëdo sasive.

2. Ai, i cili me vetëdije e konsideron të lejuar konsumimin e pijeve dehëse, duke e ditur se është e ndaluar, bën vepër të mosbesimit (kufrit) dhe kështu del prej fesë islame.

3. Lejohet të pihet vetëm në raste të jashtëzakonshme. Pra, kur ndodh që njeriu është në rrezik jete dhe nuk ka mundësi për të shpëtuar, veç duke përdorur pijen dehëse. Në këtë rast i lejohet të konsumojë sa të kalojë krizën e jetës.

4. Nuk lejohet pasja, shërbimi, bartja, shitja, blerja, fitimi, prodhimi etj.

5. Për shkatërrimin apo asgjësimin e pijeve dehëse nuk ka siguri dhe kompensim.

6. Nuk lejohet të përdoret për ndonjë interes apo shërim. Për këtë, i Dërguari (s.a.v.s.), ka thënë:

7. Kur pija dehëse shndërrohet tërësisht në uthull, atëherë lejohet përdorimi i saj.

KONSUMIMI I DROGAVE DHE QËNDRIMI I SHERIATIT ISLAM NDAJ TYRE

Në analogji me pijet dehëse, na del në pah se droga është rreptësisht e ndaluar, duke parë se dehja, pa dyshim, është shumë më e qartë në drogë se sa në pijet dehëse. Ndaj të gjitha llojet e pijeve dehëse dhe të gjitha llojet e drogës konsiderohen haram. Mund të përmendim këto argumente për ndalimin e drogës:

a. Kategorizimi i drogës nën kuptimin e përgjithshëm të ajetit: "... u lejon ushqimet e këndshme dhe u ndalon ato të pakëndshmet...". (El-A'raf: 157) Po ashtu droga hyn në kuptimin e përgjithshëm të hadithit:



"Nuk ka dëm e as të dëmtuar (reciprok)". (Transmeton Ahmedi dhe Ibn Maxheh).

b. Droga hyn në kuptimin e hadithit, i cili transmetohet nga Ahmedi dhe Ebu Davudi, se Ummi Seleme-gruaja e Pejgamberit (s.a.v.s.), ka treguar: "Pejgamberi (s.a.v.s.), ka ndaluar çdo pije dehëse dhe çdo gjë që shkakton shkujdesje". Pra, drogat konsiderohen të ndaluara, për shkak se shkaktojnë shkujdesje...

c. Droga ndalohet me argumentet që ndalojnë verën, sepse njëlloj si vera edhe droga humb aftësinë e të gjykuarit dhe e bën njeriun të shkujdesur. Buhariu dhe Muslimi transmetojnë se prijësi i besimtarëve Umer bin el-Hatabi (r.a.), u ishte drejtuar njerëzve prej minberit të Pejgamberit (s.a.v.s.), duke u thënë: "Pije dehëse është çdo gjë që e humb aftësinë e të gjykuarit". Ndaj kjo thënie e përcakton se çfarë është pije dehëse, i mbyll mundësitë e pyetjeve të dyshuesve, dhe vendos ndalimin deri në ditën e kiametit.

Mbi këtë bazë, të gjitha materiet që njihen me emrin **drogë**, si hashashi, kokaina, afioni e të ngjashëm, kanë ndikim në humbjen e aftësisë së logjikës, ngaqë konsumuesi e mendon të afërt atë që është larg. Atij i paraqiten gjëra që nuk ekzistojnë në realitet. Noton nëpër dete duke ëndërruar, magjepset prej iluzioneve, aq sa harron veten, fenë dhe këtë jetë. El-Karafi dhe Ibn Tejmije kanë treguar se ekziston konsensusi i dijetarëve për ndalimin e hashashit. Ibn Tejmije ka thënë: "Kush e konsideron hashashin hallall, ka dalë prej besimit".

Shënim:

Disa nga dijetarët hanefitë janë të mendimit se ai që thotë se droga nuk është haram, është i pafe dhe bidatxhi (që sjell risi në fe). Ibn Tejmije (r.a.), është i mendimit se ai që e konsideron hallall drogën, ka bërë kufër (mosbesim). Imamët e medh'hebeve nuk kanë folur për drogën, ngase në kohën e tyre nuk ka qenë

e përhapur si në ditët tona.

TË FITUARIT ME DROGË

Të fituarit dhe të punuarit me drogë është vepër e ndaluar rreptësisht. Dijetarët islamë paraqesin këto argumente:

1. Në fjalën e Allahut (xh.sh.):

"Mos e hani pasurinë tuaj mes vete në mënyrë të padrejtë..."³

2. Në hadithin e të Dërguarit (s.a.v.s.), të cilin e transmeton Ibn Ebi Shejbe (r.a.), nga Ibn Abbasi (r.a.): "Vërtet Allahu, kur ka ndaluar diçka, ka ndaluar edhe fitimin prej saj".

Shënim:

Ekziston një pyetje, e cila parashtrrohet nga ana e disa njerëzve, se cili është qëndrimi për përdorimin e verës-alkoolit si ilaç (bar shërues)... Përgjigjen e ka dhënë vetë Pejgamberi (s.a.v.s.). Muslimi, Ahmedi dhe të tjerë, transmetojnë se një njeri e kishte pyetur Pejgamberin (s.a.v.s.), për çështjen e verës-alkoolit dhe ai i qe përgjigjur se është e ndaluar. E ai njeri i kishte thënë: "Unë e bëj atë si ilaç shërues". Pejgamberi (s.a.v.s.), ishte përgjigjur: "Ai nuk është ilaç, por sëmundje". Po ashtu, Ebu Davudi transmeton se Pejgamberi (s.a.v.s.), ka thënë: "Allahu ka dërguar sëmundjen dhe ilaçin, dhe për çdo sëmundje ka ilaç. Shërohuni, por mos kërkoni shërim në gjëra të ndaluara". Buhariu transmeton nga Ibn Mes'udi (r.a.), se Pejgamberi (s.a.v.s.), kur ka folur për pijet dehëse, ka thënë: "Vërtet Allahu nuk ka bërë shërim në ato gjëra që u ka ndaluar".

Të gjitha këto tekste (ajete dhe hadithe) argumentojnë në mënyrë të prerë se përdorimi i alkoolit si bar shërues është i ndaluar (haram) dhe se ai që e përdor ka bërë mëkat.⁴

Kur disa ilaçe kanë përmbajtje të pakët të alkoolit, dhe janë të domosdoshme, lejohet përdorimi, nëse vërtetohet se në to është shërimi, me kusht që përshkruarësi i barit të jetë mjek, mysliman i aftë dhe të ketë frikën e Allahut (xh.sh.), sepse bazë e sheriatit është lehtësimi, evitimi i mundimit dhe zbatimi i gjërave që janë në interes të njerëzve. Si bazë për këtë është fjala e Allahut (xh.sh.): ***"...e kush shtrëngohet (të hajë nga këto), duke mos pasur për qëllim shijen dhe duke mos tepruar, për të nuk është mëkat..."*** (El-Bekaretu: 173)

3. El-Bekaretu: 188.

4. Edukimi i fëmijëve në islam, Ulvani, Abdullah Nasih, fq.185-187.

REZYME⁵

Çdo pije dehëse, pavarësisht se me çfarë është prodhuar, konsiderohet e ndaluar. I njëjti rregull vlen edhe për hashashin. Ky do të ndëshkohet njëlloj si konsumuesi i pijeve dehëse. Në koleksionin e Buhariut dhe të Muslimit theksohet se i Dërguari i Allahut (s.a.v.s.), ka thënë: “Çdo pije dehëse është haram...”. Në një transmetim thuhet: “Çdo pije dehëse është verë dhe si e tillë është haram”. Ndërsa në një transmetim tjetër sqarohet: “Çdo pije dehëse është verë e çdo verë është e ndaluar”. Po ashtu në një transmetim qëndron: “Ajo që deh, qoftë e pakët apo e shumtë, është e ndaluar”⁶.

Ndalimi i verës vërtetohet edhe nga Kurani Fsinik, siç u vërtetua edhe prej sunetit të të Dërguarit (s.a.v.s.). Allahu i Lartësuar ka thënë: **“O ju që besuat, s’ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyra nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre, që të jeni të shpëtuar.”**⁷

PËRFUNDIM

Ky është një fenomen shumë i rrezikshëm dhe i dhimbshëm⁸, që e shohim të përhapur në çdo ambient ku nuk ka vlera të moralit dhe ku nuk ka respekt dhe zbatim edukata islame.

Këtë fenomen e shohim që është prezent në shumicën e rasteve tek fëmijët të cilët kanë qenë pa përkujdesje dhe nuk ka pasur kush t’i edukojë. Po kështu edhe tek fëmijët që kanë devijuar dhe janë degjeneruar, për shkak se prindërit e tyre kanë qenë neglizhentë në edukimin e tyre. Këta janë shoqëruar me të këqinjë dhe kriminelët dhe kanë përfutur çdo gjë të dëmshme dhe të pavlefshme.

PASOJAT DHE DËMET QË RRJEDHIN NGA PËRDORIMI I DROGËS DHE I PIJEVE DEHËSE:

A. PASOJAT SHËNDETËSORE DHE PSIKIKE:

Shkencëtarët e mjekësisë janë të një mendjeje se konsumimi i pijeve dehëse dhe drogave shkakton çmenduri, dobëson memorien, sjell sëmundje të nervave, lukthit dhe zorrëve, paralizon aftësinë e të menduarit, shkakton dhimbje në sistemin e tretjes, humbjen e oreksit, dobësimin e trupit, paqartësinë në të kuptuar, impotencën seksuale, ngurtësimin e rrjetit të arterieve dhe shumë sëmundje të tjera të rrezikshme. Mjafton të dimë se për shkak të dëmeve të këtij fenomeni, si-

5. Bazat e thirrjes, Zejdani, Abdul Kerim, fq. 354-355, përktheu mr. sci. Flamur Sofiu.

6. Ibid, fq. 340-342.

7. El-Maideh: 90.

8. Shiko: Edukimi i fëmijëve në islam, Ulvani, Abdullah Nasih, për - theu mr. sci. Flamur Sofiu, fq. 185-187.

Ky është një fenomen shumë i rrezikshëm dhe i dhimbshëm, që e shohim të përhapur në çdo ambient ku nuk ka vlera të moralit dhe ku nuk ka respekt dhe zbatim edukata islame.



pas statistikave kombëtare franceze, kanë vdekur më shumë se nga sëmundja e kancerit. Kështu, në vitin 1955, për shkak të përdorimit të alkoolit kanë vdekur 17000 francezë, ndërsa prej kancerit kanë vdekur rreth 12000.

B. PASOJAT EKONOMIKE:

Dihet qartë se konsumuesi i pijeve dehëse dhe drogave e harxhon pasurinë e tij shumë lehtë, duke mos llogaritur fare. Nuk mund të fshihet se në këtë mënyrë harxhimi shkatërrohet pasuria, shkatërrohen familje dhe sillet varfëria. Veç kësaj, konsumuesi kronik i këtyre pijeve shkakton humbje ekonomike dhe prapambetje në hapësirat e civilizimit. Sëmuret nga dobësimi i trupit dhe humbet mundësinë e komunikimit të qartë.

C. PASOJAT PSIKIKE, MORALE DHE SHOQËRORE:

Konsumuesi kronik i pijeve dehëse ose drogës pajiset me cilësitë me të këqija. Bëhet gënjeshtar frikacak, përbuzës i vlerave morale dhe bën vepra kriminale, si vjedhje, prostitucion dhe vrasje. Duke humbur vlerat morale, nuk ka forcë për të drejtuar vullnetin e tij dhe është i dobët për të zbatuar obligimet e veta.

Kohën e tij e kalon në vende të fshehta dhe grupe njerëzish të këqinj, shoqërohet me shokë kriminelë, për të cilët është e lejuar çdo gjë e keqe dhe për të nuk ka asgjë që duhet nderuar dhe respektuar!!..

Dihet se shtetet imperialiste i përdorin drogat si armë destabilizuese për të shkatërruar popujt, për të prishur moralin e umetit, për të humbur vlerat dhe të mirat e xhihadit dhe rezistencës. Egjipti ende ka problem me luftën ndaj drogës, rrënjët e së cilës i ka promovuar dhe vendosur Britania e Madhe imperialiste, qysh para një çerek shekulli. Në të njëjtën mënyrë Anglia ka luftuar Kinën, vetëm pse kishte ndaluar tregtinë e “afionit” dhe dhe kjo njihet me emrin “lufta e afionit”.



Shkrimtari, personazhi, lexuesi i vogël - marrëdhënie, raporte dhe aspekte të komunikimit artistik në poezinë për fëmijë të Adelina R. Mamaqit



-Pjesa e dytë-

Në opusin përrallor të shkrimtares gjejmë një botë me një mrekulli të madhe fantazie ashtu siç e ka në të vërtetë në palcën e saj përralla, si gjini e moçme krijuese, që nuk është gjë tjetër veçse produkt i mençurisë popullore. Gjejmë thesarin e urtësisë njerëzore, zgjuarsinë dhe triumfin e së mirës, rrugën drejt virtutit, doket, zakonet, identitetin, autoktoninë, etj., etj., të shpërfaqura si motive e si subjekte, herë të realizuara në përralla të mirëfillta e herë në përralla të mbështetura në modelet popullore. Rrafshi mbi të cilën vendosen personazhet dhe mjediset ku ata veprojnë flasin se "... krijimtarinë letrare të Adelina Mamaqit e karakterizon imagjinata e bujshme e autore për të bërë shpirtëzimin e gjallesave dhe sendeve, krejt me qëllim zhvillimi të imagjinatës së fëmijëve dhe gërshetimit të saj me realitetin ekzistues."¹

Marrëdhënia autore - personazh është e pranishme, jo vetëm te përralla, por edhe te poezia, gjini që autorja e lëvtron po me aq dashuri sa edhe përrallën. Kjo marrëdhënie ka konfiguracionin e saj dhe gjen pasqyrim në shumë vëllime me poezi të autore. Te libri "Vjershat e Majlindës" spikat, për shembull kjo dukuri ku: "Në qendër të çdo vjershe është vënë i njëjti personazh, vogëlushja Majlindë. Kjo i jep vëllimit tiparet e një poeme të ndarë në shumë pjesë, në mënyrë që lexuesi i vogël ta lexojë e ta përvetësojë

1. Ibishi, Ibrahim: "Magjia e shkrimit dhe përjetimi i leximit", Shtëpia Botuese "Rozafa", Prishtinë, 2008, faqe 82.

më mirë.

Rrëfimi është në vetën e parë. Çdo fëmijë mund ta vërë emrin e vet në vjershë dhe, në vend që të thotë **Jam Majlinda vogëlushë / a nuk ngjaj si lule fushe?**, të deklamojë: **Jam Albana...** Kështu lexuesja bëhet vetë heroinë e librit dhe kjo ia ndez më tepër fantazinë."²

Mendojmë se kjo mënyrë paraqitjeje, autore i është kthyer në traditë, por nga libri në libër ka sjellë larmi, pra, nuk ka rënë në përsëritje, ka shmangur klishetë e ngjashmërive. Përmendim gjatë ecurisë së krijimtarisë së autore si arritje personazhet: Goni trazovaçin, Xhoin-Toin, etj.

Marrëdhënia e autore me këta personazhe që vë në qendër të librave, shkon deri në adhurim. Përmes vargjeve autorja shqetësohet, loton, dëshpërohet, zhgënjehet, beson, ëndërron dhe gëzohet së bashku me personazhin; drithërohet dhe emocionohet si ai! Sepse personazhin e ka të shtrenjtë! E rrëfen bukur atë, po aq sa krijimin e saj në tërësi.

Personazhi i fal botën e tij autore, atë botë që falë frymëzimit e krijoi më parë autorja, se "Autorët janë porsi aktorët; ne hyjmë nën lëkurët e personazheve tona, për të jetuar jetët e tyre..."³

2. Bishqemi, Prof. As. Dr. Astrit: "Histori e Letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj", (Botim i tretë, i plotësuar dhe i përmirësuar), Shtëpia Botuese "Dy Lindje dhe dy Perëndime", Tiranë, 2008, faqe 202 ("Vjershat e Majlindës", vjersha, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1978).

3. Olen, Yame: "Të shkruash me gaz" (përktheu Granit Zela), gaz. "Dr -

Libri "Xhoi – Toi" paraqitet që në koncept i ndërtuar në mënyrë lodërtare. Vetë fjala *Toi*, në anglisht, do të thotë lodër. Kjo lojë, si koncept e bërthamë, nuk mbetet vetëm te ky libër, por shenjat i gjejmë edhe në botimet e fundit në këtë gjini të autores, si te "Sa shtëpi ka dielli?" e "Pinguini Ping Ping Pi", ndonëse këto libra i përkasin një grup moshe më të rritur. Pra, në këto poezi me këtë status, elementi lodërtar zë një hapësirë të konsiderueshme. Por autorja duke i qëndruar besnike kësaj natyrë-poezie edhe prozës (përrallës) herë pas here nuk harron t'i falë "pjesë", "sythe", "gjethe" e "pjesëza" poetike nga ky status, që shpeshherë shfaqet edhe me nuanca lirizmi. Na vijnë në mendje vepra, si: "Si e gjete folenë, moj dallëndyshe" e "Zogu Pup në shtëpinë prej xhami", etj.

Po kthehemi përsëri te libri "Xhoi – Toi". Nga ana tematike na paraqitet me një fytyrë të re, me larmi motivesh e rrezatim fantazie, me një fjalor interesant e komunikim dashurie, me një qiell ëndrrash e bëmash të natyrshme e të përligjura. Xhoi – Toi, si personazh që i bashkon të gjitha vjershat, është vizatuar me realizëm e besueshmëri në një realitet që enkas e krijon mosha e saj, por që më parë e ka "prekur" pena dhe talenti i shkrimtares Mamaqi. "Prekja" ka krijuar një realiteti të magjishëm, sepse i magjishëm është dhe personazhi i krijuar. Duke parë këtë magji dhe moshën e personazhit, është e pamundur të mos ndjesh mall për fëmijërinë tënde, është e pamundur të mos thuash me nostalgji: "Ah, sikur të bëhesha edhe një herë i vogël!"

Në fund të fundit, pse të mos kujtojmë edhe fëmijërinë e autores. Mos vallë fëmijëria aktuale e Xhoi-sit i ka sjellë gjyshes fëmijërinë e saj apo dukuri të largëta të kësaj fëmijërie?.. Gjithsesi mendoj që këto dy fëmijëri diku "takohen", jo rastësisht, por si përligjeje e si vazhdimësi dhe pjesë organike e qëndrueshmërisë së trungut familjar; ndaj me të drejtë thuhet se: "Vargjet e Adelinës të vetmen qetësi shpirtërore e kanë kthimin në fëmijëri të vetë poetes... Zëri i saj është një zë i veçantë i një krijueseje të zhytur emocionalisht në kohën e fëmijërisë, arti i së cilës në fakt është një shprehje emocionale e pamjeve të përditshme nga bota e fëmijëve."⁴

Realiteti artistik që përftojmë në këtë vepër është larg përsëritjes së librave të mëparshëm të kësaj krijueseje. Në këtë larmi autorja shpalos fuqishëm personalitetin e saj artistik. Për këto raporte, stu-

ta", 13.11.2005

4. Rama, Shukrije: "Shpirti plot rubinë" (studim, Vepra letrare e Adelina Mamaqit), Shtëpia Botuese "Rozafa", Prishtinë, 2007; (Kapitulli II – Poezia e fëmijërisë-), faqe 30.

diuesi Faik Shkodra shprehet: "Adelina Mamaqi i fali letërsisë për fëmijë vepra të vlefshme dhe shumë të dobishme. S'ka dyshim se ajo është krijuese që me kohë ka kuptuar rregullat dhe ligjësitë, të cilat do të duhej të respektoheshin në procesin e krijimtarisë letrare. Me fjalë të tjera, ajo shkruan për probleme, për çështje, për dukuri e gjësende, që objektivisht i përgjigjen botës dhe kërshërisë së fëmijës."⁵

Xhoi – Toi është një personazh që të lë mbresë. Xhoisi, është një personazh, që në këtë libër, ka universin e saj, ku shëtit së bashku me lojën e saj (realizim i produktit të imagjinatës), lojë që i fal gëzim, buzëqeshje e lumturi, kureshtje dhe e zgjon të bëjë pyetje (ose të thëna ndryshe "pse-të") të pafund...

Të tilla modele, ku në qendër të veprës është personazhi kryesor, më pak në poezi në krahasim me prozën, gjejmë si në letërsinë shqiptare për fëmijë, ashtu edhe në letërsinë botërore. Mjafton të kujtojmë serialin e Veshkaushit të O. Grillos, Çufon e G. Bushakës, Çapaçulin e D. Bubanit, Çaçon e S. Haskos, etj., etj.; për të vazhduar me Pipin çorapegjatën e A. Lindgren, Guliverin e Xh. Suift, Pinokun e K. Kolo-dit, Çipolinon e Xh. Rodarit, Lizën... e L. Kerollit, Nils Holgersonin e S. Lagerlëft, Piter Panin e Xh. Barrit, Bambin e F. Salten, Tom Sojerin e Hak Finin të M. Tue-init, "Dhomën e vogël të librave" të Elenër Farxhon, serinë e librave të bazuara në karaktere të veçanta të vizatuara për grupe të ndryshme moshash të Enid mary Blyton, "Ninën..." e Moony Witcher etj., etj.; për të vazhduar me personazhe të tillë proverbialë, si: Rosaku i shëmtuar, Kësulkuqja, Borëbardha, Hirushja, Gishtoja, Bukuroshja e fjetur, Maçoku me çizme, Xho Llolli, Lota etj., etj.; për të arritur deri te "Enciklopedia" Harry Potter i J. K. Rouling, një personazh popullor, që ka pushtuar mendjet dhe zemrat e fëmijëve të të gjithë kontinenteve.

Libra me personazhe të tillë i kapërcejnë kohërat, siç kanë ndodhur në të vërtetë. Bëmat, aventurat, historitë e fantazitë e tyre të rrëfyera mjeshtërisht, jetojnë tok me emrin e autorëve që u dhanë jetë personazheve, të cilët në rrjedhën e tyre letrare u bënë "pronë" e sa e sa brezave..., janë "pronë" e së tashmes, "pronë" e ardhmërisë.

Këta libra kanë edhe një veçori shumë të rëndësishme, se ato nuk lidhen vetëm me fëmijërinë e njerëzve, por edhe me fëmijërinë e fëmijëve. Duke i parë në konceptin e kohës dhe të hapësirës, këto

5. Shkodra, Dr. Sc. Faik: "Letërsia për fëmijë (nga fillimet deri sot)", Prishtinë, 2002, shkrimi: "Vargje që botën dhe shpirtin e fëmijës e shprehin në përmasa më të gjera", faqe 354.

problematika zgjojnë interesa lidhur me ardhmërinë e brezave, ruajnë të fshehtat e misteret e tyre që vetëm poetët e vërtetë dinë t'i zbulojnë e që përmbliken në një emërues të përbashkët: Këta libra lexohen me dëshirë, ëndje e kërshëri..., lexohen në çdo kohë, nuk i fshihen kohës dhe komunikojnë me kohën, duke rritur universin e vërtetë të vlerave.

Mendojmë se këtë fat ka edhe libri me poezi "Xhoi – Toi" i shkrimtares Adelina R. Mamaqi. Fati i personazhit Xhoi nuk harrohet lehtë. I ngjan një drite që të ndjek pas, i ngjan një këshill të urtë e të çmuar që të shfaqet kur ti e kërkon apo kur ke nevojë për të. Siç thotë autorja: "...shtëpinë e mbush plot dritë!" Dhe duke mos harruar "bisedën" me personazhin e vet, shkrimtarja i drejtohet përsëri: "Ti je jetë, / Je më shumë se ne vetë!" Ndaj, dhe lënda poetike të fal ndjesinë e një dashurie të pafund...

Në marrëdhënie me autoren është interesante të njihet edhe koha e personazhit. Si jeton ai, dhe si jeton koha e tij. Mendojmë se është më shumë se një marrëdhënie. Kredo e shkrimtares. Këtë e gjejmë në rrëfimin përrallor të procesit krijues të saj. Si model po marrin përsëri figurën e Xhoisit. Nëpërmjet kësaj marrëdhënieje çdo vjershë bëhet e afërt dhe e thjeshtë. Rrëfen për personazhin. Zgjedh fjalë, shprehje dhe struktura me ngjyresa sa më figurative, të cilat paraqesin brenda një konteksti të caktuar një mesazh dhe e përcjellin bukur atë. Kjo është arsyeja që në krijimtarinë poetike të shkrimtares zë vend një sistem figurativ që përbëhet nga metaforat, krahasimet, simbolet, enumeracioni etj.

Në një vjershë si kjo, sistemi figurativ është i "përhapur" në tërë strukturën e poezisë, por ruan edhe një shpirtëzim (metaforë) të dyfishtë (në formë inversi): një fëmijë-lule, një lule-fëmijë.

"Kjo lule ka çelur që të jetojë / Ashtu si ti. / Kjo lule pret të rritet, / Si pret dhe ti. // Kjo lule i gëzohet diellit, / Si i gëzohesh ti. / Kjo lule i përkëdhelet puhizës, / Si prindërve ti. // Kjo lule ka dëshirë të jetojë, / Se, jetë ka si ti. / Oh!.. Po e këputë, / Ti, / Nuk je më ti!"⁶

Adelina R. Mamaqi i takon atij grupi shkrimtarësh që "bisedojnë" brenda tekstit ekzistues. Për rrjedhojë, raporti shkrimtar – lexues, ka vlerën e jetëgjatësisë në hapësirat librore, ku "lëviz" pareshtur loja magjike plot fantazi, e cila: "... në fakt, përbën veprimtarinë më të dendur e më kënaqësiprurëse të fëmijës."⁷ dhe

6. Mamaqi, R. Adelina: "Xhoi – Toi", vjersha, Tiranë, 2005, Sh. B. "Extra", poezia "Kjo lule dhe ti", faqe 16.

7. Freud, Sigmund: "Poeti dhe fantazimi", faqe 162, (zgjidhi dhe përktheu Shpëtim Doda), rev. "Mehr Licht", nr. 28. 07. 2006.

"... fëmija arrin të vendosë fare mirë një vijë dalluese mes kësaj botësie (dhe është fjala për botësinë e lojërave të tij, - nënvizimi im) dhe realitetit, dhe argëtohet duke i ndërlikuar objektet dhe situatat e imagjinatës së tij me objektet e prekshme dhe të dukshme të realitetit."⁸

Pikërisht për këtë problem, pra për lojën, m'u kujtua një shkrim i poetit dhe studiuesit Hasan Hasani, teksa fliste për poetin e talentuar të letrave shqipe për fëmijë Agim Deva, në mes të tjerave thoshte: "Duke marrë të shumtën e herave lojën si objekt frymëzimi, ky krijues ka arritur që krijimtaria e tij poetike të bëhet një lektyrë e këndshme, e kërkuar, e domosdoshme për të vegjlit."⁹ Më lejoni të heq një paralele dhe ta "transferoj" thënien e studiuesit Hasani edhe për krijimtarinë e Adelina R. Mamaqit, e cila mbart të njëjtin tipar të qenësishëm brenda krijimtarisë së saj.

Bëj përpjekje për një përcaktim përfundimtar për vlerat e krijimtarisë së shkrimtares Adelina R. Mamaqi. Çuditërisht, shkrimtarët janë përsëri ata, që të parët më vijnë në ndihmë. Kujtoj një thënie të Mitrushit të papërsëritshëm: "**Autori i përrallave është shkrimtari më i madh dhe më i talentuar i gjithë kohërave...**".

Gjithashtu bëj përpjekje të di se çfarë reflekton në krijimtarinë e autores Adelina R. Mamaqi? Si përgjigje po i referohem shkrimtarit, editorit dhe gazetarit Ramiz Kelmendi: "Kjo poeteshë e madhe ka një shpirt të pasur me një imagjinatë të papërshtueshme, ku aq bukur i ka ilustruar veprat e saj, të cilat të fusin thellë në ngjarje dhe të bëjnë të ndihesh si të jesh në mesin e personazheve të saj. Kjo poete gjeti fjalët më të mira për t'i thurur në veprat e saj. Gjete fjalët më të bukura për fatosat (fëmijët, nënvizimi im) tanë, ku i dha jetë dhe gëzim botës feminare."¹⁰

"Shkruaj që të lexohem, ...", - do të thoshte Anne Rice.¹¹ Dhe kjo është një e vërtetë magjiplote për poeten Adelina R. Mamaqi dhe krijimtarinë e saj.

8. Po aty, faqe 163.

9. Hasani, Hasan: "Faqe libri" (shënime letrare), Sh. B. FAIK KONICA, Prishtinë, 2007; shkrimi: "Kah poezia intelektuale për fëmijë", faqe 238.

10. Kelmendi, Ramiz: Referat i mbajtur me rastin e 70-vjetorit të lindjes së shkrimtares Adelina Mamaqi dhe 50-vjetorit të krijimtarisë së saj, organizuar në Kosovë, dt. 26. 10. 2010; cituar gazetën "BOTA SOT", dt. 27. 10. 2009, shkrimi: "70 vjet jetë – 50 vjet krijimtari letrare për Adelina Mamaqin", autorja Xhevrije Sylejmani.

(Shkrimtari e publicisti Ramiz Kelmendi ka botuar në vitin 1969, dyzet vjet më parë në Kosovë, librin e më të parës poeteshë në letrat shqiptare, vëllimin poetik "Ëndrra vashërie" të Adelina Mamaqit).

11. Rice, Anne: "Si shkruaj? Pse shkruaj?" (përktheu: Granit Zela), gaz. "Drita", 13. 11. 2005.

-) Dedja, Pandora: "Kujtesë" (studime, kritike letrare, mbresa), Sh. B. Uegen, Tiranë, 2006; shkrimi: "Bregu i kaltër", faqe 300.



Shpërngulja me dhunë e popullsisë Çame dhe pasojat e kolonizimit grek

Prof. dr. Selman Sheme

Popullsia në gjeohapësirën e Çamërisë, deri në vitin 1945 përbënte një bashkësi territoriale krahinore me natyrë sedentare, me vendbanime të përhershme dhe të qëndrueshme, me jetë ndjesore kushtëzuar nga mënyra e sigurimit të burimeve ekonomike për të jetuar, me shtëpi dhe prona tokësore të patjetërsueshme. Degët kryesore të ekonomisë ishin bujqësia, blegtoaria, frutikultura, vreshtaria, jeta zejtare dhe veprimtaritë tregtare të shkëmbimit të mallrave me vendbanimet fqinje.

Megjithë zhvillimet e mëdha politike që kanë ndodhur në Epir (Çamëri), herë duke pushtuar krahinat përreth e herë duke u pushtuar nga popuj të tjerë (romakë, sllavë, turq, grekë etj), popullsia shqiptare e Çamërisë ka arritur të ruajë dhe të zhvillojë më tej tiparet etno-kulturore, traditat e lashta etnike, duke mbetur në të gjitha periudhat historike një popullsi kompakte me gjuhë, zakone dhe tradita kulturore të veçanta.

Sipas statistikave greke të vitit 1937, Çamëria kishte 279 fshatra me një popullsi prej 112.619 banorë, nga të cilët vetëm 20.200 ishin grekofonë, ndërsa 92.419 banorë ishin shqiptarë. Popullsia shqiptare, sipas be-

simit, përbëhej nga 59.419 shqiptarë të krishterë dhe 33.000 shqiptarë myslimanë.

Siç shihet, deri në prag të Luftës së Dytë Botërore Çamëria ishte një rajon me përbërje etnike homogjene, ku mbi 82% të popullsisë e përbënin shqiptarët (viti 1937).

Shpërnguljet e dhunshme dhe me pasoja shkatërruese për strukturën demografike të gjeohapësirës së Çamërisë kanë filluar para 100 vitesh, kur me vendimet e padrejta të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, pjesa më e madhe e sipërfaqes dhe shumica e qyteteve dhe fshatrave të Çamërisë mbetën jashtë kufijve të shtetit të sapoformuar shqiptar, duke rënë nën sundimin grek.

Ky proces u fut në një fazë të re gjatë luftës italo-greke, (1940-1941) dhe arriti pikën më kulmore me ngjarjet e vitit 1944-1945.

Më 27 qershor 1944, në rajonin e Paramithisë ndodhi masakra më çnjerëzore ndaj popullsisë shqiptare myslimane të Çamërisë. Forcat e Lidhjes Kombëtare Republikane greke (EDES), të gjeneralit Napolon Zervas,



hynë në qytet dhe vranë afro 600 shqiptarë myslimanë, gra, burra e fëmijë, shumë prej të cilëve të përdhunuar dhe torturuar para se të vriteshin.

Gjatë fushatës greke të spastrimit etnik të Çamërisë, nga 27 qershori 1944, deri në mars 1945, u vranë gjithsej 2771 civilë. Gjatë kësaj periudhe u plaçkitën dhe më pas u dogjën edhe 68 fshatra dhe 5800 shtëpi. Si pasojë e këtij gjenocidi, mbi 35.000 shqiptarë të fesë myslimane u shpërngulën nga vatrat e tyre dhe u vendosën në Shqipëri. Gjatë emigracionit, 2400 vetë kanë vdekur si rezultat i mungesës së ushqimit dhe nga sëmundjet e ndryshme. Dëshmi për këtë është varreza masive çame në fshatin Kllogjer të rrethit të Sarandës.

Disa nga rrjedhjat më të dukshme e të evidentuara të shpërnguljes me dhunë të popullsisë shqiptare myslimane nga gjeohapësira e Çamërisë dhe të vendosur në shtetin amë, janë:

Së pari, këto migrime sollën me vete rrishtet e ngush-timit etnik të trojeve shqiptare. Trojet e trungut etnik të rretheve të Filatit, Gumenicës, Paramithisë, Margellicit etj, të populluar me shumicë nga popullsitë shqiptare, janë zëvendësuar pjesërisht ose tërësisht nga kolonë grekë dhe vllahë. Për këtë qëllim, në gjysmën e dytë të shek XX dhe deri në ditët tona, politika për helenizimin e krahinës u fokusua në dy drejtime.

1. Në intensifikimin e procesit të helenizimit të shqiptarëve të krishterë, nëpërmjet shkollës, kishës dhe administratës

2. Kolonizimi i krahinës me emigrantë grekë dhe vllahë, të ardhur nga pjesë të ndryshme të Greqisë, kryesisht nga rajoni i Pindëve dhe Atika.

Në disa nga fshatrat e rajonit të Filatit u vendosën kolonë grekë dhe vllahë, të ardhur nga malësia e Murganës. Kështu, në Smartë vendosën PALABIT, SHËN NIKOLIT, e SARAKACANE (vllahë). Në Versele dhe Galbaq vendosën VORTOPIT dhe banorë nga fshatra të tjera të Murganës Qendrore. Në Spatar vendosën KSEHORIT dhe PALABIT, në Dolan vendosën VLLEHË dhe PIGALUDHIOT, në Sklavi u vendosën PALIOHORIT dhe VILIOTE. Fshatrat Lops, Shqefar, Sollopi etj., u rrënuan krejtësisht

dhe nuk u ripopulluan me imigrantë. Hapësira rurale e tyre u shndërrua në tokë bujqësore.

Megjithëse fshatrat e Çamërisë në përgjithësi u kolonizuan me emigrantë grekë dhe vllahë, popullsia e vendbanimeve ka njohur një rënie drastike. Kështu Spatari, në 1913 kishte 499 banorë, ndërsa në 2010 kishte vetëm 268 banorë. Picari në 1940 kishte 397 banorë, ndërsa në 2001, vetëm 149 banorë. Versela, në 1913 kishte 482 banorë, ndërsa në 2001, vetëm 280 banorë, Koska, në 1913 kishte 768 banorë, ndërsa në 1951 kishte 202 banorë. Galbaqi në 1913 kishte 517 banorë, ndërsa në 1951 vetëm 202 banorë.

Siç shihet, Rajoni i Çamërisë, pas shpërnguljes me dhunë të popullsisë shqiptare, është në një proces të shpopullimit masiv dhe, për pasojë, mjedisi natyror është degraduar dhe dezertifikuar.

Së dyti, këto shpërngulje të dhunshme kanë dëmtuar vitalitetin e kombit, i cili përcaktohet edhe nga hapësira territoriale, nga komunikimi i gjerë mes krahinave periferike dhe të skajshme me rajonet qendrore.

Në kushtet e fragmentizimit të periferive tona territoriale, të faktorizimit politik, kulturor dhe ekonomik, globalizimi dhe integrimi europian është një alternativë që do të krijonte kushte adekuate për tejkalimin e reminishencave nacionaliste dhe zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me çështjen kombëtare shqiptare.

Së treti, këto migrime të përdhunshme sollën çrregullime demografike, pasi u shoqëruan me vrasje dhe shfarosje të mbi 5000 personave dhe shpërnguljen e gjithë popullsisë myslimane shqiptare që përbënte edhe pjesën më vitale të krahinës.

Duke u mbështetur në regjistrimin grek të vitit 1951, i fundit në të cilin jepen të dhëna për përkatësinë fetare dhe gjuhën amtare, del se numri i popullsisë shqiptare etnike në Greqi ishte 22.736 banorë.

Sipas të dhënave të De Agostinit (kalendarit gjeografik të Novarës), të vitit 2006, rezultoi se numri i popullsisë shqiptare etnike në Greqi arrin në 165.000 banorë.

Në dhjetëvjeçarët e fundit, shtimi natyror i popullsisë në Epir ka qenë mjaft i ulët, me një mesatare vjetore prej 1400 banorësh. Ndërsa në vitin 2007, në krahasim me vitin 2001, ka një saldo negative të shtimit vjetor të popullsisë, me një vlerë prej minus 5300 banorë. Këta tregues janë pasojë e ritmeve të ulëta të shtimit të popullsisë dhe veçanërisht janë të lidhur me dukuritë e eksodit rural dhe të emigracionit të jashtëm. Gjatë kësaj periudhe, janë shpopulluar rreth 347 fshatra, të cilët janë krejtësisht të braktisur. Për rrjedhojë, dendësia mesatare e popullsisë është e ulët, rreth 38 banorë për km² (2007) ose 2.4 herë më e ulët se dendësia mesatare e Greqisë dhe rreth 3 herë më e ulët se dendësia e Shqipërisë. Në këto kushte, sipërfaqe të mëdha të tokës që dikur kanë qenë të kultivuara ose kullota për

blegtorinë, janë degraduar apo dezertifikuar.

Së katërti, me shpërnguljen e popullsisë çame në trojet e veta, u dëmtuan traditat kulturore kombëtare e krahinore. Shpërbërja e fshatrave dhe e qendrave urbane solli edhe humbjen e një pjese të thesareve të kulturës materiale me vlera kombëtare e krahinore.

Në peizazhin rural të Çamërisë ruhen disa dëshmi të palëvizshme të këtij rajoni, dikur të populluar, në formën e shtëpive të shkatërruara, xhamive, kullave dhe ndërtesave të vjetra, të cilat kanë mbetur të izoluar në kodra apo skuta të fshehura nën tokë nga erozioni dhe shkatërrimi në rrethinat e vendbanimeve të reja. Keto ndërtesa të vjetra përbëjnë një nga zonat më të rëndësishme gjeografike të monumenteve historike të periudhës veneciane dhe osmane në Europën Juglindore. Përveç teatrit të Dodonës dhe Nikopolit, qyteteve të lashta të Pasaronit, Kastricës, Tekmonit, Ilinoit, Ozdinës, etj., ka mjaft fortifikime ilire, të cilat më vonë u bënë themelet e kështjellave të mëdha veneciane. Ekzistojnë edhe një numër i konsiderueshëm monumentesh islame, si xhamia e bukur në Liqenin e Janinës, xhamia e Margellicit, e Koskës, xhamia e Çaparenjve në Luarat, ura e mrekullueshme e Artës etj. Kanë mundur t'u mbijetojnë ngjarjeve të dhunshme dhe tragjike të rajonit edhe mijëra shtëpi të thjeshta, shumica të pabanuara. Mjaft shtëpi janë pushtuar nga pronarë të paligjshëm grekë ose emigrantë grekë të ardhur nga krahinat e tjera të vendit (Greqisë). Afër kufirit me Shqipërinë ka një numër të konsiderueshëm të shtëpive të vjetra shqiptare të tipit kullë, me vlera të mëdha arkitektonike që kanë mbijetuar mes pyjeve dhe zonave me shkurre. Monumentet më të rëndësishme urbane janë Paramithia, Margellici dhe disa qendra më të vogla, si Parga, Arpica (Perdika), Vola (Sivota) etj.

QYTETI I PARGËS

Pjesë e strategjisë së helenizimit të Çamërisë, në aspektin urban dhe arkitektonik, ka qenë lejimi i një procesi të ngadalshëm dhe tepër të fshehur të erozionit të historisë dhe të trashëgimisë etno-kulturore çame. Kohët e fundit, ky proces shkatërrimi, nga i cili Europa po humbet një pjesë mjaft të rëndësishme të së kaluarës së saj osmane, ka marrë përmasë alarmante.

AMFITEATRI I DODONËS

Së pesti, pas shpërnguljes së Çamërisë nga trangu etnik dhe pushtimi i saj nga Greqia, proceset natyrore të zhvillimit ekonomik u nderprenë. Ndryshimi i strukturës demografike të popullsisë, shpërnguljet në masë etj., ndikuan negativisht në zhvillimin ekonomik të krahinës, veçanërisht në gjysmën e dytë të shek. XX. Në bazë të ligjit, absurd të luftës, mbahen në "sekuestro konservative" dhe toka u është dhënë në përdorim kolonëve



grekë, të pamotivuar për zhvillimin e ekonomisë. Sot Epiri është rajoni më i prapambetur dhe më i izoluar në Greqi, me lidhje të pakta me rajonet e tjerë. Rajoni qendror i Athinës dhe rajoni verior i Selanikut, që përbëjnë dy polet më të zhvilluara ekonomike të Greqisë dhe qendrat gravituese të saj, i kanë kthyer shpinën Epirit.

Në këto rrethana, një nga rrugët e zhvillimit të rajonit, është riatdhesimi i popullsisë çame, prej 300.000 banorësh, që jetojnë në shtetin amë, në trojet e veta në Çamëri, si dhe kthimi i pronave të tyre. Ky proces do të përmirësonte në mënyrë të ndjeshme, situatën demografike dhe ekonomike të kësaj krahine. Shqiptarët e riatdhesuar do të ishin shumë të motivuar për zhvillimin dhe prosperitetin e krahinës dhe do të kishin vullnetin për t'i arritur këto qëllime. Ata do të integroheshin shumë shpejt në proceset e ndarjes shoqërore-gjeografike të punës dhe do të kontribuonin edhe në rregullimin e ekuilibrave të zhvillimit hapësinor, lokacional, në raportet qendër - periferi.

Sfidat e zhvillimit rajonal dhe ndërrajonal, funksionimi i ekonomisë së tregut dhe integrimi evropian, e bëjnë të domosdoshëm bashkëpunimin ndërkufitar, veçanërisht në vendet e Ballkanit Perëndimor. Forma më e njohur dhe më e mirë e institucionalizimit të bashkëpunimit ndërkufitar, është padyshim eurorajoni.

Në kuadrin e këtij procesi, janë institucionalizuar dhe konkretizuar eurorajonet Moravë-Pcinje-Strumë (Maqedoni-Serbi-Bullgari), bashkëpunimi eurorajonal Danub-Drava-Sava (Hungari-Kroaci-Bosnje), eurorajoni i Adriatikut (Shqipëri-Mal i Zi- Kroaci-Itali) etj.

Bashkëpunimi ndërkufitar në një mjedis me kufij të hapur midis rajonit të Çamërisë (Epirit), Rajonit Jugor (Vlorë-Sarandë-Gjirokastrë) dhe polit Industrial të Rajonit të Pulias (Itali), apo më gjerë, eurorajonit të Jonit, do të mbështeste fuqimisht zhvillimin ndërkufitar në këto hapësira periferike, kryesisht rurale, të Shqipërisë dhe Greqisë dhe do t'i integronte ato në proceset e zhvillimit ndërrajonale, duke ridimensionuar ndarjen shoqërore-gjeografike të punës në hapësirat e Ballkanit.

Tefsiri i Sure-i Asrit

Kjo sure asht ma e shkurta e sureve të Kurani Qerimit, përmban tre Ajete. Mbas fjalës të Ibni Abasit (qofshin të ndjerë) fjala asër asht koha qi ndër ate rjedhin lëvizjet e punimet e njerzis, arabisht i thuhet edhe Dehër. Kuptimet e fjalës Asër janë kto: (1) Koha e njoftime qi falet iqindija (Zëmra). Arabët e kishin zakon si e çkrihin punën dhe si ngëheshin në kohë të Zëmrës mblidheshin (si katunarët e Shqipnis) edhe fjalosshin e bisedofshin, punët e tyne vetjake. Porsi asht e ndiçme se disa herë qëllonte e bësheshin fjalë të pa pëlqyme e ngjarje të mëzirçme. Pra këtë kohë e qukshin si një kohë prapësire. Nga ky shkak Zoti betohet për mbi nderin e kësaj kohë që, o njeri ta març vesh se vet koha, as shahet as qertohtet, dmth kjo kohë a kjo ditë asht e lumtur dhe bekime edhe kjo kohë a kjo ditë asht e prapë dhe e mallkime të mos thush Goja nuk duhet me u stërvit me e fol kësi soj se në kohnat si punohet pun'e mirë ashtu punohet edhe pun'e keqe. Ahere s'duhet të shahen kohnat por duhen me u sha e me u qertu punët e punëntarve. Se si u tha sipër kohnat janë enë (Zarf) për punët të Zotit, ndër të cilat krijon 'ushqen' disa i nderon 'disa i poshtëron e disa i ngren e disa i rëzon, po nd'ato kohë. Prandaj s'asht e drejtë me u sha koha. Zoti me madhnin e vet n'ajetin e parë të ksajë Suresë urdhnon: (Vel.....) për kohën të pa çume a për kohën e Zëmrës betohem (qi ju po e qertoni).

Në Ajetin e dytë urdhnon: (inne....) pa dyshim gjithë njerëzit me të vërtet janë ndë një damë të math dmth e kan hupë veten e tyne përjetë. Sicilit q'i thuhet njeri edhe asht me ment në krye nga punët e vet gjindet ndë një dam të math e të përhershim. Përjashtonen vetëm ata njerës qi përjashton i madhi Zot n'ajetin qi vjen ma poshtë. Punët e njeriut, po ato vetë kanë ndjelle ligsit e prapësit e jo koha e vendi.

Në gjuhët arabishte fjala gjithë edhe tanë miret prej fjalës (qyl) a (el). Mënyr e përdorimit të këtyne çquhet prej ylemas. N'Ajetin e tretë urdhnon Zoti (illa.....) vetëm ata njerës s'kan ra në dam të përjetçim të cillët kan besu Zotin edhe pejgamberin. D.m.th. nga dami i përjetçim për jashtohen vetëm ata qi i kan zan besë Zotit e pejgamberit edhe e dinë pa dyshim si për ata ashtu edhe për gjithë botën vetëm Zoti i vërtetë kënaqet, zemronet, për të mir për të keqe çpërblimi asht në dorë të tij. Kësi sojë njerës qi besojnë kështu veten e tyne e kan në dorë dhe punojnë ashtu si besojnë.

Besimi i tyne asht një iman i qindrushim jo i lëvisçim.

Për-sëri Zoti urdhënon: (ve ami.....) Mbesojnë edhe ashtu si besojnë me një besim të fortë e të patundcim punojnë punët e mira. D.m.th. ata qi besojnë Zotin e Pejgamberin me at besimin e saktë punojnë punë të

pëlqyshme qe ju ka tregum Zoti në Kurani qerimi e u ka dëftum i madhi pejgamber. Punojnë asi punësh qi i bijen dobi si vetes të ti ashtu edhe fëmijës të vet dhe gjith kombit edhe gjith botës mbarë. Nuk punojnë asi punësh qi t'i vijë damë kujt a ti vijë damë fesë a se Atdheut por si e si përpiqen me e ndalum damin e ligsitë prej vëllaznevet tej e tej.

Urdhënon Zoti ma poshtë: (v te.....ve....te) Ata porositin njeri tjetrin me vërtetsi edhe me durim, d.m.th. përjashtohen ngaj dami i math dhe i përherçim ata qi besojnë e punojnë punë të mira si për veten e vet ashtu edhe për gjith botën edhe kurdoherë qi piqen me vëllaznët e tyne njeri tjetrin e porositin për mos me u da nga e vërteta, nga drejtësija dhe porosisin për me duru e me kry gjith punët e hajrit.

Zoti me madhsin e vet ketu përse e veçanëroj porosinë nga punët e mira vetëm të vërtetën edhe durimin?

Si kush qi i bazon punët e veta mbi vërtetsinë dhe mbi durimin ajy i ka shti në dorë gjith punët e hajrit edhe ashtu i largon nga gjithë punët e kqija. Kjo gja asht po ajo e vërtetë e patundshme qi e kan pat gjith fet e gjithë Sheriatnat. Pra nga ky shkak Zoti i vërtetë për me e shpëtum njerin nga nji dam i tillë vuui shart besimin e vërtetë, punimin e pëlqyshim edhe porsinat me vërtetsi e me durim qi me anën e ktyne katër sendeve bota do ta dinë se c'asht e vërteta dhe asi soj të qindrojnë në vërtesie.

Bota nga hajalatet (nga andrat) duhen zgjum se andrat s'i pranon akli as naksi

d.m.th. kush i thot vetes njeri duhet me punu si i ka urdhnun Zoti r Pejgaber, jo me të sajume.

PËRFUNDIMI

Kan qenë dy shokë nga sahatet qi kurdoherë qi piqshin njeni me tjetrin deri mos i a këndonin njeni tjetrit kët Sure nuk ndahshin.

Imam Shafuja thotë: Prej Kurani-qerimit të mos kish zbrit tjetër Sure vetëm kjo mjaftonte si për dynja ashtu edhe për Ahiret.

Pra ta shkurtojme me kto fjalë! Oti! Qi i thu

vetes njeri! A e beson Zotin e Pejgamberin? A e ke besum kuranin e Zotit? Ahere puno si ke besum puno si të urdhnon Kurani ! bëju mirë gjith botës, puno me e shpëtu fenë edhe atdhen. Me cillin do qit ë piqesh mos hiq dorë nga tevasija (Porosija) për të drejtë e për durim d.m.th. mos ki frikë prej kujt, pos si veten ashtu edhe gjith botën e porosit qit ë mos ndahenë nga e vërteta e nga durimi se popogandat qi banen jashtë këtyne ato e renojnë krejt fenë edhe atdhen. U-murr

vesh qi mysliman i vërtetë quhet kush i ka kto katër sofate: (1) Iman II Ameli-Salih III Tevasi bilhak IV Tevasi bissabër, e kush s'i ka s'asht.

Zoti na çiltë sytë e mos baft kush (tevasi) propaganda jashtë të vërtetesë për me e renu fenë e Atdhenë.

AMIN!

A. J.

*Marrë nga revista Zani i Naltë
Nr. 2, Nantuer, Vit' i I.*



Sinqeriteti

Dijetarët u kanë dhënë rëndësi të madhe veprave që burojnë direkt nga zemra dhe kanë shkruar libra të shumtë mbi këtë temë, duke i nxitur njerëzit në mënyrë që ata të përmirësohen dhe të përkryehen. Veprat e zemrës janë shumë të rëndësishme, sepse shpëtimi i njeriut varet pikërisht nga fakti se sa të përsosura janë ato. Nga këto vepra, vendin e parë e zë sinqeriteti, i pari, më i rëndësishmi dhe baza e të gjitha veprave. Sinqeriteti është thelbi i fesë. Në Kuranin famëlartë, Allahu i madhëruar urdhëron e thotë: **“Ata nuk janë urdhëruar për asgjë tjetër përveçse të adhurojnë Allahun me adhurim të sinqertë, të largohen nga çdo besim i kotë, të falin namazin, të japin zekatin. Kjo është feja e drejtë”**. (Bejjine,5). Në një ajet tjetër, thuhet: **“Vetëm Allahun e adhuroj dhe adhurimin tim ndaj Tij e kryej me sinqeritet”** (Zumer,14).

Të jesh i sinqertë me Allahun, do të thotë që çdo vepër ta kryesh vetëm për hir të Tij. Sinqeriteti përfshin të gjitha fushat e jetës, jo vetëm ato fetare. Sinqeriteti në jetën e myslimanit është një mjet i domosdoshëm për të fituar kënaqësinë e Allahut të Madhëruar. Në një hadith Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“Sinqeriteti të çon në mirësi, kurse mirësia të çon në xhenet. Vërtet, njeriu i cili është vazhdimisht i sinqertë (në besim dhe në të folur), konsiderohet nga Allahu (xh.sh.), besimtar i vërtetë. Gënjeshtra të çon në shthurje, kurse shthurja të çon në xhehenem. Njeriu që*

gënjën vazhdimisht, konsiderohet tek Allahu, si gënjeshhtar i madh.” (Mutefekun alejhi).

Besimtari duhet të jetë i sinqertë në kryerjen e obligimeve fetare, ashtu siç na obligon Allahu Fuqiptotë. Besimtari duhet të jetë i bindur se çdo vepër ku zë vend sinqeriteti, pranohet tek Allahu i Lartësuar dhe për të do të ketë shpërblim.

Besimtari i frikësohet Allahut të Madhëruar për çdo vepër që bën gjatë jetës, prandaj zemra e tij përfshihet nga sinqeriteti, kur vepra të jetë kryer sipas parimeve të Islamit. Allahu i Lartësuar thotë: **“O besimtarë, frikësohuni Allahut dhe jini me ata që janë të sinqertë.”** (Teube:119). Që veprat tona të jenë të pranuar tek Allahu i Lartësuar, duhet që sinqeriteti ynë të jetë në përputhje me sunetin e Muhamedit (s.a.v.s.).

Në librin e dijetarit Islam Ibn Tejmije “Të qenët rob i Allahut”, përmendet Fudejl ibn Ijad, i cili në lidhje me ajetin: **“...Për t’ju provuar se cili prej jush është më vepërmirë...”** (Mulk,2), ka thënë: *“Ka kuptimin më i sinqerti dhe më i sakti.”*

Neve na mbetet që të punojmë me fjalën e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij, Muhamedit (s.a.v.s.), duke u ruajtur kështu nga dyfytërsia dhe gjërat e tjera të dyshimta, të cilat mund ta zbehin sinqeritetin në zemrat tona.

Dijetari i shquar Islam Ibn Hazmi thotë: “Roli i

sinqeritetit tek veprat është i ngjashëm me rolin e shpirtit tek trupi". Si do ishte gjendja e trupit pa shpirt? Kështu pra, veprat pa sinqeritet janë të vdekura. Sinqeriteti është porta e vetme për pranimin e veprave ose për refuzimin e tyre. Është ajo veti që e çon personin në fitore ose humbje.

Sinqeriteti është të pastruarit e shpirtit nga çdo gjë e huaj që e ndot atë. Të jesh i sinqertë në fe, do të thotë të veprosh vetëm për të fituar dashurinë dhe kënaqësinë e Allahut. Të jesh i sinqertë me Allahun, do të thotë të braktisësh dyfytërsinë, hipokrizinë, në të gjitha çështjet që të preokupojnë. Sinqeriteti është njësimi i Allahut me bindje të plotë në çdo fjalë dhe vepër, vetëm për hir të Tij.

Imam Gazaliu transmeton në librin e tij "Ihja Ulumuddin" se një rob i devotshëm kishte dëgjuar që një grup njerëzish adhuronin një pemë. Prandaj u nis ta priste. Iblisi i tha: "Nëse ti e pret, ata do të adhurojnë një pemë tjetër. Ktheju ibadetit tënd". Por robi i devotshëm ia ktheu se, patjetër duhej ta priste. U grindën dhe u kacafytën me Iblisin. Fitoi robi i devotshëm. Djalli i tha: "Ti je i verbër, ktheju ibadetit tënd dhe do të kesh çdo natë nga 2 dinar nën jastëk". Njeriu mendoi e tha me vete: "Po". Kur gdhiu të nesërmen, i gjeti 2 dinarët. Edhe natën tjetër po ashtu, ndërsa natën e tretë, jo. Në mëngjes mori sëpatën e shkoi të priste pemën, por Iblisi ia preu rrugën dhe e mundi. Njeriu pyeti se ç' kishte ndodhur. "Unë të munda i pari e tani më munde ti. Hidhërimi yt në fillim ishte për Allahun, ndërsa tash për dinarët", - ia ktheu Iblisi.

Hasan el Basriu ka thënë: *"Të gjithë njerëzit janë të humbur, me përjashtim të të diturve. Të gjithë të diturit janë të humbur, me përjashtim të vepruesve. Të gjithë vepruesit janë të humbur, me përjashtim të të sinqertëve"*.

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *"Veprat shpërblehen sipas qëllimit e secilit i takon ajo çfarë ka pasur për qëllim"*. **(Buhariu, Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Nesaiu.)**

Shumica e dijetarëve të hershëm i fillonin librat e tyre me këtë hadith madhështor. Ndër ta

përmendim Imam Buhariun, që me këtë hadith ka filluar "Sahihun" e tij, En Neveviu "Dyzet hadithet" e "Rijadus Salihin", Abdulgani el Makdesi "Umdetul Ahkam", El Begauiju "Mesabihu es Sunneh" dhe "Sherhu es Sunneh", Es Sujuti "El Xhamus Sagir" etj.

Një vepër, që të jetë e pranuar tek Allahu i Madhëruar, duhet të plotësojë dy kushte:

1. Sinqeriteti për hir të Allahut të Madhëruar.
2. Të jetë në përputhje me udhëzimet e të Dëguarit të Allahut (s.a.v.s.).

SHENJAT E SINQERITETIT

1. Dëshira për të punuar për hir të fesë.
2. Të jenë veprat e fshehura më të shumta se veprat e ditura.
3. Durimi dhe mosankimi.
4. Dëshira për vepra të fshehta.
5. Bërja në mënyrë të përsosur e veprës në fshehtësi.
6. Shtimi i veprave në fshetësi.

Ebu Hamza Themali thotë: "Ali bin Husejn dilte çdo natë pas namazit të jacisë, kur njerëzit flinin, mbante mbi shpinë ushqime dhe i shpërndante nëpër shtëpitë e të varfërve". Ali bin Husejn ka thënë: "Vërtet, sadakaja e fshehtë shuan hidhërimin e Allahut të Madhëruar".

Omer bin Thabit thotë: "Kur vdiq Ali bin Husejri, e kemi pastruar dhe kemi vërejtur në shpinën e tij gjurmë të zeza. Kemi pyetur se ç'ishin? Na treguan se qenë shenja nga barra që mbante çdo natë duke shpërndarë sadaka për të varfërit".

Në komentin e sures Tevbe, Aliu (r.a.), thotë: "Një beduin hyri në xhami dhe fali një namaz me shpejtësi. Aliu (r.a.), u ngrit me një shkop e i tha ta përsëriste namazin. Ai e përsëriti. Aliu e pyeti nëse ishte më mirë tani apo më parë. Beduini ia ktheu se më parë kishte qenë më mire, pasi e kishte falur për Zotin, ndërsa tani qe frikësuar prej shkopit". Sinqeriteti është sekret mes Zotit dhe robit.

Gjeologjia dhe meteorologjia në historinë e shkencës islame

Ma. Artur Tagani

Në historinë e shkencës islame, gjeologjia nuk është zhvilluar si një shkencë më vete, por si pjesë e shkencës së meteorologjisë (el-Asasu'l-ulvije), gjeografisë dhe kozmologjisë. Punimet e para lidhur me këtë shkencë kanë nisur nga vitet e para të shekullit IX, me përgjigjet ndaj pyetjeve të ndryshme rreth përbërjes së maleve, shkëmbinjve, lumenjve, deteve etj., të shkencëtarit poliedrik **el-Xhahidh** (vd. 869).

Pas **el-Xhahidhit**, në shekullin X, bien në sy **el-Biruni** dhe **Mes'udi**, si dy shkencëtarë të mëdhenj të kësaj fushe. Në librin e tij, "**Muruxhuh-dheheb**", **Mes'udi** shpjegon arsyen e tërmeteve, tregon për lumenjtë nëntokësorë, deltat dhe vullkanet. Sërish edhe në këtë fushë, **Ibn Sina** dhe **Ihvanu's-safa** janë dy burime të rëndësishme të kësaj shkence. Ata japin mjaft të dhëna interesante rreth përbërjes së sipërfaqes së tokës, rreth maleve, deteve dhe fosileve.

Gjithashtu edhe në shekujt e mëvonshëm, shkencëtarët myslimanë kanë kontribuar mjaft në këtë fushë me vepra të ndryshme shumë të rëndësishme, si "**Kitabu'l-zelazil**", i **Ibn Asakir ed-Dimeshki** (vd. 1179), vepra enciklopedike "**Axhaibu'l-mahlukat ve axhaibu'l-buldan**" e **Zekerijja el-Kazvinit** (vd. 1283) dhe një mori shkencëtarësh dhe veprash në këtë fushë.

Lidhur me çështjet e kësaj fushe që janë trajtuar nga shkencëtarët myslimanë, mund të zgjatemi

shumë, por ne po përzgjedhim disa prej tyre.

1. PËRBËRJA E MALEVE DHE DISA NDRYSHIME GJEOLGJIKE SIPAS ZEKERIJJA EL-KAZVINIT

"Malet në fillim ishin të përziera ujë e dhe. Me ndikimin e temperaturës së diellit, sikurse lluca bëhet briket, po ashtu, me kalimin e kohës dhe me fryrjen e erës, janë formuar grumbuj të fortë dheu. Kështu u bënë shkëmbinjtë. Me rrotullimin e yjeve çdo 36000 vjet, toka pëson ndryshime të mëdha. Veriu bëhet jug, tokat e thara kthehen në dete, detet thahen, fushat bëhen male e malet fusha.

Malet janë si shtylla, që mbajnë ekuilibrin e tokës. Ato janë një thesar i vërtetë mineralësh..." (Z. el-Kazvini, *Axhaibu'l-mahlukat ve axhaibu'l-buldan*, Bejrut 1979, fq. 298)





2. VULLKANET, SIPAS ZEKERIJJA EL-KAZVINIT

“Arsyeja përse disa male natën nxjerrin flakë dhe ditën tym, është se boshatiset squfuri. Për shembull, mali Etna në Sicili...” (*Ibid*, fq. 313)

3. TËRMETET, SIPAS ZEKERIJJA EL-KAZVINIT

“Kur në gropat e nëndheshme mblidhen mjegullsitë dhe avujt, bëhen ujë për shkak të temperaturës së ulët dhe, për arsye të mungesës së temperaturës së lartë, kjo masë nuk shpërbëhet. Nëse sipërfaqja e tokës ngrohet dhe ato nuk gjejnë vend të dalin, sikurse dridhet trupi i njeriut kur ka temperaturë, edhe ato e dridhin sipërfaqen e tokës.

Në trupin e njeriut ekziston një sistem i natyreshëm ngrohjeje, i cili djeg, shpërbën ose shkrin lëndët e dëmshme, por në tokë nuk ka një sistem të tillë.

Nganjëherë, këta avuj të akumuluar dalin në mënyrë të fuqishme dhe copëtojnë tokën, aq sa këto situata mund të bëhen shkak të shkatërrohen male e qytete...” (*Ibid*, fq. 317)

4. SHKAKU SE PËRSE QIELLI KA NGJYRË BLU, SIPAS KINDIT

Shumë kohë para **Kindit**, grekët, e në veçanti **Aristoteli**, kanë bërë shpjegime lidhur me arsyen e ngjyrës së qiellit. Mirëpo, është **Kindi** (shek. IX), ai që shpjegon saktë shkakun e ngjyrës së qiellit. Të tjerët para tij, kishin pranuar se qielli në mënyrë natyrale ka ngjyrë blu. Kindi korrigjon këtë mendim të gabuar, në veprën e tij të vogël me titull “**Arsyeja se përse qielli ka ngjyrë blu**”, duke thënë se kjo shpjegohet me përthyerjen e rrezeve. Ai thotë se shkakun e përse uji i deteve dhe qielli duken në ngjyrë blu, është për arsye të manifestimit të përplasjes së rrezes së diellit me molekulat

dhe pikëzat e vogla të ujit dhe dominimi i ngjyrës së kaltër. Ky është edhe shpjegimi shkencor i sotëm. (*Kindi, Risale fi'l-il-leti'levni'lazeverdi...*)

5. RETË DHE SHIU SIPAS FARABIUT

Filozofi dhe shkencëtari i madh mysliman, **Farabiu**, që në shekullin X ka shkruar: “Rrezja e diellit bie në disa zona të lagështa. Nga ato zona ngrihen avuj. Prej tyre përbëhen retë dhe nga retë bie shiu...” (*Farabiu, Faziletu'l-ulum*, pj. 17)

6. SHPJEGIMI SHKENCOR I YLBERIT DHE KARAFI

Ylberi, si një ngjarje atmosferike, u ka tërhequr vëmendjen njerëzve dhe, që në kohët e hershme, i ka bërë të mendojnë rreth tij. Shumë mendimtarë, sikurse **Aristoteli**, **Ibn Sina** dhe **Farabi**, janë përpjekur ta shpjegojnë përbërjen e këtij fenomeni dhe shkakun e radhitjes së ngjyrave të tij, por të gjithë janë treguar të pasaktë. Për Ibn Sinain, thuhet se ka thënë: “Disa gjëra i kuptoj dhe shumë gjëra nuk kuptoj rreth përbërjes së ylberit. Ngjyrat nuk i kuptoj, shkakun e tyre nuk e kuptoj. Nuk më mjaftojnë as ato çfarë thotë **Aristoteli** rreth kësaj çështjeje. Janë të gabuara dhe gënjeshtra.”

I pari që bën një shpjegim krejtësisht shkencor rreth përbërjes së ylberit dhe arsyes së ngjyrave të tij është optisti dhe teologu i shquar islam Karafi (vd. 1285). Shpjegimet e tij përputhen tërësisht me shpjegimet e sotme shkencore. Sikur të bëjmë një përmbledhje të asaj çfarë thotë ai, do të ishte: Ylberi shfaqet në kohë me shi dhe ngjyrat i duken sipas ndryshimit të temperaturës, nga lart poshtë, në varësi të gradëve të ndryshme të avujve, si rezultat i përthyerjes së rrezeve të diellit në atmosferë. Në pjesët e larta gjendet avull normal. Në rreze të diellit, ky avull shfaqet përherë i kuq. Ndërsa në pjesën më të lartë ka një dendësi avulli, për arsye të temperaturës së ulët. Kjo dendësi avulli duket në ngjyrë blu të mbyllët. Përzierja e këtyre dy ngjyrave, sjell ngjyrën e verdhë. Në pjesët më afër tokës, për arsye të temperaturës së lartë, avulli gjendet më rrallë. Kjo gjë bën që të formohen ngjyra më të hapura. Atëherë, ylberi përbëhet prej këtyre katër ngjyrave: e kuqja, e verdha, e kaltërta dhe ngjyra e hapur. Arsyja përse ylberi është me hark të rrumbullakët, është sepse merr formën e shfaqjes së diskut të diellit. (*A. Sayili, al-Karafi and His Explanation of the Rainbow, ISIS*, v. 32, 1940, fq. 16 – 26)

Ibn Hazmi dhe vepra e tij “Gjerdani i pëllumbeshës”

Në Kordoba të Spanjës myslimane (Andaluzia) ka jetuar në shekullin X dhe XI një prej personaliteteve më të rëndësishme të botës Islame, një figurë komplekse dhe me aspekte të shumëfish-ta, të cilat janë ekspozuar në veprat që ai shkroi. Ai është Ibn Hazmi, poet, mendimtar, teolog, historian, kritik i religjioneve dhe shkollave filozofike e teologjike, moralist dhe jurist.

Ebu Muhamed Ali ibn Hazmi lindi në vitin 383/994, në një familje me pozitë të lartë shoqërore. Meqë i ati qe vezir i halifit Mansur, Ibn Hazmi e kishte të lehtë të arsimohej nga mësuesit më të famshëm të Kordobës, në të gjitha lëndët: hadith, histori, filozofi, fikh, mjekësi, lehtërsi.

Për fat të keq, fiset arabe të Afrikës veriore, berberët, më 404/1013 shkatërruan një pjesë të tërë të Kordobës. Në qershor të po atij viti, Ibn Hazmi humbi të atin. Me ashpërsimin e kryengritjeve kundër sundimit të Emevitëve, Ibn Hazmi u largua nga Kordoba, ndërsa pasuritë e tij u konfiskuan. Kështu që në moshën njëzetvjeçare, ai u angazhua plotësisht në politikë, duke u radhitur ndër ithtarët më luajalë të dinastisë emevite. Iku në Almeria, ku u vu në krye të lëvizjes që përkrahte princin Abdurrahmanin IV, pretenduesin e ligjshëm të kalifatit. Por princi u vra në betejën që i dha dërmën edhe ushtrisë së tij. Në këtë betejë Ibn Hazmi ra rob lufte, por pas pak kohe, fitoi lirinë.

Ibn Hazmi u strehua në Shatib (Xativa), aspak i demoralizuar. Aty ai gjeti siguri dhe

qetësi që të shkruante veprën e vet të shkëlqyeshme erotike, “Gjerdani i pëllumbeshës” (Tavku’l-hamame), ditar i përvojës së tij në jetë, në të cilën, ndër të tjera, zbulon një plagë të ruajtur deri atëherë në fshehtësi, dashurinë e vet rinore.

Edhe më tej i mbetet besnik çështjes së Emevitëve, dinastisë së vetme legjitime. Ai qe mbështetësi më i fuqishëm i princit Abdurrahmanit V, i cili hipi në fron në vitin 413/1023. Ibn Hazmi bëhet veziri i tij, por për fat të keq, vetëm për një kohë të shkurtër. Dy muaj më vonë, në shkurt të po atij viti, princi vritet dhe Ibn Hazmi dëbohet nga Kordoba. Këtë herë nuk ka më asnjë shpresë për rikthimin e Emevitëve në pushtet, kështu që heq dorë nga veprimtaria politike dhe i përkushtohet shkencës, deri më 454/1063, kur vdiq.

Me librin e titulluar “Gjerdani i pëllumbeshës”, Ibn Hazmi klasifikohet ndër trashëgimtarët e platonizmit islam, pararendës i të cilit qe Muhamed ibn Davud Isfahani (vdiq më 297/909) i famshëm me librin, Kitabuz-zehra, një përmbledhje poezish me temë dashurie. Në bibliotekën e pallatit në Shatib, Ibn Hazmi ka pasur në dispozicion një ekzemplar të këtij libri të Ibn Davudit. Ai hedh vështrimin në fragmentin në të cilin Ibn Davudi aludon në mitin e Platonit nga “Gostia”:

“Disa ithtarë të filozofisë kanë menduar se Zoti e ka krijuar çdo shpirt duke i dhënë formë sferë, pastaj e ka ndarë në dysh, dhe çdo pjesë

e ka vënë në një trup”.

Fshehtësia e dashurisë është bashkimi i së-
rishëm i këtyre dy pjesëve në tërësinë filles-
tare. Idenë e para-ekzistencës së shpirtave e
konfirmon edhe hadithi profetik. Ibn Hazmi e
përmend atë, por e komenton si ribashkim që i
përket elementit të lartë të shpirtave të veçuar,
të shpërndarë nëpër këtë botë. Kjo ka të bëjë
me afërsinë ndërmjet impulseve që vënë në
lëvizje ndjenjat, të cilat kanë zënë fill që në ko-
hën e para-ekzistencës të tyre në botën e lartë.
Dashuria është afrimi reciprok ndaj formës. E
ngjashmja kërkon të ngjashmen e vet.

Dashuria është shkrimi shpirtëror, unifikim
i shpirtave. Kur shqyrton shkakun pse lind da-
shuria, Ibn Hazmi të kujton Fedarin e Platonit.

Ky shkak është “formë e bukur nga jashtë
(dhahir), sepse shpirti është i mirë, lakmon me
pasion çdo gjë që është e bukur dhe ka sim-
pati për shembëlltyrat e përsosura. Kur e sheh
shembëlltyrën e tillë, ai përqendrohet në të.
Dhe nëse në atë shembëlltyrë zbulon diçka që
i përgjigjet natyrës së tij vetjake, shembëlltyra e
tërheq fuqishëm dhe lind dashuria në kuptimin
e vërtetë. Por, nëse në shembëlltyrë nuk gjen
asgjë të ngjashme me natyrën vetjake, simpatia
e tij nuk shkon më tej nga forma!”

Me rëndësi është analiza që zbulojmë tek Ibn
Hazmi, i cili është dhahiri (d.m.th. ekzoterist në
çështjet juridike, luajal tekstuales, formës së
jashtme). Mendime të ngjashme do të mund të
gjenim tek ekzoteristët, siç janë Ruzbihani nga
Shirazi dhe Ibn Arabiu, të cilët përpiqen që bo-

tën e dukshme nga jashtë ta bëjnë të heshtë.

Arabisti A. R. Nykl e botoi për herë të parë
tekstin e librit të Ibn Davudit, si dhe bëri për-
kthimin e parë të librit të Ibn Hazmit në gjuhën
angleze. A. R. Nykl është marrë edhe me një
çështje që është jashtëzakonisht interesante.
Ajo është ngjashmëria e madhe ndërmjet teo-
risë së dashurisë së Ibn Hazmit dhe disa ideve
që paraqiten në “Shkathtësinë e hareshme” të
William IX Akvitanit, dhe përgjithësisht në te-
mat kryesore të repertorit të trubadurëve, deri
te luftërat kryqtare kundër albizhanëve.

Rëndësia e tij (gjeografike, tipologjike, shpirt-
ërore) është mjaft e madhe, sepse nuk ka të bëjë
vetëm me çështjen e formave dhe të tematikës,
por të diçkaje që është e përbashkët me *fedeli
d’amore* dhe religjionin e dashurisë që shpallnin
disa sufi. Për Ibn Davudin, për Xhahidhin, për
teologun Ibn Kajjim, rruga e dashurisë i përket
Zotit, ajo nuk del sheshit. Për sufitë, për Ruz-
bihanin nga Shirazi si edhe për Ibn Arabiun,
dashuria pikërisht përbëhet nga kjo shfaqje.
Spiritualiteti i sufive të mëpasëm bëhet tjetër
lloj nga spiritualiteti i atyre që u paraprinë. Da-
shuria nuk është thjesht shembull i dashurisë
së Zotit, sepse nuk duhet kaluar nga objekti
njerëzor në ndonjë objekt që do të ishte hyjnor.
Këtu ndodh transformimi i vetë dashurisë njerë-
zore, sepse ajo është “ura e vetme që kapërcen
greminën e tevhidit”.

Gjatë leximit të këtij libri, ndihmë të çmue-
shme do të japë vepra tjetër e Ibn Hazmit,
“Karakteret dhe mirësjellja” (Kitabu’l-ahlak
ve’s-sijer), sepse autori në të më përfaqëson e



përcakton terminologjinë teknike me të cilën shërbehet, duke i analizuar aspektet e dashurisë. Pos kësaj, kjo vepër, pak a shumë, është "ditar" intim. Këtu autori shkruan pa kurrfarë plani paraprakisht të përcaktuar, vrojtimet, përsiatjet dhe gjykimet e veta për njerëzit dhe jetën. Kjo vepër zbulon njeriun dhe shoqërinë andaluziane të shekullit V/XI.

Si jurist, Ibn Hazmi shquhet me veprën *Kitabu'l-ibtal*, në të cilën preokupohet me pesë burime të vendimit juridik që pranojnë shkollat e ndryshme, që janë: analogjia (*kijas*), mendimi vetjak (*rej*), miratimi (*istihsan*), imitimi (*taklid*), motivimi (*talil*). Në librin tjetër *Kitabu'l-muhalla*, krahas shkollës dhahiri, përcaktohen bazat e diskutimit juridik.

Vepra më e rëndësishme e Ibn Hazmit - teolog, është shqyrtimi i tij mbi religjionet dhe shkollat e mendimeve, *Kitab ul-fisal ve'n-nihal*. Kjo vepër voluminoze, konsiderohet me të drejtë shqyrtimi i parë në historinë krahasuese të religjioneve në gjuhën arabe. Në këtë vepër, mësuesi nga Kordoba tregon tërë madhështinë e gjeniut dhe gjerësinë e dijes së vet. Në të ekspozon, përveç religjioneve të ndryshme, edhe qëndrimet e ndryshme të shpirtit njerëzor kundruall faktit religjioz, si qëndrimin e skeptikëve që vënë në dyshim të gjitha vlerat e shenjta, ashtu edhe qëndrimin e besimtarit të thjeshtë nga populli.

Ai i ndan njerëzit dhe mësimet në më shumë se një kategori. Ekziston kategoria e të pafeve, e cila barabar i përfshin edhe skeptikët edhe materialistët. Ekziston kategoria e besimtarëve,

e cila përfshin ata që besojnë në hyjni personale dhe ata që besojnë në hyjni pa formë, abstrakte që nuk ka kurrfarë lidhjeje me antropomorfizmin. Grupi i dytë ndahet në monoteistë dhe politeistë. Ndër të parët dallojmë sërish ata që zotërojnë Librin, i cili, nëpërmjet ndonjë profeti është shpallur nga qielli dhe ata që nuk e kanë. Ata që e kanë Librin paraqesin dy raste të ndryshme: ekzistojnë ata që gjatë shekujve e kanë ruajtur me besnikëri tekstin e shenjtë pa kurrfarë ndërrimi dhe ata që e kanë ndërruar tekstin. Kriteri i vërtetësisë së faktit religjioz përbëhet pra, për Ibn Hazmin, në konfirmimin e Unitetit Hyjnor (*tevhid*) dhe në ruajtjen e plotë të tekstit të Shpalljes gjatë shekujve.

Fakti religjioz, i kuptuar kështu, zë fill kryesisht në kuptimin për hyjnoren, për të shenjtën, kurse autenticiteti i këtij kuptimi varet nga konfirmimi i unitetit transhental, të cilin e garanton Shpallja profetike. Që kjo Shpallje ta ruajë produktivitetin e vet të përhershëm, është më se e nevojshme që të ruhet çdo fjalë e saj, nga shekulli në shekull, sepse pikërisht ky tekst është pragu nëpër të cilin besimtari hyn drejt fshehtësisë së hyjnore.

Këto janë karakteristikat kryesore të universit religjioz, si e percepton Ibn Hazmi dhe në funksion të të cilit ai themeloi sistemin e vet ekzoterik (dhahiri), si rrugën e vetme drejt së vërtetës shpirtërore. Të mos harrojmë se edhe Ibn Arabi, një nga ezoteristët (*batini*) më të mëdhenj të të gjitha kohëve, ka qenë po ashtu andaluzian dhe, nga aspekti juridik, një dhahiri.



Xhamia e Et'hem Beut

Nga tetë xhamitë e mëdha të ndërtuara në Tiranë gjatë shekujve XVIII-XIX, ajo që ka arritur e paprekur që nga koha e ndërtimit, është Xhamia e Haxhi Et'hem Beut. Për hir të bukurisë dhe vlerës së saj artistike dhe arkitektonike, para Luftës së Dytë Botërore, urbanistët e Tiranës hartuan planin e ri rregullues të kryeqytetit, në mënyrë të tillë që ajo të ishte në sheshin e ri qendror (Sheshi Skënderbe), i cili zëvendësoi sheshin e mëparshëm qendror, që ndodhej para Xhamisë së Vjetër. Xhamia e Haxhi Et'hem Beut, për vlerën e saj artistike, u shpall pas Luftës së Dytë Botërore monument kulture. Si rrjedhim nuk u rrënuar gjatë luftës që iu bë monumenteve fetare në vitet '60-të të shekullit të 20-të. Ajo vazhdon të tërheqë gjithnjë admirimin e

vizitorëve shqiptarë e të huaj dhe si e tillë vlen të trajtohet në mënyrë të veçantë.

Njoftimet kryesore për historinë e ndërtimit të xhamisë dalin nga 4 mbishkrime në gjuhën osmane, që gjenden të skalitur në muret e saj. Vijnë pas këtyre, njoftimet që dalin nga burimet dokumentare të kohës – në fakt të pakëta, si dhe nga kujtimet e ruajtura nga tradita gojore tiranase të regjistruara që në shekullin e 20-të.

Sipas mbishkrimeve që përmban Xhamia e Et'hem Beut, themelet e saj i vuri në fund të shekullit të 18-të Molla Beu, kurse faltoren e plotësoi i biri i tij, Haxhi Et'hem Beu në çerekun e parë të shekullit të 19-të. Që të dy, at e bir qenë personalitete të shquara të jetës politike të Tiranës të kohës së tyre. Haxhi Et'hem Beu ishte njëkohësisht edhe personalitet i jetës kulturore të qytetit. Sipas traditës gojore, Molla Beu ishte nga Petrela, i vendosur në Tiranë dhe mbahej nga vija femërore si pasardhës i Bargjinëve. Sikurse konstatohet nga mbishkrimet që përmbajnë pllaka e vendosur mbi portalin e jashtëm dhe ajo e vendosur mbi portën e brendshme të xhamisë, themelet e faltores i vuri Molla Beu, në vitin 1207 hixhri (gushti 1794 - korrik 1795), i cili arriti të ndërtonte xhaminë deri në përfundimin e kubesë, pa mundur të plotësonte minaren dhe të përfundonte portikun, suvatimet dhe dekoracionet, pasi vdiq. Nga mbishkrimi kuptohet se autori i tekstit është njëfarë Zija. Këto të dhëna plotësohen nga një mbishkrim tjetër që është vendosur në portalin e jashtëm. Në këtë mbishkrim thuhet se Molla Beu nuk arriti ta plotësonte krejtësisht ndërtimin e xhamisë me minaren dhe dekoracionet,





pasi vdiq në vitin 1222 hixhri (mars 1807 shkurt 1808), por që i biri, Haxhi Et'hem Beu, e plotësoi duke përfunduar xhaminë e çatinë, duke ndërtuar minaren e sofanë dhe duke e zbukuruar me pikturat e ornamentet. Në fund të mbishkrimit thuhet se qëllimi i ndërtuesve të kësaj xhamie ishte t'i jepnin Tiranës një bukuri të përjetshme, ashtu si Shën Sofia i kishte dhënë Stambollit. Faltorja përfundoi së ndërtuari në vitin 1236 hixhri (tetor 1820 - shtator 1821).

Xhamia qëndron mbi themele në formë kuadrati me gjatësi e gjerësi 18,70 x 16,10 m, pra zë një sipërfaqe 301 metra katror. Është ndërtuar me gurë të sjellë nga fshati Shtish-Tufinë, që ndodhet në afërsinë lindore të Tiranës. Asnjë nga të katër fasadat nuk i ngjan tjetrës, gjë që tregon aftësinë krijuese të mjeshtrit arkitekt. Tipi i xhamisë është me portik, që ndodhet në formë L-je në anën lindore dhe veriore të faltores. Portiku është rrethuar nga ana e jashtme me 16 kolona prej gurësh monolitë 2,90 m të lartë, secila me nga një kapitel korintik prej 0,60 m dhe me një bazament prej 0.25 m. Mbi kolonat e rrumbullakëta, të punuara me shije e saktësi,

qëndron një arkadë e përbërë prej 5 harqesh (7 në anën lindore, 5 në anën veriore dhe 3 në anën perëndimore) jo në formë të mprehtë (jo me majë), por në formë gjysmërrethi, ndërtim i përhapur në Shqipëri qysh në kohët antike. Kolonat janë të pajisura me kapitele të dekoruara me ornamente motivesh vegjetale të skalitura në relief, të cilat vetëm tek-tuk i ngjajnë njëra-tjetrës. Kolonat janë të lidhura midis tyre me kangjella prej hekuri, të punuara me siguri nga farkëtarët vendës. Hyrja e portalit të jashtëm, si dhe hyrja në faltore (portali i brendshëm) ndodhen në anën veriore të xhamisë. Në të dy anët e hyrjes së portalit të jashtëm ndodheshin dy varre – në të majtë, varri (nuk ekziston më), i Haxhi Et'hem Beut dhe fare pranë tij ka qenë pusi për të marrë abdes, ndërsa në të djathtë varri i së shoqes, Ballkëze, varr që ekziston edhe sot. Të dy varret me pllaka guri dhe me nga dy lapidarë secili, janë të zbukuruara me ornamente vegjetale e floreale (trëndafila, rrush, hurma etj.), të skalitur në relief dhe me nga një mbishkrim me anagram datat e vdekjes së tyre.

Brenda faltores, në anën jugore ndodhet mihrabi; në të majtë të tij është minberi; përkundrajt tyre është mahfli, që zgjatet në gjithë anën veriore të faltores, i mbështetur mbi dy pilastra guri të bardhë mbi kapitele, gjithashtu të dekoruara. Faltorja ka 18 dritare në dy rreshta horizontale, të cilat, me gjithë numrin e madh, i japin asaj dritë të kufizuar dhe kështu krijojnë një ambient mistik, të cilin e plotëson kubeja, e cila, nga pikëpamja arkitektonike, është ndërtuar mjaft mirë dhe mbulon të gjithë hapësirën e brendshme të faltores. Nga jashtë kubeja, e cila ngrihet mbi një pullaz në një bazament tetëkëndësh, respekton stilin arabik, por streha e xhamisë, shumë e gjerë (1,20 m), është ndërtuar nën ndikimin e traditës arkitektonike lokale.

Gjymtyrë e bukur e xhamisë është minarja, tepër e hollë dhe shumë elegante, që ngrihet lart me finesë e thjeshtësi. Ajo mbështetet mbi një kullë të veçantë gati të shkëputur nga faltorja, 2,25 m e gjatë, 2 m e gjerë dhe 9 m e lartë. Kulla është e përbërë prej 37 rreshta gurësh; në



rreshtin e 17-të ka pesë gurë mermeri të skalitur me motive gjeometrike dhe në rreshtin e 36-të ka 3 gurë të tjerë të skalitur me motive vegjetale, të punuara me kujdes, element ky që, gjithashtu është marrë nga tradita shqiptare. Gjithë minarja ka 101 shkallë (deri në kazan ka 90 shkallë). Ka gjithsej 6 frëngji nga hyn drita. Kazani me portalin e vet, 47 x 190 cm – mjaft elegant, e stolis si një kurorë e bardhë minaren. Pjesa e sipërme e minares u dëmtua rëndë dhe, për pasojë, u shemb gjatë luftës për çlirimin e Tiranës, në nëntor 1944, por, në sajë të punës së kujdesshme që bëri më 1945-ën mjeshtri plak Adem Mata, i sponsorizuar nga besimtarët bamirës të qytetit të Tiranës, minarja u riparua në gjendjen që është sot.

Përveç ornamenteve skulpturore, Xhamia e Haxhi Et'hem Beut ka plot zbukurime piktore me ajete kuranore dhe me arkade. Si përfundim, Xhamia e Haxhi Et'hem Beut, në kompozicionin e vet arkitektonik, me volumin thellësisht harmonik, me minaren e bardhë dhe elegante, me kupolën dhe dekoracionet e saj me ajete kuranore, me portikun solid e të ëmbël, me dekoracionet dhe ornamentet e saj, mund të radhitet ndër monumentet më të bukura të

fesë islame, jo vetëm të Shqipërisë, por edhe më gjerë.

Xhamitë në Tiranë mbajnë mbiemrat e familjeve autoktone tiranase, të cilat edhe i kanë ndërtuar. Në Tiranë feja islame ka pasur rrënjë të forta. Të parët e familjeve që kanë ndërtuar këto xhami, nuk janë mjaftuar vetëm me dhurimin e truallit. Ata kanë dhuruar troje për të ndërtuar xhamitë në vendet kyçe të qytetit të asaj kohe dhe është për t'u evidentuar se disa prej këtyre xhamive, fatkeqësisht, pasi Tirana u shpall kryeqytet i Shqipërisë, për shkak të planeve rregulluese, u prishën, për t'u lënë vendin zgjerimit të rrugëve etj. Ndërsa në kohën e regjimit komunist, ato xhami që nuk qenë prekur nga planet rregulluese të qytetit, u prishën, duke u nisur vetëm nga fakti se ishin objekte fetare.

Kur xhamitë janë shembur, tabelat – pllakat treguese, që gjendeshin në to, u zhdukën. Megjithëkëtë, për disa prej tyre, shënimet e tabelave në fjalë kanë ardhur deri në ditët tona. Dhe, nëpërmjet tyre ne njihemi jo vetëm me bamirësin e kohës që ka ndërtuar xhaminë, por herë-herë edhe me një historik të shkurtër të ndërtimit të saj.



Në fillim puna apo familja?

Një ndër problemet e ditëve të sotme që na paraprin çdo ditë, është ekuilibri që duhet të vendosim midis jetës, familjes dhe punës sonë. Një numër i konsiderueshëm njerëzish, për shkak se nuk arrijnë të vendosin një ekuilibër të tillë, humbasin, dikush punën, dikush familjen dhe dikush tjetër të dyja. Por duhet të dimë që ndër elementet kryesore të lumturisë sonë janë edhe familja edhe puna. Pra lumturia jonë, në

një farë mënyre, varet nga këto dy elemente. Prandaj jemi të detyruar që të jetojmë, duke mos i hyrë në hak njërës as tjetrës.

Një nga problemet më të vështira të njerëzve që jetojnë jashtë shtetit, është edhe krijimi i një ekuilibri mes punës dhe familjes. Në shumicën e rasteve njerëzit, të cilët sapo janë bërë pjesëtarë të një shoqërie të huaj, për t'u përshtatur me jetën e atij vendi dhe për të qëndruar në këm-

bë, punojnë me orar të zgjatur, madje edhe në fundjavë. Kështu detyrohen të lënë pas dore familjet e tyre. Kur shohim pasojat e kësaj neglizhence, fatkeqësisht vërejmë se kompensimi është i pamundur.

Një miku im, më ka treguar një histori, e cila ishte sa e dhimbshme aq edhe mësimdhënëse, për një familje. Burrë e grua, sapo kishin shkuar në Australi dhe, për të paguar kredinë e shtëpisë që kishin marrë, punonin të dy ditë e natë. Me mendimin se do të kishin një shtëpi të vetën, duke punuar shumë, arritën që të paguanin për pesë vjet kredinë që kishin për ta paguar për njëzet vjet. Por fatkeqësisht, mbas pesë vjetësh, ajo shtëpi i ishte e pamjaftueshme. Sepse për pesë vjet me radhë ata kaluan aq pak kohë me njëri-tjetrin dhe ndanë aq pak gjëra bashkë, sa kur u bënë me një shtëpi të vetën, u ndjenë si të huaj. Për këtë u ndanë.

Ndoshta nuk mbaron kështu historia e çdo personi, i cili nuk mund ta ruajë ekuilibrin mes jetës familjare dhe punës. Por pa dyshim, secili prej nesh duhet ta dijë se çdo minutë që vjedhim nga koha, që duhet të ndajmë për familjen, mund të kthehet në të ardhmen në dhimbje. Ka shumë prindër, baballarë që në kohën e duhur nuk u kanë qëndruar pranë fëmijëve të tyre dhe i kanë lënë mbas dore. Dhe kur këta fëmijë kanë hyrë në moshën e pjekurisë dhe më tej, kanë filluar të veprojnë dhe të sillen në mënyrë të atillë, sa t'i turpërojnë prindërit. Por tashmë për ata prindër është shumë vonë. Nuk u mbetet gjë tjetër vetëm të vështrojnë të turpëruar veprimet e fëmijëve e t'u skuqet fytyra nga fjalët që dëgjojnë për ta.

Mendoj se shkak i gabimit në përgjithësi, qëndron në perceptimin e elementit të dashurisë. Baballarët ose nënat mendojnë se fëmijët apo bashkëshortët e tyre do t'i duan ata në çdo kohë dhe në çdo situatë. Ndërkohë ne e dimë që një lule, sado e thjeshtë apo e vogël të jetë,



nëse mbetet pa ujë ose larg rrezeve të diellit, fillon të vyshket. Por përpara nesh ndodhet zemra, e cila është shumë e lehtë për t'u thyer por shumë më e vështirë për t'u riparuar. Prandaj, kushdo qoftë, prindër, bashkëshort, vëlla, motër, fëmijë, nëse nuk kujdesemi, nuk derdhim djersë për të, humbim dashurinë e çmuar të tyre dhe, sado të mëdha të jenë sukseset tona në emër të punës, karrierës, materialitetit, ato nuk numërohen si të tilla.

Le të përcjellim disa mesazhe të tilla që na forcojnë lidhjet me të afërmit tanë. Gratë duhet t'i presin burrat e tyre me një buzëqeshje dhe gëzim në fytyrë. Burrat duhet t'i ndihmojnë bashkëshortët e tyre në përgatitjen e ushqimit apo larjen e enëve. Prindërit nuk duhet të shohin televizor me fëmijët e tyre, por duhet të bisedojnë me ta për problemet dhe vështirësitë që ata kanë. T'i dëgjojnë mirë ata dhe të merakosen për problemet e tyre.

Çdo pjesëtar i familjes duhet të dijë për tjetrin; se çfarë pëlqen dhe nuk pëlqen. Nëse brenda familjes ka mërzitje, duhet t'i eliminojmë ato. Duhet të shkrijmë akullin që mund të ketë ndërmjet pjesëtarëve të asaj familjeje. Çdokush që është pjesëtar i një familjeje, duhet të dijë që është pjesëtar i një thesari shumë të çmuar. Ta dijë këtë dhe të jetojë me një lumturi në shpirt duke falënderuar pafundësisht.



Një mollë në ditë të mban larg doktorit

Sipas Dr. Adams dhe ekipit të tij në Universitetin e Iowa-s, acidi ursolik, që gjendet në lëkurën e mollës, ndihmon në djegien e yndyrave dhe në zhvillimin e muskujve. E thënë ndryshe, të ndihmon të kesh një trup të bukur dhe të jesh gjithmonë në formë.

Në eksperimentet që janë bërë mbi minjtë e laboratorit, ka rezultuar se molla ka shtuar muskujt deri në masën 15% dhe ka pakësuar yndyrnat deri në masën 50%. Gjithashtu u vërejt se, megjithëse acidi ursolik shtoi masën e muskujve, pesha trupore e minjve nuk ndryshoi.

Por dobiet e mollës nuk mbarojnë me kaq. Konsumimi i rregullt i mollës, ul nivelin e sheqerit në gjak, nivelin e kolesterolit dhe nivelin e acideve të dëmshme yndyrore. Dr. Adams theksoi se molla është e dobishme, veçanërisht për të moshuarit, muskujt e të cilëve pakësohen me kalimin e kohës. Kjo sëmundje, e quajtur "atrofi", prek shumë njerëz gjatë jetës së tyre dhe për të nuk ka asnjë kurë.



"Gjatë kërkimit shkencor për të gjetur përbërjet kimike që do të kurojnë atrofinë, midis të tjerave na doli përpara edhe acidi ursolik." - tha ndër të tjera Dr. Adams. Ky është një lajm shumë i mirë, sepse acidi ursolik gjendet me shumicë në lëkurën e mollës. Prandaj mund themi me plot bindje se "një mollë në ditë të mban larg doktorit".

Higjiena e gojës

Dhëmbët, si çdo pjesë e trupit, kanë lidhje me pjesët e tjera, por në këtë rast shëndeti i tyre është një tregues i dukshëm dhe i saktë i shëndetit të të gjithë organizmit. Ajo çfarë shohim në gojë, është në fakt gjendja e trupit tonë në miniaturë. Por edhe e kundërta është e vërtetë. Nëse organizmi ynë ka probleme, edhe dhëmbët i ndjejnë këto probleme dhe sëmuren. Madje mendohet se pjesa më e madhe e problemeve

dentare vjen nga dhëmbët. Ndaj këshilla e parë që duhet të thotë një dentist, është që njerëzit të kenë kujdes në radhë të parë për shëndetin e tyre dhe më pas edhe për dhëmbët. Mbi të gjitha, nëse kemi ndonjë problem me dhëmbët, nuk duhet ta lëmë situatën të degjenerojë, sepse në një rast të tillë bëhet fjalë për shumë më tepër se dhëmbët e gojës.

Të ngrënë e dhëmbëve


Shumë njerëz çuditen kur e kuptojnë se janë "ngrënë dhëmbësh", sepse në fakt e bëjnë këtë gjë, ndërsa janë në gjumë, pra, kur nuk janë të ndërgjegjshëm. Dhe ata nuk e kuptojnë se kjo është një mënyrë përmes së cilës trupi shpreh stresin e tij, edhe pse në mënyrë të pavetëdijshme për personin. Sipas mjekëve, ngrënia e dhëmbëve, ose kërcëllitja e pavetëdijshme e tyre, është shenjë e stresit psikologjik dhe

emocional.

Shpesh njerëzit e vënë re krejt papritur se i kanë dhëmbët të ngrënë, apo të sheshtë ose e kuptojnë se çfarë ka ndodhur nga dhimbja e nofullës. Si pasojë e kësaj kërcitjeje, mund të shkaktohen edhe dhimbje koke. Për këtë mund të përdoren disa pjesëza të quajtura "ruajtëse të gojës", që i vëmë natën në gojë.



ADN në vend të tranzistorëve



Teknologjia kompjuterike po bën hapa aq gjigandë, saqë çdo ditë dëgjojmë për teknologji të reja që dalin në treg. Por ky lajm është me të vërtetë sensacional.

Shkencëtarët e Caltech planifikojnë të bëjnë realitet ëndrrën e shumë shkencëtarëve. Pra, atë të ndërtimit të një kompjuteri me bazë ADN-je. Ata kanë arritur të

zëvendësojnë tranzistorët e kompjuterit me qarqe biokimike dhe të kryejnë disa përlllogaritje të lehta.

“Siç e dini, në industrinë e kompjuterëve të gjithë mundohen vazhdimisht të bëjnë një kompjuter sa më të mirë. Edhe ne këtë duam. Qëllimi ynë është të ndërtojmë qarqe biokimike për kryerjen e përlllogaritjeve shumë të vështira. Prandaj dhe punën e tranzistorëve ia kemi besuar ADN-së” - tha njëri nga shkencëtarët e Caltech.

Qarqet biokimike përbëhen nga gypa qelqi të cilët përmbajnë molekula që notojnë në ujë të kripur. Qarqet me bazë ADN-je, molekulat i perceptojnë si sinjale. Ndërsa sinjalet e këtyre molekulave qarkullojnë në ujin e kripur si të ishin në ndonjë kablo. Por sigurisht që studimi është ende në fillimet e tij dhe qarku më i madh që është ndërtuar deri tani përmban vetëm 74 molekula të ADN-ve të ndryshme.

Këmbë robotike shumë të veçanta

Japonezët si gjithmonë arrijnë të na mahnitin me risitë që sjellin në fushën e robotikës. Dr. Joshijuki Sankai, i Universitetit të Tsukubas, ka ndërtuar këmbë robotike për t'u ardhur në ndihmë njerëzve me të meta fizike. Në fakt, gjëja e mahnitshme nuk është kjo, por ajo se këto gjymtyrë vihen në lëvizje me anë të mendjes.

Roboti i quajtur HAL (HybridAssistiveLimb– Gjymtyrë ndihmëse hibride) iu prezantua publikut në qytetin Bochum të Gjermanisë. Qëllimi kryesor i tyre është të ndihmojë njerëzit e paralizuar dhe me të tjera të meta fizike. Por në sajë të gjymtyrëve robotike që ka ndërtuar firma Cyberdyne, HAL mund të përdoret edhe nga njerëzit e zakonshëm për të ngritur peshë më të rënda.

Dr. Joshijuki Sankai e ka filluar këtë projekt 20 vjet më parë. Ai punoi shumë mbi këtë projekt dhe iu deshën rreth tri vjet për të përcaktuar impulsat elektrike që lidhin trurin me gjymtyrët. Ndërsa katër vite iu deshën për të lidhur sinjalet elektrike me programin e

kompjuterit. Më në fund, para gjashtë vjetësh, ai kreu testin e fundit. Në fillim, e gjithë pajisja e përbërë nga këmbët, bateria dhe kompjuteri peshonte më tepër se 22 kg. Por tani, me një dizajn modern dhe të lehtësuar, ato peshojnë vetëm 10 kg.

Kur njeriu vendos të lëvizë, truri i dërgon sinjale nervore sistemit muskolor. Ndërsa sensorët e robotit perceptojnë sinjalet e muskujve dhe kështu arrijnë të vënë në lëvizje këmbët robotike.

Këtë vit HAL do të kalojë në prodhim seri, ku do të prodhohen rreth 500 copë në vit. Ai do të disponohet në tre masa, S (e vogël), M (e mesme) dhe L (e madhe). Roboti do të përdoret për të sëmurët dhe në spitale.



Zgjedhjet e përgjithshme në Turqi



Pas një fushate të gjatë, në 12 qershor Turqia mbajti zgjedhjet e përgjithshme. Pjesëmarrja në zgjedhje ishte e lartë, rreth 87%. Nga zgjedhjet arritën të hyjnë në Asamblenë e Madhe Popullore të Turqisë deputetët e tri partive politike dhe deputetët e pavarur. Partia AK mori 49,9% të votave të vlefshme duke dalë edhe partia e parë në këtë garë zgjedhore dhe nxori 326 deputetë. Këtë parti e ndoqën Partia Republikane Popullore me 25,9% të votave dhe 135 deputetë, Partia e Lëvizjes Nacionaliste me 13% dhe 53 deputetë dhe 36 deputetët e pavarur, të cilët morën 5,8% të votave në mbarë Turqinë.

Rezultatet e këtyre zgjedhjeve patën një jehonë të madhe si në Turqi, ashtu dhe në botë. U bënë vlerësime të ndryshme mbi ndikimet që do të kenë këto rezultate në politikën e Turqisë dhe si rrjedhim edhe në politikën e saj rajonale dhe botërore.

Para së gjithash përfundimet e zgjedhjeve përfaqësojnë një risi në historinë e Turqisë. Për herë të parë një parti, partia AK, doli partia e parë tre herë radhazi duke e rritur numrin e votave në krahasim me zgjedhjet e mëparshme. Votat e partisë AK nga 34% që ishin në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2002 u rritën në 47% në zgjedhjet e vitit 2007 dhe në 50% në zgjedhjet e fundit të vitit 2011. Po të kemi parasysh se votat që mori partia AK në zgjedhjet e fundit janë sa dyfishi i votave të partisë kryesore të opozitës, Partisë Republikane Popullore, pasuesja më e afërt e partisë AK, ose të barabarta me shumën

totale që morën të gjitha partitë e tjera, e bën edhe më të dukshëm suksesin e shënuar nga partia në pushtet për Drejtësi dhe Zhvillim AK. Disa e shikojnë si "kërcënim" këtë fitore të plotë të partisë AK, ndërsa shumica e analistëve e konceptojnë atë si një fitore të merituar të partisë AK.

Duket se politikat që ka ndjekur dhe projektet që ka realizuar partia AK për 9 vite në qeverisje janë vlerësuar pozitivisht nga gjysma e popullit. Disa nga fushat kryesore, ku duket se partia AK ka arritur ta bindë popullin, janë: performanca e saj veçanërisht në fushën e transportit, shëndetit, ekonomisë, fuqizimit të autoritetit civil e politika e jashtme. Mund të themi se një faktor i rëndësishëm është edhe vazhdimi i stabilitetit ekonomik dhe politik në Turqi, pavarësisht krizës në ekonominë globale dhe problemeve në rajonin e Lindjes së Mesme.

Një përfundim i rëndësishëm i zgjedhjeve të 12 qershorit janë reagimet pozitive dhe inkurajuese që vijnë nga bota perëndimore. Një pikë e rëndësishme që duhet nënvizuar këtu është realizimi përafërsisht i parashikimit që kishte bërë para zgjedhjeve revista "The Economist". Pra, dalja nga zgjedhjet e një ekuilibri të fuqishëm në Turqi, ku mund të kenë ndikim edhe partitë e tjera, në vend të një partie të vetme që do të dominonte dhe që mund të bëjë çdo gjë. Po të shikojmë lajmet që publikuan gazetat dhe mediat në perëndim dhe në shumë vende të botës, mund të themi se rezultatet e 12 qershorit në përgjithësi janë pritur me kënaqësi. Zgjedhjet dhe përfundimet e tyre u konceptuan në formën se stabiliteti i Turqisë do të vazhdojë si në aspektin e politikës së brendshme, ashtu edhe asaj të jashtme. Revista "Der Spiegel" bëri komentin se falë suksesit që ka arritur, kryesisht në drejtim të demokratizimit edhe më tej të vendit, Turqia është shndërruar në "fuqinë në rritje të Bosforit". Ndërsa analistët dhe politikanët e tjerë bëjnë komentin se zgjedhjet në Turqi treguan se islami mund të bashkëjetojë në harmoni me demokracinë dhe se mund të jetë shebull për të gjithë botën islame.